



**Bashkia Finiq**

**Plani i Përgjithshëm Vendor**

Plani i Zhvillimit të Territorit

## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Plani i propozuar i zhvillimit të territorit .....</b>	<b>4</b>
1.1	Ndarja e territorit në sisteme territoriale dhe konvertimet e tyre .....	4
1.2	Ndarja e territorit në zona dhe njësi strukturore .....	6
1.3	Përdorimi i tokës sipas kategorive, nënkategoritë dhe funksioneve .....	9
1.4	Zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare .....	16
1.4.1	Trashëgimia natyrore .....	17
1.4.2	Trashëgimia kulturore dhe zonat mbrojtëse .....	17
1.4.3	Parashikime dhe udhëzime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore .....	19
1.4.4	Mbrojtja dhe ruajtja e pasurive kulturore të palujtshme .....	20
1.4.5	Udhëzime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jo monument .....	23
1.4.6	Ligji i ri për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë .....	25
1.4.7	Propozime për shpalljen e monumenteve të kulturës .....	25
1.5	Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik e urban.....	29
1.6	Tipologjitë e propozuara hapësinore .....	32
1.7	Mënyrat e ndërhyrjes në territor .....	33
1.8	Njësitë që i nënshtrohen hartimit të PDV-së .....	35
1.9	Instrumentet për drejtimin e zhvillimit .....	36
1.10	Parashikimet demografike dhe strehimi.....	37
<b>2</b>	<b>Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike .....</b>	<b>39</b>
2.1	Rrjeti rrugor .....	39
2.1.1	Koordinimi i trafikut .....	44
2.1.2	Lëvizja e këmbësorëve dhe çiklistëve .....	44
2.2	Transporti publik .....	45
2.3	Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm .....	46
2.4	Sistemi i integruar i kanalizimeve dhe trajtimit të ujrave të ndotura .....	48
2.5	Rrjeti i furnizimit me energji elektrike .....	50
2.5.1	Ndriçimi publik .....	51
2.6	Telekomunikacioni.....	51
2.7	Menaxhimi i mbetjeve .....	52
2.8	Plani për hapësirat publike dhe shërbimet sociale.....	54
2.8.1	Hapësirat publike .....	54
2.8.2	Edukimi.....	59
2.8.3	Shërbimi shëndetësor .....	61
2.8.4	Varrezat.....	62
2.8.5	Mbrojtja kombëtare, civile kundër zjarrit .....	62
<b>3</b>	<b>Plani i mbrojtjes së mjedisit .....</b>	<b>63</b>
3.1	Mbrojtja e peizazhit natyror e urban.....	63
3.2	Mbrojtja e burimeve ujore .....	64
3.3	Mbrojtja e biodiversitetit dhe shtimin e hapësirave të gjelbra .....	66
3.4	Përmirësimi i cilësisë së ajrit .....	66
3.5	Masa për trajtimin e zonave problematike mjedisore .....	68

3.6	Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve, kullotat .....	69
<b>4</b>	<b>Plani i Veprimeve për zbatimin e PPV-së .....</b>	<b>69</b>
4.1	Plani i veprimit / Fazat e zbatimit për zhvillimin e planit .....	69
4.2	Plani i investimeve kapitale.....	76
4.3	Të ardhura .....	77
4.4	Shpenzime .....	78
4.5	Teprica operative neto.....	79
4.6	Investimet afatgjatë.....	96
4.7	Treguesit e monitorimit të zbatimit të planit.....	97
4.8	Ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ vendor .....	99
4.9	Faktorët që mund të shkaktojnë rishikim të PPV-së apo pjesëve të saj.....	99
4.10	Përcaktimet kryesore për termat e referencës për Planet e Detajuara Vendore dhe Planet Sektoriale.....	100
<b>5</b>	<b>Kapacitetet institucionale .....</b>	<b>105</b>
5.1	Vlerësimi i nevojave për personel të kualifikuar dhe logjistikë .....	105
5.2	Rishikimi i nevojave të bashkisë për ristrukturim .....	112
5.2.1	Ristrukturimi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.....	113
5.3	Zhvillimi i kapaciteteve dhe marrëveshjet e zbatimit.....	114
<b>6</b>	<b>Konsultime me palët e interesuara .....</b>	<b>117</b>
6.1	Dëgjësë publike për Planin e Zhvillimit dhe Rregulloren e Planit .....	117
6.2	Raporti i Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në nivel Vendor.....	119

# **1 Plani i propozuar i zhvillimit të territorit**

## **1.1 Ndarja e territorit në sisteme territoriale dhe konvertimet e tyre**

Një nga objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) është drejtimi i zhvillimit të sistemit urban të banimit dhe harmonizimi i tij me 4 sistemet e tjera në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Në këtë kontekst, ruajtja, mënyra e përdorimit dhe, sipas rastit, konsolidimit të sistemeve të tjera territoriale janë pjesë e këtij objekti. Pikërisht për qëllime planifikimi dhe menaxhimi, territori ndahet në 5 sisteme territoriale, të cilat përcaktohen në nivel makroplanifikues që në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit dhe detajohen përmes Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së PPV-së. Propozimet territoriale të prezantuara në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të bashkisë Finiq, të detajuara në këtë dokument, janë reflektuar edhe në sistemet territoriale të propozuara, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit si më poshtë:

### **Sistemi urban**

Ky sistem përbën tërësinë e të gjitha strukturave të ndërtuara të pranishme dhe të planifikuara në territor. Në krahasim me vlerën ekzistuese të sipërfaqes së këtij sistemi, plani propozon një rritje prej 308.37Ha ose 21.15%. Kjo rritje vjen kryesisht për efekt të mbushjes urbane në disa zona urbane ku ekziston tendenca për zhvillim si edhe për shkak të zhvillimit të Finiqit në drejtim të pjesës perëndimore dhe jugore. Konvertimet në sisteme urbane në këto raste kanë qenë nga sistemet bujqësore apo nga ato natyrore, të cilat duke patur parim mbrojtjen dhe konsolidimin e tokës bujqësore apo natyrore, është përzgjedhur konvertimi në toka me bonitet të ulët. Territore me sipërfaqe relativisht të vogël, të vendosura në pjesët periferike të zonave urbane I janë nënshtruar procesit të konvertimit në sistem urban, për të përfshirë në këtë sistem ndërtesa ekzistuese apo për të krijuar mbushje urbane në ato qendra të banuara ku është e nevojshme.

### **Sistemi infrastrukturor**

Ky sistem përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar dhe në nivel vendor. Përsa I përket sistemit infrastrukturor janë propozuar ndërhyrje rehabilituese pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë. Rrjeti I transportit rrugor, infrastruktura e ujësjellësit si edhe ajo elektrike kanë nevojë për mirëmbajtje dhe pjesërisht për rikonstruksione. Përsa I përket rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza propozohen ndërhyrje më të konsiderueshme, ku për disa zona urbane propozohet rehabilitimi dhe sjellja sipas standatreve e gropave septike dhe në disa zona të tjera, ku edhe numri I popullsisë është më I lartë propozohet të ngrihet rrjeti infrastrukturor I kanalizimeve. Ky sistem ka pësuar një ulje prej 34%, ose prej 176.24 Ha dhe është I përbërë pothuajse tërësisht nga infrastruktura e transportit rrugor, për arsye se rrjetet e

tjera infrastrukture janë nëntokë. Kjo ulje ka ndodhur për shkak të metodologjisë së zbatuar për procesin e kategorizimit dhe ndarjes së territorit në njësi strukturore, ku edhe pse rrjeti rrugor është ekzistues, ai është përfshirë brenda njësive të cilat i përkasin një sistemi tjetër, duke u llogaritur si Kshr. Kjo metodologji është zbatuar kryesisht brenda qendrave urbane për rrugët e kategorisë E ose F.

### **Sistemi bujqësor**

Bujqësia dhe blegtoaria përbëjnë një nga bazat më të rëndësishme të ekonomisë, ajo është e shprehur në të gjitha degët e saj që nga drithrat e bukës e deri te perimet e drufrutorët. Sipërfaqja e këtij sistemi pëson një ulje prej 149.34 Ha ose 1.21%. Nga Strategjia Territoriale në këtë sistem është propozuar magazinimi i produkteve bujqësore në afërsi të fshatit Dermish. Arsyeja e uljes së kësaj sipërfaqeje ka të bëjë kryesisht me procesin e mbushjes urbane të propozuar për zonat urbane apo të zgjerimit të tyre, periferitë e të cilave kufizohen me tokë bujqësore. Tokat ku është kryer ky konvertim janë përzgjedhur kryesisht me bonitet të ulët.

### **Sistemi ujqor**

Bashkia Finiq laget nga liqeni i Butrintit në një vijë rreth 2 km dhe një sipërfaqe që është nën juridiksionin e saj rreth 3 km<sup>2</sup>. Lumenjtë që përshkojnë bashkinë Finiq janë:

- Lumi i Bisticës që kalon komplet në territorin e saj në një gjatësi rreth 18 km
- Lumi i Kalasës në një gjatësi rreth 8km
- Lumi i Pavllës që është dhe kufiri ndarës me bashkinë Konispol në një distancë rreth 20 km
- Lumi i Navaricës me një distancë rreth 15 km.

Sistemi ujqor realisht nuk pëson ndryshime në sipërfaqe apo konvertime, por vlerat e konvertimeve rezultojnë për arsye saktësimi të dixhitalizimit të këtij sistemi. Përsa i përket këtij sistemi plani propozon rehabilitimin e brigjeve lumore, parandalimin e zhvillimit në afërsi të brigjeve si edhe ngritjen e fushatave ndërgjegjësuese për pastrimin dhe mirëmbajtjen e trupave ujore.

### **Sistemi natyror**

Sipërfaqen më të madhe të territorit të bashkisë Finiq e zë sistemi natyror. Relievi i territorit të Bashkisë Finiq është i larmishëm, mbasi ndërthuren vargjet malore, grykat e qafat me luginat e ndryshme. Relieve është kryesisht fushor dhe kodrinor. Territori i Bashkisë Finiq në pjesën lindore kufizohet nga vargu mali i Gjerë - Shtugarë, ndërsa në pjesën veriore kufizohet me konturin verior të Fushëgropës së Delvinës, në anën jug - perëndimore mbyllet nga vargmali Sarandë - Milë, ku hapësira midis tyre i lejon bashkisë dalje në lagunën e Butrintit. Nga propozimet e planit sipërfaqja e këtij sistemi ka pësuar një rritje prej 17.21 Ha ose prej 0.05%. Përsa i përket Parkut Kombëtar të Butrintit dhe zonës së mbrojtur të Syrit të Kaltër , vepron Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Përsa i përket pjesës tjetër të territorit të këtij

sistemi, plani propozon mbrojtjen rigoroze të tij, duke u marrë masa për mbrojtjen ndaj zjarrit, parandalimin e erozionit apo fushatave ndërgjegjësuese për ruajtjen e tij.

Table 1: Sistemet territoriale në bashkinë Finiq sipas sipërfaqës dhe përqindjes (Përpunoi: Dea Studio)

Sistemi	Ekzistuese Ha	Ekzistuese %	Propozuar Ha	Propozuar %	Ndryshimet Ha	Ndryshimet %
Bujqësor	12392.84	26.79	12243.50	26.47	-149.34	-1.21
Infrastrukturor	518.29	1.12	342.05	0.74	-176.24	-34.00
Natyor	31531.52	68.17	31548.73	68.21	17.21	0.05
Ujor	351.88	0.76	351.88	0.76	0.00	0.00
Urban	1458.13	3.15	1766.50	3.82	308.37	21.15

Përsa I përket llojeve të konvertimeve të shpjeguara më sipër, ato janë sipas tabelës:

Sistemi	Konvertimi	Sipërfaqe Ha	Perqindje %
Bujqësor	Infrastruktura	54.45	0.12
Bujqësor	Urban	330.99	0.72
Infrastrukturor	Bujqësor	87.65	0.19
Infrastrukturor	Natyre	53.58	0.12
Infrastrukturor	Urban	105.47	0.23
Natyor	Infrastruktura	13.21	0.03
Natyor	Urban	115.94	0.25
Urban	Bujqësor	148.44	0.32
Urban	Infrastruktura	2.80	0.01
Urban	Natyre	92.78	0.20

## 1.2 Ndarja e territorit në zona dhe njësi strukturore

Komponenti themelor i Planit të Zonimit është harta e propozuar e përdorimit të tokës. Çdo zonë e propozuar, përfshin parimet e zhvillimit, që do të shprehet në formën e rregullores. Një qasje sistematike, e cila merr në konsideratë një sërë parimesh udhëzuese, normash ekzistuese, si edhe kufizimet kryesore në nivel kombëtar, është hartuar për të mbështetur procesin e zonimit dhe për të minimizuar zgjedhjet arbitrare, duke synuar paralelisht planifikimin e një sërë rregullash të thjeshta dhe të zbatueshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, i cili do të lehtësojë procesin e zbatimit.

*Parimet gjithëpërfshirëse të zonimit.* Parimet e procesit të zonimit, të përdorura në krijimin e Planit të Zonimit, kanë marrë parasysh evolucionin historik të zonës, si edhe diferencimin gjeografik dhe morfologjinë e territorit. Në të njëjten kohë, procesi i zonimit përfshin edhe filozofinë e qendrueshmërisë, të miratuar në nivel global me konsideratë të veçantë në udhëzimet e politikave kombëtare dhe praktikatat e suksesshme të ndjekura në vendet

evropiane. Parimet e zhvillimit të qendrueshëm hapësinor përpiqen të krijojnë barazi dhe drejtësi brenda zonës së planifikimit, duke ruajtur edhe rritjen e potencialit të zhvillimit për brezat e ardhshëm. Një detyrë e rëndësishme në procesin e zonimit është identifikimi dhe propozimi i zonave urbane dhe rurale të zgjerimit për çdo njësi të zonës së studimit, si edhe përcaktimi i zonave të reja të zhvillimit. Kjo nënkupton një seri vendimesh që janë të bazuara në:

- Vizionin hapësinor për zhvillimin e ardhshëm në bashkëpunim me Bashkinë.
- Identifikimin e nevojave programore në bazë të parashikimeve shkencore, adaptimin e standarteve kombëtare dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.
- Detajimin e hollësishëm të tokës për çdo lokalitet në studim.
- Planifikimin ekzistues dhe rregulloren e kufizimeve.

Mënyra se si faktorë të ndryshëm janë marrë në konsideratë në procesin e zonimit të ndarjeve të zonave dhe njësive strukturore, shpjegohet si më poshtë:

*Modelet primare të përdorimit të tokës.* Kjo përfshin evidentimin e përdoruesve primarë të tokave, që ndodhen në nënndarjet ekzistuese në nivel rajonal, duke përfshirë të gjithë territorin e Bashkisë. Një klasifikim i parë është bërë ndërmjet tokës urbane dhe asaj jurbane, bujqësore dhe sistemeve natyrore të zonës së planifikimit. Zona është identifikuar fillimisht sipas përdorimit kryesor të tokës dhe në rastet kur mbizotëron një larmi përdorimesh, duhet të bëhen nënndarje të tjera, që korrespondojnë me përdorimin ekzistues.

Përveç faktorëve të mësipërm, ndarja e zonave dhe përcaktimi i zonave të zhvillimeve të reja, si edhe zonat e reja të zgjerimit, janë bazuar në parimet e mëposhtme duke marrë në konsideratë udhëzimet ekzistuese dhe praktikave më të mira të vlerës universale, si më poshtë vijon:

### **Përqendrimi i zhvillimit**

Zonimi mbështet një numër të kufizuar polesh zhvillimi, të identifikuar aktualisht me ndikim të ulët, duke respektuar nevojën primare për të ruajtur vlerën e një pejsazhi thelbësishëm të paprishur dhe të pazhvilluar në shkallë rajonale. Zonimi synon në këtë mënyrë të shmangë zhvillimet sporadike (të shpërndara, autonome), që ndikojnë në natyrën e virgjër të pejsazhit të tërësi të bashkisë dhe që komprometojnë vlerën e saj të përgjithshme duke kufizuar përftimet potenciale në ato ekonomike.

### **Racionalizimi i zhvillimeve ilegale**

Zonat e zgjerimit urban janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë lehtësimin, racionalizimin dhe konsolidimin e zhvillimit ekzistues sporadik, dhe/ose të paligjshëm në përputhje me kërkesat e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të politikës së planifikimit bregdetar, strategjive dhe planeve, si edhe me skemat përkatëse të planifikimit.

### **Përdorimi ekonomik i infrastrukturës**

Zonimi mbështet zhvillimin ekonomik të infrastrukturës ekzistuese dhe asaj të propozuar, pa shkaktuar dëmtime gjatë përdorimit.

### **Homogjeniteti i zonave**

Zonimi siguron rregulla të plota në mënyrë të thjeshtë, që do të jenë të lehta për t'u zbatuar.

Shkalla e zonave ka marrë parasysh:

- Sigurimin e një zone të një madhësie absolute, në mënyrë që të shmanget një strukturë e fragmentuar urbane dhe rregulloreje të komplikuar, duke ruajtur korrektësinë brenda morfologjisë urbane.
- Të mund të përgjithesojë përdorimin sipas përdorimit kryesor në çdo zonë. Për shembull, një zonë rezidenciale do të jetë përshkruar si një zonë homogjene, pa pasur nevojën për të detajuar në një hartë të përdorimit të tokës hapësirat publike të hapura, zonat e parkimit që gjenden brenda tij, etj.

### **Sisteme të ndryshme territoriale**

Duke u bazuar në VKM 686, zonat dhe njësitë strukturore duhet të përfshijnë të kufijtë e vet vetëm 1 lloj sistemi. Në momentin kur kemi dy elementë territorialë të cilët i përkasin sistemeve të ndryshme, në atë pikë vendoset edhe kufiri ndarës i zonës dhe njësisë strukturore.

#### **Lloje të ndryshme të përdorimit të tokës**

Edhe brenda të njëjtit sistem, janë kryer zonimet e territorit nëse elementë të ndryshëm i përkasin përdorimeve të ndryshme të tokës. Nëse brenda një zone urbane, kemi sipërfaqe banimi dhe industri, kufiri ndarës i tyre bëhet edhe kufiri i njësisë strukturore.

### **Kufijtë e zonave kadastrale dhe ndarjes së pronësisë**

Atje ku ka patur informacion dixhital si edhe ku ka qenë e mundur, si element orientues për ndarjen e kufijve të zonave dhe njësisë strukturore është mbajtur edhe kufiri i zonave kadastrale dhe i parcelave të pronësisë.

### **Llojet e ndryshme të kushteve të zhvillimit të parashikuara për zonat urbane**

Nëse brenda një zone urbane, me funksion primar banimin, është venë re një diferencim në presionin e zhvillimit, psh tendeca është për zhvillim më të lartë në një zonë dhe më e ulët në një zonë tjetër, këto hapësira janë ndarë në njësi strukturore më vete.

### **Zhvillimi ose konservimi i propozuar i zonave natyrore, bujqësore, ujore**

Mënyra e ndërhyrjes në territor është gjithashtu një faktor përcaktues i kufijve territoriale të zonave dhe njësisë strukturore. Një hapësirë e cila propozohet për konservim ka ndarje dhe kushte zhvillimi të ndryshme me një hapësirë e cila është propozuar për Rihzhillim.

### **Llojet e ndryshme të ndërhyrjeve në infrastrukturë**

Llojet e ndryshme të ndërhyrjeve në sistemin infrastrukturor, e kryesisht në infrastrukturën e transportit rrugor kanë qenë gjithashtu faktorë përcaktues të ndarjes së kufijve. Nëse një segment rrugor është propozuar për zgjerim dhe një pjesë tjetër e tij është propozuar për rikonstrukcion atëherë ato kanë kushtë të ndryshme zhvillimi dhe rrjedhimisht njësi strukturore të ndryshme.

### **Kushtëzimet e ardhura nga ligjet kombëtare dhe sektoriale**



Në zonat të cilat kanë rëndësi kombëtare siç janë Zonat e mbrojtura, pasuritë kulturore dhe të natyrës, apo elementët e tjerë përjashtues të territorit, zhvillimet kushtëzohen sipas legjislacioneve përkatëse, duke mbajtur në konsideratë edhe zonat e tyre buferike.

### **Projektet e propozuara të cilat zbërthejnë Vizionin e zhvillimit të bashkisë**

Pozicionimi strategjik në territorin e bashkisë edhe i projekteve të propozuara në dokumentin e Strategjisë Territoriale ka qenë faktor kushtëzues i ndarjes së zonave dhe njësive strukturore.

### **Elemente ndarës territorialë**

Kufizimi nga rrjeti rrugor kryesor ekzistues dhe/ose i propozuar, dhe sipas rastit edhe nga kufizues të tjerë natyralë e artificialë, të cilët krijojnë elemente me karakter qartësisht të matshëm në territor, dhe sipas rastit përfshijnë linja hekurudhore, vija ujore, lumenj, kanale të hapura, breza sanitare, dhe të tjera të kësaj natyre.

## **1.3 Përdorimi i tokës sipas kategorive, nënkategoritë dhe funksioneve**

Bazuar në mjetet metodologjike të paraqitura më lart, përkufizimet e 22 kategorive bazë të tokës janë kryer duke përdorur përcaktimet sipas VKM Nr. 686 të datës 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar. Sistemi i klasifikimit të zonave të përdorimit të tokës është analizuar më tej nëpërmjet nënkategorive brenda çdo zone të përdorimit të përgjithshëm të tokës, në lidhje me destinacionin e tij të dëshiruar. Për të siguruar realizimin e objektivave të përcaktuara në vizionin për zhvillimin e territorit, PPV përcakton gjithashtu kategoritë dhe nënkategoritë sipas përdorimit të propozuar të tokës për secilën nga njësitë strukturore të përcaktuara, si më poshtë:

*Table 2\_Kategoritë e përdorimit të tokës (Burimi: DEA Studio)*

	<b>Kategori</b>	<b>Siperfaqe Ha</b>	<b>Perqindje</b>
1	A.Banim	1528.35	3.304
2	AS.Arsim	1.69	0.004
3	B.Toke Bujqesore	11915.34	25.761
4	BA.Bujqesi + Banim	62.29	0.135
5	EB.Ekonomi Bujqesore	166.45	0.360
6	IB.Infrastruktura Bujqesore	99.43	0.215
7	IE.Industri Ekonomi	140.93	0.305
8	IEN.Infrastruktura Energjitike	7.02	0.015
9	INT.Infrastruktura Transporti	265.86	0.575
10	IS.Institucione	0.97	0.002
11	ITK.Infrastruktura Telekomunikacioni	0.17	0.000
12	IUK.Infrastruktura Ujesjelles - Kanalizime	69.00	0.149
13	M.Monumente	58.72	0.127
14	N.Toke Natyrore	31548.73	68.210
15	S.Sherbime	5.49	0.012

16	SH.Shendetesi	1.77	0.004
17	SHA.Aktivite Shoqerore & Argetimi	5.73	0.012
18	U.Ujera	351.88	0.761
19	V.Varreza	20.67	0.045
20	ZU.Zona ushtarake	2.18	0.005

Përkufizime dhe propozime të lidhura me kategoritë e përdorimit të tokës përshkruhen më poshtë:

### 1. N\_Sistemi Natyror

Nënndarjet bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti:

- Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 81, datë 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe zonat e mbrojtura të propozuara, duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij Ligji; kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen nga Ligji 8093/1996.
- Përdorimi N- Tokë natyrore, përfshin, sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin dhe biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme.

Sistemi Natyror formohet nga bashkimi i territoreve me kategori bazë përdorimi toke, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

1. **“Tokë natyrore (N)”** përfshin territoret natyrore, si: pyje, kullota, livadhe, shkurre e të tjera, të paprekura nga aktiviteti njerëzor. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: N1\_Pyje; N2\_Kullotë; N3\_Livadh; N4\_Shkurre, N5\_Tokë pa frut.
2. **“Natyre dhe argëtim (NAR)”** përfshin territoret natyrore, infrastrukturën ekologjike në funksion të aktivitetit njerëzor në natyrë, si: parqe, plazhe, shtigje dhe strukturat në funksion të ekoturizmit. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: NAR1\_Park Natyror; NAR2\_Plazh; NAR3\_Shtigje; NAR4\_Eokturizëm.

Sipërfaqet me përdorim N-Tokë natyrore, siç tregohen edhe në hartën e propozuar për përdorimin e tokës, janë të përqëndruara kryesisht në njësitë Mesopotam, Dhivër dhe pjesërisht në Livadhja. Sipërfaqen më të madhe në këtë kategori e zënë Pyjet dhe Toka pa frut. Në njësinë administrative Mesopotam, ndodhet monumenti natyror i Syrit të Kaltër dhe pjesa pyjore përreth tij e cila propozohet të kthehet në park natyror. Në njësinë administrative Aliko ndodhet Zona e mbrojtur e Parkut të Butrintit. Zhvillimi në të dy zonat përcaktohen nga legjislacioni përkatës dhe të gjithë ndarjet strukturore dhe përdorimet e lejuara të tokës vijnë sipas kufirit të miratuar të Zonës së Mbrojtur dhe përdorimeve të lejuara në të. Në të gjithë monumentet natyrore pjesë e territorit të bashkisë Finiq, është aplikuar niveli i parë i mbrojtjes. Elementë të veçantë, të tillë si shpella dhe pemët e lashta, janë përfshirë në këtë kategori.

## 2. B\_Sistemi Bujqësor

Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me tokat bujqësore.

Sistemi bujqësor përfshin këto kategori përdorimi toke, me përcaktimet respektive si më poshtë:

1. **“Bujqësi (B)”** përfshin tokat bujqësore me kultura të përhershme apo sezonale bujqësore, si dhe tokat djerrë, sipas legjislacionit përkatës. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: B1\_Kultura të përhershme; B2\_Kultura sezonale; B3\_Tokë djerrë.
2. **“Infrastrukturë bujqësore (IB)”** përfshin infrastrukturën në shërbim të aktivitetit bujqësor që mundëson vaditjen dhe kullimin e tokave bujqësore. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: IB3\_Infrastrukturë vaditjeje dhe kullimi.
3. **“Ekonomi bujqësore (EB)”** përfshin strukturat dhe infrastrukturat në funksion të ekonomisë bujqësore e blegtorale, si dhe shërbimet e agroturizmit. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: EB1\_Struktura në funksion të bujqësisë; EB2\_Struktura në funksion të Blegtorisë; EB3\_Agroturizëm.
4. **“Bujqësi - Banim (BA)”** përfshin banimin në funksion të aktivitetit bujqësor. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: BA1\_Bujqësi – Banim.

Në territorin e bashkisë Finiq, pjesë e sistemit territorial Bujqësi, mbizotëron kategoria e përdorimit të tokës B\_Tokë bujqësore me Kultura sezonale si edhe Tokë djerrë. Tokat bujqësore të bashkisë Finiq janë shumë pjellore në territoret e njësive administrative Finiq dhe Aliko. Gjatë zonimit të territorit të bashkisë, janë shtuar njësitë me përdorim toke: Bujqësi-Banim. Në këtë klasifikim janë vendosur territorit në të cilat ka ndodhur zhvillimi sporadik i ndërtesave të banimit, brenda tokës bujqësore dhe me largësi të caktuara nga njera-tjetra dhe që janë kryesisht në funksion të bujqësisë. Për arsye të këtij karakteri ato nuk mund të përfshihen brenda zonës urbane. Njësitë me përdorim toke Ekonomi Bujqësore, janë të vendosura në pjesët periferike të zonave urbane dhe afër tokave bujqësore dhe janë të përqëndruara kryesisht në pjesën jug-perëndimore të bashkisë Finiq, aty ku janë qendrat me potencial më të lartë për zhvillimin e Bujqësisë.

## 3. IN\_Sistemi Infrastrukturor

Kjo kategori i referohet të gjitha pjesëve të infrastrukturës për transportin, mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, furnizimin me ujë, naftës dhe gazit, biokarburanteve, komunikimit elektronik, furnizimit me energji elektrike, mbrojtjes së tokës nga erozioni dhe rrëshqitja dhe mbrojtjes kundër zjarrit, sipas legjislacionit të posaçëm.

Sistemi infrastrukturor përfshin këto kategori përdorimi toke, me përcaktimet respektive si më poshtë:

1. **“Infrastrukturë transporti (INT)”** përfshin infrastrukturën e transportit rrugor, hekurudhor, ujor, ajror dhe multimodal; rrjetet e përbëra nga linjat, stacionet dhe struktura të tjera në shërbim të tyre. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: INT1\_Infrastrukturë rrugore; INT2\_Infrastrukturë Hekurudhore; INT3\_Infrastrukturë Transporti Ujor; INT4\_Infrastrukturë Transporti Ajror; INT5\_Infrastrukturë Multimodale.
2. **“Infrastrukturë energjetike (IEN)”** përfshin infrastrukturën e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burime hidrike, lëndë djegëse, eolike e diellore, si dhe infrastrukturën e gazifikimit, përfshirë linjat dhe strukturat mbështetëse. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: IEN1\_Elektrike; IEN2\_Hidrike; IEN3\_Hidrokarbure; IEN4\_Eolike; IEN5\_Diellore.
3. **“Infrastrukturë telekomunikacioni (ITK)”** përfshin rrjetet, antenat dhe strukturat që mundësojnë telekomunikacionin. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: ITK1\_Stacion Telekomunikacioni; ITK2\_Antena.
4. **“Infrastrukturë e ujësjellës – kanalizimeve (IUK)”** përfshin rrjetet dhe strukturat në shërbim të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: IUK1\_Ujësjellës; IUK2\_Kanalizime.
5. **“Infrastrukturë menaxhimi mbetjesh (IMB)”** përfshin strukturat në shërbim të grumbullimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: IMB1\_Trajtim Mbetjesh; IMB2\_Depozitim Mbetjesh.

Kategoria mbizotëruese në territor përse i përket sistemit infrastrukturor është Infrastruktura e Transportit, ku mbizotëron nënkategoria e përdorimit të tokës Infrastruktura Rrugore. Në % më të vogël gjendet në përdorimin e tokës edhe kategoria Infrastrukturë Menaxhim mbetjesh, falë prezencës së venddepozitimeve ilegale të mbetjeve, të cilat janë propozuar për rehabilitim. Përse i përket infrastrukturës së Ujësjellës-Kanalizimeve dhe asaj të Telekomunikacionit ato janë linja të shtrira në tokë ose në ajër, duke sjellë që territoret ku shtrihen ato të kenë një kategori tjetër përdorimi toke, e cila zakonisht mund të jetë Infrastrukturë Transporti ose edhe pjesë e Sistemit Natyror, Bujqësor apo Urban.

#### 4. U\_Sistemi Ujor

Territoret që përfshihen në kategorinë ujëra përfaqësohen nga brigjet lumore dhe përrenj, sipas nënkategorisë. Në këto zona është rreptësisht i ndaluar çdo lloj zhvillimi.

Sistemi Ujor përfshin këto kategori përdorimi toke, me përcaktimet respektive si më poshtë:

1. **Ujëra (U)** përfshin të gjithë trupat ujorë: dete, laguna, kënetë, liqene, lumenj, përrenj e burime ujore, sipas legjislacionit përkatës. Nënkatëgoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: U1\_Det; U2\_Lagunë; U3\_Kënetë; U4\_Liqen; U5\_Lumë; U6\_Përreua; U7\_Burim Ujor.

Në territorin e bashkisë Finiq, mbizotëron nënkategoria e përdorimit të tokës Lumë, Liqen dhe Burime ujore. Bashkia Finiq është e pasur me trupa ujore si lumenjtë e: Kalasës, Bisticës, Pavlla, liqeni i Butrinitit dhe i Bisticës dhe burimi i Syrit të Kaltër. Nënkategoritë e tjera nuk gjejnë aplikim.

## 5. A\_Sistemi Urban

Sistemi Urban përfshin këto kategori përdorimi toke, me përcaktimet respektive si më poshtë:

1. **“Banim (A)”** përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: A1\_Banim; A2\_Banim dhe Shërbime.
2. **“Shërbime (S)”** përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare, akomoduese dhe zyre. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: S1\_Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi; S2\_Shërbime Tregtare dhe Biznesi.
3. **“Industri ekonomi (IE)”** përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e industrisë së lehtë e të rëndë, si dhe funksione ekonomike komplekse. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: IE1\_Industri e lehtë; IE2\_Industri e Rëndë; IE3\_Aktivitet Ekonomik Kompleks.
4. **“Institucione (IS)”** përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e administrimit publik, shërbimeve publike, sociale, diplomatike, financiare dhe fetare. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: IS2\_Shërbim Publik; IS3\_Shërbim Social; IS4\_Shërbim diplomatik; IS5\_Institucione financiare; IS6\_Institucion fetar.
5. **“Arsim (AS)”** përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e arsimit në të gjitha nivelet: parashkollor, i ulët, i mesëm dhe i lartë, sipas legjislacionit përkatës. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: AS1\_Arsim parashkollor; AS2\_Arsim i Ulët; AS3\_Arsim i mesëm; AS4\_Arsim i lartë.
6. **“Shëndetësi (SH)”** përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimit ambulator dhe spitalor, sipas legjislacionit përkatës. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: SH1\_Shërbim ambulator; SH2\_Shërbim spitalor.
7. **“Aktivitete shoqërore dhe argëtimi (AR)”** përfshin territore dhe struktura në shërbim të aktiviteteve kulturore e sportive, parqe dhe hapësira publike. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: AR1\_Hapësira publike; AR2\_Aktivitete kulturore; AR3\_Aktivitete sportive dhe rekreative.
8. **“Monumente kulturore (M)”** përfshin territore dhe struktura, pjesë të trashëgimisë kulturore dhe historike. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: M1\_Monumente kulture.
9. **“Zona ushtarake (ZU)”** përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet ushtarake, sipas legjislacionit përkatës. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: ZU1\_Infrastrukturë ushtarake.
10. **“Varreza (V)”** përfshin territoret dhe strukturat në shërbim të varrezave. Nënkategoritë e kësaj kategorie përdorimi toke janë: V1\_Varrezë; V2\_Varrëzë dëshmorësh; V3\_Memorial.

Zonat Rezidenciale përbëjnë dhe pjesën më të madhe të territorit të urbanizuar të Bashkisë së Finiqit, duke përfshirë këtu zonat e shtëpive parësore dhe dytësore. Zonat rezidenciale përfshijnë një shumëllojshmëri tipologjish:

- Zonat ekzistuese urbane;
- Zonat e zgjeruara të propozuara për qendra urbane, për të mundësuar mbulimin e nevojave për zhvillim në të ardhmen;

Përdorimi i tokës dhe i strukturave në të për shërbime (S1), (S2), përfshin ato zhvillime të lejuara që bëhen për ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturave përkatëse, dhe ku sipas rastit jo më shumë se 10% e zonës dhe strukturave të saj shfrytëzohet për qëllime banimi, sipas sipërfaqes së ndërtimit.

Monumentet e trashëgimisë kulturore me vlerë të jashtëzakonshme rregullohen me anë të një zonimi të veçantë hapësinor dhe udhëzime shoqëruese, të nxjerra sipas Ligjit 9048/2003. Zona tampon e ruajtjes së pejzazhit prej 250 m, është për të siguruar ekzistencën e monumenteve të regjistruara si të tilla, duke iu referuar Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

Zonat me aktivitete ekonomike industriale krijojnë tipin e tretë të kategorisë së përgjithshme të përdorimit të tokës, që përfshin të gjitha zonat e urbanizuara të territorit të bashkisë Finiq. Këto zona i përkasin aktiviteteve ekonomike që nuk duhet të shtrihen në zonat rezidenciale dhe/ose zonat për zhvillimin e turizmit.

Arsimi përfshin të gjitha trojet e rezervuara për institucionet arsimore apo institucionet ndihmëse në funksion të arsimit, ekzistuese dhe të propozuara. Propozimet, siç shpjegohen në kapitullin përkatës të këtij dokumenti, janë bërë duke u bazuar mbi analizën e gjendjes ekzistuese dhe evidentimin e nevojave për planifikimin e infrastrukturës arsimore, bazuar në parashikimet ligjore të VKM nr.686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar dhe legjislacionin sektorial përkatës. Në shumë raste duhet patur parasysh që sipërfaqja e trojeve të rezervuara për institucionet arsimore është disa herë më e vogël sesa sipërfaqja minimale e njësive strukturore të cilat përfshijnë edhe përdorime të tjera toke si Banim (A), Shërbime (S), etj.

Shëndetësia përfshin të gjithë sipërfaqet territoriale të rezervuara për institucionet shëndetësore apo strukturat ndihmëse në funksion të tyre.

Strukturat dhe territoret që përfshihen në kategorinë të veçanta, janë zona e varrezave publike, të dëshmorëve dhe varrezat e fshatrave, me kodin (V.1). Këto zona shoqërohen gjithmonë me zonën mbrojtëse buferike.

Nënkategoritë e mësipërme, përsa I përket territorit të bashkisë Finiq, janë të shpërndara si më poshtë:

Table 3\_Nënkategoritë e përdorimit të tokës (Burimi: DEA Studio)

	<b>Nënkategori_1</b>	<b>Siperfaqe Ha</b>	<b>Perqindje</b>
1	A1-Banim	1031.36	2.23
2	A2-Banim dhe Sherbime	496.99	1.07
3	AR1-Hapesira Publike	3.76	0.01
4	AR2-Aktivitete Kulturore	0.22	0.00
5	AR3-Aktivitete Sportive	1.75	0.00
6	AS1-Arsim Parashkollor	0.39	0.00
7	AS2-Arsim i Ulet	0.87	0.00
8	AS3-Arsim i Mesem	0.43	0.00
9	B1-Kultura te Perhershme	1652.89	3.57
10	B2-Kultura Sezonale	10262.45	22.19
11	BA1-Bujqesi - Banim	62.29	0.13
12	EB1-Struktura ne Funkcion te Bujqesise	103.52	0.22
13	EB2-Struktura ne Funkcion te Blegtorise	47.19	0.10
14	EB3-Agroturizem	15.73	0.03
15	IB3-Infrastruktura Vaditje dhe Kullimi	99.43	0.21
16	IE1-Industri e Lehte	47.31	0.10
17	IE2-Industri e Rende	29.19	0.06
18	IE3-Aktivitet Ekonomik Kompleks	64.43	0.14
19	IEN1-Elektrike	0.00	0.00
20	IEN2-Hidrike	7.02	0.02
21	INT1-Infrastruktura Rrugore	265.86	0.57
22	IS2-Sherbim Publik	0.43	0.00
23	IS6-Institucione Fetare	0.54	0.00
24	ITK2-Antena	0.17	0.00
25	IUK1-Ujesjelles	23.73	0.05
26	IUK2-Kanalizime	45.27	0.10
27	M1-Monument Kulture	58.72	0.13
28	N1-Pyje	12455.80	26.93
29	N2-Kullote	291.12	0.63
30	N3-Livadh	729.03	1.58
31	N4-Shkurre	1379.56	2.98
32	N5-Toke pa frut	16693.22	36.09
33	S1-Sherbime Akomodim dhe Argetimi	0.72	0.00
34	S2-Sherbime Tregtare dhe Biznesi	4.77	0.01
35	SH1-Sherbim Ambulator	1.77	0.00
36	SH2-Sherbim Spitalor	0.00	0.00
37	U2-Lagune	0.00	0.00

38	U4-Liqen	213.60	0.46
39	U5-Lume	138.28	0.30
40	V1-Varreze	20.67	0.04
41	ZU1-Infrastruktura Ushtarake	2.18	0.00

#### 1.4 Zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare

Në bashkinë e Finiqit gjenden një sërë zonash dhe objektesh të rëndësisë kombëtare. Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare, sipas përcaktimeve të nenit 7 dhe 9 të ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe nenit 30 dhe 31 të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, përcaktohen nga Planet Kombëtare dhe/ose me miratim të KKT-së. Çështjet e rëndësisë kombëtare në territorin e bashkisë Finiq janë:

**Monumentet e natyrës dhe pasuritë kulturore**, të cilat mbrohen nga legjislacioni i posaçëm për mënyrën e shfrytëzimit do të marrin rëndësinë e duhur në mënyrën e trajtimit në këtë Plan. Respektimi i zonave buferike dhe rrezeve të përcaktuara për mbrojtjen nga ndërtimet të këtyre monumenteve do të pasqyrohet në hartat, platformën GIS dhe në trajtimin e përdorimit të tokës.

**Pyjet** dhe shërbimi pyjor për tokën, për turizmin, për kullotat e livadhet për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe për mjedisin, mbrohet dhe rregullohet nga legjislacioni i posaçëm. Gjithashtu ruajtja e tokës bujqësore është parësore në trajtimin e këtij Plani, sidomos e tokës pjellore sipas legjislacionit të posaçëm për tokën bujqësore

**Varrezat, zonat ushtarake, objektet arsimore dhe shëndetësore** janë përdorime të cilat përjashtohen nga zhvillim dhe planifikimi i zhvillimit territorial të tyre bëhet duke respektuar legjislacionin e posaçëm. Bashkia Finiq ka dy zona industriale të shpallura: Zona industriale e Vrionit dhe Zona industriale e Finiqit.

Çdo zhvillim në **brigjet ujore**, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm dhe ky plan. Duhet mbrojtur burimet ujore të cilat përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm, këto territore kanë zonë buferike brenda së cilës është e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveç ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujqor. Ndërtimi i veprave dhe i objekteve për shfrytëzimin e burimeve ujore dhe për parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit janë objekt i lejeve administrative ose koncesioneve. Është i ndaluar magazinimi i materialeve dhe lëndëve, që mund të shpëlahen në ujë dhe ndërtimi i objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet. Finiqi laget nga: Liqeni I Butrintit, Lumi I Bisticës, Kalasës, Pavllës, Navaricës.



Në shtratin e lumit të Kalasës, Bisticës dhe Pavllës në brigjet ujore të saj ka **rrjete ekologjike** ku rriten specie të florës si: Rrapi, Shelgu, Arra, dhe ato të faunës shpendë të ujit si: Rosa e egër, pata e egër, lejleku, pulbardha, shapka etj. Po këto specie të faunës gjenden dhe në Liqenin e Butrintit.

**Infrastrukturat** gjithashtu mbrohen nga zhvillimi, si dhe rezervohet territori i mjaftueshëm në raste të parashikimeve apo projeteve për zgjerimin e tyre si psh rrugët, antenat, digat, rezervuaret etj. Bashkinë Finiq e përshkojnë këto akse rrugore kombëtare: Rruga nacionale Sarandë – Qafë Muzinë, Metoq – Konispol, Sarandë – Delvinë, Xarrë – Pllakë, Blerimas – Çlirimas. Bashkia Finiq ka 4 burime energjitike, hidrocentrale të cilat janë në funksionim.

#### **1.4.1 Trashëgimia natyrore**

Bashkia Finiq paraqet një larmishmëri asetesh natyrore. Në territoret e bashkisë Finiq gjendet një Park Kombëtar dhe një Rezervat Strikt Natyror, dhe një sërë monumentesh natyre. Sugjerohet shpallja e një zone të mbrojtur buferike përreth monumenteve natyrore, për të garantuar ruajtjen e peizazhit të paprekur nga ndërtimet, së paku 150 m nga monumenti.

Më poshtë janë listuar asetet e shpallura monument natyre.

- **Parku Kombëtar i Butrintit**
- **Rezervati Strikt Natyror i Kardhiqit**
- **Monument natyre**
  - o Syri i kaltër
  - o Rrapi i Muznës
  - o Rrapi i Dhivrit
  - o Rruga e Gjarpërit
  - o Ujëvara e Kardhiqit
  - o Valanidhet e Dhrovjanit
  - o Bokërrimat e Muzinës
  - o Kanioni I Leshnicës
  - o Pylli I Kardhikaqit

#### **1.4.2 Trashëgimia kulturore dhe zonat mbrojtëse**

Zona e Bashkisë së Finiqit paraqet një sërë zonash dhe territoresh me gjurmë të rëndësishme historike. Vlejnë për t'u përmendur qytetet antike si Qyteza dhe Kalaja e Ripësit në fshatin Zminec, Qyteza e Paleomanastrës (Midis Zminecit dhe Karroq) apo Tempulli antik i Dobrit. Gjithashtu vlerë të madhe i shtojnë ndërtimet Fortifikuese të shpërndara pothuajse në të gjithë

territorin; banesat tradicionale dhe ndërtime të tipit “Ura” apo “Puse”, si Pasuri e Paluajtshme me karakteristika të veçanta inxhinierike e arkitekturore të zonës.

Për të bërë të mundur ruajtjen e vlerave mjedisore, kulturore e peizazhistike të një sërë pasurish kulturore, lind nevoja e mbrojtjes së territorit përreth këtyre objekteve.

Për këtë, zona mbrojtëse e të gjitha pasurive të shpallura, e cila përbën: “Territorin e përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, ansamblit arkitektonik/urban, kompleksit arkitektonik dhe pasurisë kulturore, roli i së cilës është mbrojtja e vlerave të këtyre pasurive kulturore dhe sigurimi i dritës, perspektivës, peizazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku” duhet të vlerësohet nga institucionet përgjegjëse.

Në rastet kur zona mbrojtëse, apo e njohur ndryshe si zona buferike, si edhe distancat janë të përcaktuara nga instituti përgjegjës, atëherë është ajo fashë dhe distancë që duhet të respektohet.

Kriteret e vlerësimit të zonës së përcaktuar për secilin pasuri kulturore më poshtë është bërë në varësi të vlerave të secii objekt, si dhe të vendndodhjes së tij në territor. Në rastet kur objekti merr rëndësi si pjesë e një sistemi natyror e kulturor më të gjërë, është e nevojshme që edhe zonë mbrojtëse e tij të jetë më e madhe, duke marrë një shtrirje më të gjërë në territor dhe duke bërë pjesë të kësaj zone territoriale kodrinore, bimësinë e veçantë e ndodhur pranë objekteve si dhe elementë të tjerë me vlera të veçanta. Mbrojtja e kësaj zone i shton vlerat vetë objektit, si pjesë e një peizazhi kulturor.

Sipas Ligjit në fuqi Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore të miratojë, brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, parashikimet në lidhje me zonën mbrojtëse, distancat, masat dhe normat e tjera që ruajnë integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme, të veçanta, perspektivën ose dritën apo kushtet mjedisore dhe peizazhin, në zbatim të pikës 1, të nenit 96, të këtij ligji.

Në këtë plan propozohen disa zona mbrojtëse si më poshtë. Sidoqoftë, për secilën prej tyre duhet bërë studimi i detajuar nga institucionet përkatëse dhe ekspertët e emëruar, siç është dhe e parashikuar në ligjin e ri, përmendur më lart.

Nevoja për përcaktimin e zonave buferike:

- Qyteza dhe Kalaja e Rripësit (Fshati Zminec)
- Qyteza e Paleomanastrës (Midis Zminecit dhe Karroq) Fshati Karroq
- Shpella e Shën Marenës, në fshatin Vagalat
- Tempulli antik i Dobrit
- Kalaja e Malçanit ose Qyteza antike në Malçan
- Kalaja e Shën Gjinit, vendbanim i fortifikuar
- Kalaja në malin Ilias

- Shpella e Shën Gjergjit në fshatin Dhivër

Propozime për zona buferike deri në oborrin rrethues të pasurisë kulturore ose deri në rrugët që e kufizojnë atë:

- Kisha e Manastirit të Shën Marisë, Dhivër (oborri)
- Kisha e Manastirit të Shën Thanasit në Leshnicë të Poshtme (oborri)
- Kisha e Shën Gjergjit në Leshnicën e Sipërme (oborri)
- Kisha e Shën Kollit në Dhrovjan (oborri)
- Kisha e Shën Thanasit në Sopik (oborri)
- Kisha e Manastirit të Shën Kollit në fshatin Dhivër (oborri)
- Kisha e Shën Kollit në Dhrovjan (oborri)
- Kisha e Shën Marisë në fshatin Malçan
- Kullat e Manastirit të Theollogos, midis fshatrave Partizan e Malçan
- Banesa e Evro e Amalia Koçolenit në Dhrovjan të Poshtëm
- Banesa e Vasil Zhupës në Dhrovjan të Sipërm
- Banesa e Jorgji dhe Koço Agorës në Dhrovjan të Sipërm
- Banesa e Foto Konomit në fshatin Sirakat
- Banesa e Aristidh Llocit dhe Peço Manelit në Pecë
- Banesa e Gaqo Papait në fshatin Sopik
- Banesa e Kristo Mitropullit në fshatin Rumanxa
- Banesa në fshatin Vagalat
- Banesa e Petro Shekës

Në rastet kur objektet me status Monument Kulture, nuk kanë zonë të mbrojtur, janë subjekt i i urdhrit të Ministrisë të Kulturës, Urdhër Nr. 297, dt. 31.07.2015 “Për Shpalljen e Zonave të Mbrojtura të Monumenteve të Kulturës”. Për Pasuritë Kulturore me status “Monument Kulture” të përmendura më sipër, janë shpallur Zonat Mbrojtëse përreth, sipas Urdhërave të veçantë nga institucionet përgjegjëse, dhe duhet të zbatohen sipas përcaktimeve të tyre.

### **1.4.3 Parashikime dhe udhëzime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore**

Në Bashkinë Finiq ka pasuri kulturore të shumta që njihen si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore, duke i shtuar kësaj të fundit vlera të paçmueshme të cilat duhen ruajtur për t'i lënë trashëgimi brezave pasardhës. Bashkia duhet të ndërmarrë një seri veprimesh të nevojshme për mbrojtjen e këtyre pasurive, në bashkëpunim me institucionet përkatëse në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Përgjithsisht të gjitha pasuritë kulturore të kësaj bashkie kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, ruajtja në të ardhmen dhe arritshmëria

publike njihen nga PPV-ja si një hap i domosdoshëm për të arritur potencialin turistik të të gjithë rajonit si dhe për të garantuar ruajtjen e historisë dhe identitetit lokal.

Projektet e rehabilitimit të pasurive kulturore, të cilat kryhen në bashkëpunim me institucionet dhe agjencitë që merren me proceset e rehabilitimit dhe ruajtjes, pasi është e rëndësishme që një proces i tillë të kryhet nga teknikë dhe punëtorë me përvojë. Hapat që duhet të ndërmerren gjatë procesit mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Hartimi i projektit të rehabilitimit bazuar në një rilevim dhe studim të kujdesshëm të objekteve, duke përfshirë planin e mirëmbajtjes së tyre;
2. Bazuar në projektin e rehabilitimit të hartuar, duhet të kërkohet bashkëpunimi i mundshëm dhe mundësitë e financimit për të garantuar realizueshmërinë e punës;
3. Pasi të sigurohet financimi, projekti i rehabilitimit duhet të tenderohet dhe vetëm operatorët e specializuar duhet të pranohen të marrin pjesë, nën mbikqyrjen e pavarur të ekspertëve të emëruar;
4. Pas fazës së ndërtimit / rehabilitimit, bashkia dhe / ose grupet e tjerë të interesit duhet të garantojnë që mirëmbajtja e nevojshme të kryhet gjatë viteve të ardhshme.

### **Hartimi i një Udhëzuesi për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve me rëndësi në trashëgiminë kulturore**

Fshatrat pjesë e territoreve të bashkisë Finiq paraqesin vlera të jashtëzakonshme historike e kulturore në metodën ndërtimore, vlerat unike dhe pasuritë si ansamble urbane. Si të tillë, është e nevojshme të hartohet një kod ndërtimi për këto vendbanime, i do të garantojë ruajtjen e vlerave dhe promovimin e tyre në funksion të zhvillimit të turizmit. Ky udhërrëfyes duhet hartuar nga bashkia Finiq, me mbështetjen e institucioneve përkatëse qendrore të trashëgimisë kulturore dhe duhet miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Sugjerohet që hartimi i këtij udhëzuesi të zhvillohet në bashkëpunim me bashkitë Dropull dhe Gjirokastër, për shkak të ngjashmërisë së metodës ndërtimore.

#### **1.4.4 Mbrojtja dhe ruajtja e pasurive kulturore të palujtshme**

Në bashkinë Finiq gjenden një sërë objektesh që kanë një rëndësi të veçantë si pjesë e një trashëgimie të larmishme të përbërë nga gjetjet arkeologjike të kohërave nga antikiteti e deri në mesjetë. Për këtë arsye, është e nevojshme që disa prej këtyre objekteve të restaurohen dhe rhabilitohen për t'i dhënë atyre funksion të plotë dhe për t'i kthyer në asete të vlefshme në shërbim të zhvillimit turistik të qendrueshëm.

Falë pozitës tepër të favorshme të bashkisë, mes kurorave të maleve rrethuese, lumit të Bisticës dhe Parkut të Butrintit, territoret e bashkisë Libohovë përfitojnë një sërë atributesh të lidhura ke numrin e lartë të Monumenteve Kulturore, veçanërisht kisha dhe vendbanime të fortifikuara si dhe një numër i konsiderueshëm Monumente Natyrore. Finiqi, ishte kryeqendra e Kaonisë dhe në vitin 234/2 p. Kr. bëhet kryeqyteti i Koinonit të Epirit. Për këtë arsye dhe për shkak të pozicionit të tij gjeografik, lujati një rol të rëndësishëm në zhvillimet politike që ndoqën fundin e luftës së parë maqedono-romake (215- 205 para Kr.) Me imponimin e Pax Romana, në qytet u realizuan një radhë veprash ndërtuese të cilat përfshinin edhe rikonstruktimin e ndërtesave me karakter social. Atëhere sipërfaqja e qytetit tejkaloi kufijtë e ngushtë të akropolit dhe u përhap në rrëzët e kodrës.

Objektet e kultit dhe veçanërisht kishat janë një ndër elementët më karakteristikë të kësaj zone. Disa prej tyre datojnë që prej shekullit të 14 e disa të tjera janë ndërtuar mbi tempuj të dikurshëm paganë, si rasti i Tempullit të Dobrit. Në territoret e kësaj bashkie ndodhen gjithashtu disa ura prej guri me vlera të jashtëzakonshme dhe që dëshmojnë për zhvillimin e hershëm të kësaj zone. Gjithashtu, në bashkinë Finiq gjenden një sërë vendbanimesh tradicionale historike të cilat paraqesin vlera arkitektonike të veçanta. Disa nga këto vendbanime janë Qyteza dhe Kalaja e Rripësit në fshatin Zminec, Qyteza e Paleomanastrës (Midis Zminecit dhe Karroq)si dhe zona arkeologjike e vetë qytetit antik të Finiqit. Për të garantuar mbrojtjen e këtyre zonave, është e rëndësishme që këto vendbanime historike të sigurohen me një zonë mbrojtëse prej 500 m në mënyrë që të mbrohet vendosja e tyre natyrore. Për të garantuar mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave, lind nevoja për projektet si më poshtë:

Ndërhyrje minimale sidomos në mirëmbajtje të mureve, sistemim të vegjetacionit në zonat përreth, sistemim të sinjalistikës informuese dhe infrastrukturës:

- *Qyteza dhe Kalaja e Rripësit (Fshati Zminec)*
- *Qyteza e Paleomanastrës (Midis Zminecit dhe Karroq) Fshati Karroq*
- *Shpella e Shën Marenës, në fshatin Vagalat*
- *Tempulli antik i Dobrit*
- *Kalaja e Malçanit ose Qyteza antike në Malçan*
- *Fortifikimi i Vagalatit ose Kalaja e Vagalatit*
- *Kisha e Manastirit dhe Manastiri i Shën Kollit në Mesopotam*
- *Kisha e Manastirit të Shën Marisë, Dshivër*
- *Kisha e Manastirit të Shën Kollit në fshatin Dshivër*
- *Shpella e Shën Gjergjit në fshatin Dshivër*
- *Kisha e Manastirit të Shën Thanasit në fshatin Pecë*

- *Kisha e Shën Mërisë, Pecë*
- *Kisha e Shën Gjergjit në Leshnicën e Sipërme*
- *Kisha e Manastirit të Shën Triadhës në fshatin Kardhikaq*
- *Kisha e Shën Kollit në Dhrovjan*
- *Kisha e Shën Thanasit në Sopik*
- *Manastiri i Shën Mërisë në Shpellën e Kostarit*
- *Kisha e Shën Marisë në fshatin Malçan*
- *Banesa e Evro e Amalia Koçolenit në Dhrovjan të Poshtëm*
- *Banesa e Vasil Zhupës në Dhrovjan të Sipërm*
- *Banesa e Jorgji dhe Koço Agorës në Dhrovjan të Sipërm*
- *Banesa e Foto Konomit në fshatin Sirakat*
- *Banesa e Gaço Papait në fshatin Sopik*
- *Banesa në fshatin Vagalat*
- *Ura në Leshnicë e Poshtme*
- *Ura në Leshnicën e Sipërme*
- *Ura e Cerkovicës*
- *Puset e Vjetra të Dhrovjanit*

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar ndaj pasurive kulturore të poshtë listuara, duke qenë se gjendja e tyre aktuale është kritike dhe në rrezik shembjeje, duke çuar në një humbje të vlerave të mëdha arkitektonike, kulturore dhe historike të zonës së bashkisë Finiq:

- *Kalaja e Shën Gjinit, vendbanim i fortifikuar*
- *Kalaja në malin Ilias*
- *Kisha e Manastirit të Shën Thanasit në Leshnicë të Poshtme*
- *Kisha e Shën Thanasit në Muzinë*
- *Rrënojat e Kishës Së Shën Mëhillit, Kostar*
- *Banesa e Aristidh Llocit dhe Peço Manelit në Pecë*
- *Banesa e Kristo Mitropullit në fshatin Rumanxa*
- *Banesa e Petro Shekës*
- *Kullat e Manastirit të Theollogos, midis fshatrave Partizan e Malçan*

#### **1.4.5 Udhëzime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jo monument**

Për ndërhyrjet në objektet të cilat kanë statusin Monument Kulture, lind detyrimi ligjor për të ndjekur kuadrin ligjor dhe rregulloret në fuqi. Ndërsa për ndërhyrjet në objektet jo monument kulture, por të cilat kanë rëndësi të veçantë si bartëse të vlerave historike e kulturore, apo si pjesë e ansambleve të caktuara historike e vendbanimeve tradicionale duhet të ndjekin rekomandimet e mëposhtme:

##### **Objektet me rëndësi të veçantë historike e kulturore (pjesë e vendbanimeve tradicionale)**

1. Ndërtimet e reja apo rikonstrukcionet e objekteve ekzistuese pranë strukturave me rëndësi historike e kulturore, brenda ose jashtë vendbanimeve tradicionale, duhet të bëhen me të njëjtat materiale si strukturat ekzistuese. Këto materiale tradicionale janë guri vendas për muret, druri si element strukturor në muraturë si dhe për dyert e dritaret dhe rrasat e gurit për çatinë. Materialet duhet t'i përafrohen sa më shumë atyre tradicionale por duhet shmangur me çdo kusht mimetizimi i objekteve ekzistuese. Ndërtimet e reja duhet të reflektojnë qartë kohën e ndërtimit të tyre.
2. Lartësia e strukturave të reja ose e objekteve të rikonstruara brenda vendbanimeve tradicionale nuk duhet të kalojë lartësinë maksimale të objekteve ekzistuese (kryesisht, lartësia ekzistuese është 2-3 kate).
3. Ndërtimet e reja në vendbanime tradicionale duhet të ruajnë proporcionet e objekteve ekzistuese përreth. Duhet shmangur ndërtimet masive, të cilët kanë shtrirje të gjërë duke dëmтуar peizazhin si dhe pamjen karakteristike të vendbanimit apo peizazhit. Ndërtesa më të mëdha mund të krijohen duke grupuar disa ndërtesa më të vogla me lidhje të brendshme mes tyre.
4. Objektet ekzistuese duhet të ruajnë elementët e tyre karakteristikë. Nuk duhet lejuar përdorimi i materialeve të reja në rikonstrukcionin e tyre (si psh. beton-arme për muraturat, duralumin për dyert/dritaret si dhe duhen shmangur struktura metalike). Nuk duhen ndrshuar proporcionet ekzistuese: madhësia e dritareve, dyerve, si dhe pjerrësia e çative. Nëse do të bëni ndryshime në fasadë, ato duhet t'i përshtaten përmasave tradicionale të dyerve, dritareve dhe elementëve të tjerë.
5. Për dyert dhe dritaret e objekteve në vendbanime tradicionale, materiali i rekomanduar është druri. Duhet ruajtur dhe rindërtuar (aty ku është nevoja) qemerët ekzistues.
6. Nuk rekomandohet ndryshimi i strukturës së fasadave historike, duke mbyllur ose hapur dyer dhe dritare të reja apo ndërtuar elemente të reja (p.sh. Ballkone, strehë, shtesa) ose duke hequr elementet historike ekzistuese.
7. Në fasada, nuk rekomandohet përdorimi i ngjyrave të forta ose neon në fasadat e objekteve të vendbanimeve tradicionale, sepse jo vetëm kanë shkëlqim verbues, por edhe dëmtojnë

dukshmërinë harmonike të rrugës dhe fshatit. Në rast se do të përdoren ngjyra, rekomandohet të bëhet në mënyrë të tillë që të ketë untiet dh harmoni në pamjen e përgjithshme të këtyre vendbanimeve. Ornamentet në gur në fasada, të cilat janë një tipar karakteristik i këtyre fshatrave dhe pjesë e rëndësishme e mureve të jashtme, duhet të trajtohen me kujdes dhe me njohuritë e nevojshme.

8. Rekomandohet përdorimi i bimësisë karakteristike të zonës dhe shmangia e kulturave të reja.
9. Në rastet kur lind nevoja për të ndryshuar funksionin e një ndërtese në një biznes turistik, elementet e brendimit, si p.sh. tabelat, duhen përdorur në mënyrë të kujdesshme, veçanërisht kur kemi të bëjmë me ndërtesa historike. Tabelat e dyqaneve duhen vendosur vetëm në fasadën e kateve përdhe dhe duhet të kenë madhësi proporcionale me objektin ekzistues. Sugjerohet përdorimi i materialeve si druri, dhe metali.
10. Këshillohet të përdoren teknika të përforsimit të përkohshëm aty ku nuk janë të mundura riparimet e menjëhershme dhe të nxiten banorët për të mbrojtur këtë pasuri me anë të incentivave të caktuara sidomos në vendbanime me vlera arkitekturore.
11. Objektet e reja duhet të garantojnë ruajtjen e ansamblit urban tradicional dhe të mos kthehen në kërcënim për humbjen e vlerave tradicionale historike të këtyre objekteve. Në çdo rast, peizazhi arkitektonik duhet mbrojtur dhe promovuar.
12. Duhet krijuar mundësi për të incetivizuar banorët për ruajtjen e vlerave të këtyre objekteve dhe vendosjen e tyre në funksion të turizmit.
13. Nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit për pasuritë që këto objekte paraqesin dhe mundësinë e shfrytëzimit të tyre në funksion të zhvillimit të turizmit bazuar në historinë dhe vlerat lokale, Bashkia duhet të garantojë mbrojtjen dhe promovimin e vazhdueshëm të këtyre objekteve.

### **Hapësirat publike**

1. Sheshet kryesore të vendbanimeve tradicionale duhen mbrojtur dhe duhen parashikuar projekte për rehabilitimin e tyre. Per rindërtimin e tyre duhen përdorur gurë tradicionalë. Të gjithë elementët përbërës të sheshit, të cilët i shtojnë vlerat historike duhen mbrojtur, rehabilituar dhe aty ku është e nevojshme rindërtuar. Për ndërhyrjet në sheshet e vendbanimeve duhen bërë konsultimet e nevojshme me materialet ekzistuese arkivore, si foto apo shkrime, duhet bërë një proces konsultimi me banorët e zonës si dhe duhet ndjekur nga institucionet përgjegjëse dhe ekspertët përkatës. Elementë të tillë janë: Rrapi i fshatit; objekte publike që vendosen në shesh si kisha/xhamia, bufeja e fshatit, shkolla dhe muzeu apo qendra kulturore; si dhe kroi i fshatit.



2. Nuk duhet shkatërruar kalldrëmi ekzistues në vendbanimet tradicionale por duhet mbrojtur e rehabilituar. Gurët për kalldrëm duhet të jenë nga guroret pranë fshatit. Nuk duhet përdorur beton për shtrimin, por rërë, në mënyrë që uji të mund të filtrojë.
3. Duhet ruajtur struktura ekzistuese e rrugëve e rrugicave ekzistuese si pjesë e ansamblit historik të fshatit. Çdo ndërhyrje e re duhet të reflektojë qartazi periudhën në të cilën është bërë.

#### **1.4.6 Ligji i ri për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë**

Ligji i ri Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, i miratuar më 27 qershor 2018, parashikon disa ndryshime në qasjen ndaj trashëgimisë kulturore. Qëllimi i këtij ligji është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitja e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore.

Në këtë ligj parashikohen gjithashtu disa ndryshime në terminologji. Më specifikisht, ndryshon terminologjia si më poshtë:

1. Monument Kulture ndryshon në Pasuri kulturore e paluajtshme.
2. Instituti i Monumenteve të Kulturës ndryshon në: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK).
3. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare ndryshon në Drejtoria rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK)

Për sa i përket intensitetit të ndërhyrjes, pasuritë kulturore të paluajtshme ndahen në monumente kulture të kategorisë I dhe të kategorisë II, sipas përkufizimeve të këtij ligji (neni 54, pika 4).

#### **1.4.7 Propozime për shpalljen e monumenteve të kulturës**

Zona e Bashkisë së Finiqit paraqet një sërë zonash dhe territoresh me gjurmë të rëndësishme historike. Vlejnë për t’u përmendur ndërtime të tipit fortifikime, elemente me karakteristika të veçanta inxhinierike e arkitekturore të zonës, që i kanë jetuar kohës dhe janë në gjendje të mirë por që kanë nevojë për mirëmbajtje për t’u kthyer në elemente që dëshmojnë ekzistencën e periudhave të rëndësishme të historisë në ato territore.

Më poshtë listohen disa fortifikime prehistorike që kanë nevojë për një vëmendje nga ana e institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, duke marrë në konsideratë sidomos karakterin e tyre të veçantë historik e arkitektonik, në mënyrë që të shpallen Monument

Kulture. Propozimet për shpallje Pasuri Kulturore i nënshtrohen Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” sipas Kreu II- Verifikimi dhe deklarimi i interesit kulturor dhe regjistrimi i pasurisë kulturore, Seksioni I- Verifikimi, Neni 62.

- **Fortifikimi prehistorik i Navaricës**

*Nuk është në listën e monumenteve të mbrojtura*

Është i vendosur mbi kodrën e quajtur nga vendasit “Panaje” në verilindje të fshatit, pranë të cilit ndodhet rruga natyrore që e lidh me Dropullin e Sipërm, dhe rrethon një sipërfaqe 1ha në formë eliptike me gjatësi rreth 200 m e gjerësi 2-2.5m

Muri është ndërtuar me dy këmisha. Trakti me i mirë është ruajtur në anën veriore me lartësi 1.5 m. Hyrja e vetme e vendbanimit ndodhet në anën veriore dhe është trajtuar si hyrje ballore me gjerësi 1.9 m. Nga verifikimi në vend i të dhënave për fortifikimin e Navaricës (siç duket i dëmtuar) rezulton se planimetria e marrë me GPS ka ndryshim të madh me atë të dhënë më parë. Në ndërtimin e faqeve të murit vendosja e gurëve ndjek rregullin ku pjesët më të gjera (me volum më të madh) krijojnë faqet e tij duke krijuar edhe fuga midis tyre. Hyrja është e vendosur më shumë nga lindja dhe rezulton në anën e kundërt të skicës planimetrike të dhënë. Gjerësia e murit lëviz nga 2 – 2.2 m Hapësira brenda mureve është shumë më e vogël se 1 ha. Në anën lindore të fortifikimit në një kodër më të ulët e të butë u konstatuan gjurmë të qarta të dy banesave njëra me formë të rrumbullakët (me diametër 2.5 – 2.7 m) e tjetra me formë drejtkëndëshe (me brinjë 2.5 x 4.5 m) Të dy banesat ndodheshin në anën perëndimore të sheshit që krijohet në syprinën e kodrës. Ato përfshihen brenda një “oborri” në formën e një kuadrati të madh , linjat e të cilit konturohen nga gurë të vendosur njëri pas tjetrit. Forma të tilla banesash janë gjetur brenda ose jashtë fortifikimeve edhe në vendbanime të tjera prehistorike. Nuk u gjet qeramikë në sipërfaqe, por gërmimi i tyre në të ardhmen mund të zbulojë banesa të tjera dhe mund të sqarojë kohën e ngritjes dhe përdorimit të fortifikimit dhe banesave.

Sugjerohet mbrojtja e territoreve përreth fortifikimit, për të mbrojtur vlerat e veçanta peizazhistike dhe pamjes panoramike të territorit ku ndodhet objekti. Në rast të rehabilitimi të objektit, i gjithë territori do të ofrojë një peizazh të jashtëzakonshëm kulturor. Kjo zonë duhet të jetë së paku deri në 150 metra.



Fig. 1: Foto Fortifikimi prehistorik i Navaricës

- **Fortifikimi i Pecës**

*Nuk është në listën e monumenteve të mbrojtura*

Rolin kontrollues të rrugëve të komunikimit që kalojnë nga Qafa e Muzinës në drejtim të veriut e perëndimit duket se e ka luajtur edhe fortifikimi i Pecës i cili ruhet pak për shkak të dëmtimeve të shumta, kryesisht nga punimet ushtarake të kryera para viteve 90 të shekullit XX. Megjithatë, në fortifikimin e Pecës, mund të ndiqen linjat e rrafshuara të murit me gjerësi 2m deri në afërsi të sipërfaqes së terrenit. Në një kohë më të vonë, muri rrethues është reduktuar në gjerësi nga 2 m në 1 m. Forma planimetrike e rrethimit është pak a shumë ovale duke ndjekur terrenin e kodrës. Hyrja e vetme e dukshme e fortifikimit e cila nuk ruhet e plotë, ndodhet në anën veri perëndimore. Brenda fortifikimit në anën jugperëndimore dallohen gjurmët e mureve të një ambienti katërkëndësh, me sa duket banesë e periudhës antike. Për të mundësuar nxjerrjen e të dhënave të tjera dhe për të kuptuar më shumë për vendbanimin, u ndërморën disa sondazhe të cilat dhanë qeramikë të antikitetit të vonë e mesjetës. Ndoshta në prehistori fortifikimi ka pasur funksion vetëm mbrojtës dhe vendbanimi të ketë qenë diku në territorin e sotëm të fshatit Pecë, ku janë gjetur gjurmë të epokave të gurit. Kështu në territorin e Kishës së Shën Thanasit (sot monument kulture) u grumbullua material stralli që përbehej nga ashkla e vegla tipologjikisht paleolitikë - mezolitike.

Sugjerohet mbrojtja e territoreve përreth fortifikimit, për të mbrojtur vlerat e veçanta peizazhistike dhe pamjes panoramike të territorit ku ndodhet objekti. Në rast të rehabilitimi të objektit, i gjithë territori do të ofrojë një peizazh të jashtëzakonshëm kulturor. Kjo zonë duhet të jetë së paku deri në 150 metra.

- **Fortifikimi prehistorik i Krongjit**

*Nuk është përfshirë në hartën arkeologjike të zonës dhe ka pësuar dëmtime nga thesarkërkuesit klandestinë. Duhet të përfshihet në listën e monumenteve të mbrojtura nga shteti*

Ndodhet në majën më të lartë të malit të Krongjit, duke zotëruar gjithë territorin në rrugën për në Qafën e Muzinës në anën lindore, ndërsa në anën perëndimore zotëron territorin nga Bistrica deri në qafën e Gjashtës. Planimetria e fortifikimit të Krongjit, ka dy linja gjatësore, më e gjata me drejtim L – P, ndërsa e shkurtra P- VL, të cilat bashkohen me kënd të ngushtë duke rrethuar majën e malit në pjesët e kalueshme të tij. Muret ruhen mirë në një lartësi që lëviz nga 1.5 deri në 2.7 m. Ato ngrihen në një terren shkëmbor ku shpesh shkëmbinjtë janë bërë pjesë të murit fortifikues. Rrethimi nga ana jugore e veriperëndimore ndjek konfiguracionin e terrenit, ndërsa ana lindore e veriore janë lënë pa mure për shkak të rënies së thepisur të masivit shkëmbor, gjë që e bënte të panevojshme fortifikimin. Muratura përbëhet nga gurë të mëdhenj ( 0.8 x 0.6 x 0.4; 1 x 0.6 x 0.45 m) të marrë në territorin shkëmbor përreth; mesatar (0.55 x 0.35 x 0.25; 0.47 x 0.38 x 0.15m), ndërsa me gurë më të vegjël janë mbushur fugat dhe hapësirat midis dy këmishëve, në pjesët ku muri për shkak të terrenit më pak të pjerrët, është ndërtuar me dy faqe. Kjo strukturë shihet në pjesën më të madhe të murit, ndërsa në terren të pjerrët të theksuar, muratura është ndërtuar me një faqe duke iu mbështetur pjerrësisë së kodrës. Gurët janë të papunuar, të vendosur në të thatë njëri mbi tjetrin. Kjo teknikë e përdorur në ndërtimin e murit (2m të gjerë) dhe hyrja e ngushtë 1m në anën jugore, tregojnë për një fortifikim prehistorik që do të datohet në bronzin e vonë - hekurin e hershëm. Gjetje të rralla sipërfaqësore janë të pranishme, por shumë të fragmentuara dhe kryesisht të periudhës mesjetare. Kryerja e tre sondazheve dha pak fragmente qeramike të antikitetit të vonë dhe mesjetës. Fakti që fortifikimi ndodhet në lartësinë 930 m (pika më e lartë e fortifikuar në rrethin e Sarandës), tregon se ai nuk ka pasur funksion banimi por vetëm strehimi në rast rreziku. Kjo është arsyeja e gjetjeve të rralla arkeologjike. Fragmentet e pakta të qeramikës së antikitetit të vonë dhe mesjetës, janë dëshmi të përdorimit të tij edhe gjatë këtyre periudhave. Për këtë flasin dhe mbetjet e rrënojave të një manastiri në anën jugore të fortifikimit, që ka ekzistuar deri në mes të shekullit të kaluar.

Sugjerohet mbrojtja e territoreve përreth fortifikimit, për të mbrojtur vlerat e veçanta peizazhistike dhe pamjes panoramike të territorit ku ndodhet objekti. Në rast të rehabilitimit të objektit, i gjithë territori do të ofrojë një peizazh të jashtëzakonshëm kulturor. Kjo zonë duhet të jetë së paku deri në 150 metra.



*Fig. 2: Foto Fortifikimi prehistorik në Krongj*

Përsa l përket pasurisë natyrore, nuk propozohen zona të reja për t'u futur në listën e zonave të mbrojtura për bashkinë e Finiqit.

## **1.5 Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik e urban**

### **Zonat ekonomike**

Është e rëndësishme që zonat ekonomike të konsolidohen dhe të jenë të mirëpërcaktuara, duke përmirësuar kështu infrastrukturën për aksesimin dhe ofrimin e shërbimeve në këto zona. Bazuar në drejtimet e zhvillimit ekonomik të bashkisë, duke u orientuar drejt bujqësisë, blegtorisë dhe industrisë së lehtë, në Planin e Përgjithshëm Vendor është propozuar konsolidimi i zonës ekonomike në afërsi të Finiqit, midis Çlirimit dhe Vrionit. Edhe pse industritë që ndodhen aty klasifikohen si ndërmarrje operuese në sektorin industrial dhe atë tregtar, në Finiq bëhet fjalë kryesisht për një industri të lehtë me karakter agrar, mjaft e varur nga prodhimi dhe tregtia e produkteve bujqësore dhe rrjedhimisht, nga vetë sektori bujqësor.

Pol tjetër ekonomik është gjithashtu edhe fshati Dermish, në të cilin është propozuar ngritja e pikës së grumbullimit të produkteve bujqësore. Fshati i Dermishit, shikohet gjithashtu si një qender me rëndësi në bashki, prandaj është propozuar fuqizimi me shërbime publike dhe ekonomike.

Synimi është konsolidimi i këtyre zonave në një pole të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik për bashkinë, këto do të jenë edhe hapësirat e rikualifikuara për tu kthyer në zona ekonomike dhe

industriale. Ndër aktivitetet ekonomike me prioritet në territorin e bashkisë janë: bujqësia, industria e lehtë përpunuese ushqimore dhe turizmi.

### **Konsolidimi i qendrave rurale**

Një ndër parimet kryesore të planit është konsolidimi i qendrave urbane, për të rritur efektivitetin e investimeve publike, duke shtuar shërbimet, si dhe duke ruajtur kështu tokën bujqësore apo natyrore nga shpërhapja në territorin e banimit. Konsolidimi dhe përqëndrimi ndodh në zonat e urbanizuara tashmë, dhe profilizimi i tyre dhe ndarja në hierarki ndihmon në shpërndarjen e shërbimeve duke plotësuar nevojat.

Qendrat e fshatrave ofrojnë mundësi për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të banorëve, ku janë popozuar projekte për revitalizimin dhe zhvillimin e qendrave të fshatrave si hapësira publike duke përmirësuar jetesën e banorëve.

Propozohen projekte për konsolidimin e qendrës administrative Finiq, Aliko, Livadhja e Dermish, me krijimin e hapërisave të nevojshme për shërbime publike si administrata publike, qendër shëndetësore, zyra postare etj. Propozohen projekte për rivitalizimin e qendrave të fshatrave duke i kthyer në hapësirë publike për takime dhe zhvillim aktivitetesh për banorët.

### **Bujqësia dhe agroturizmi**

Një profil më të theksuar bujqësor kanë fshatrat përgjatë fushës së Vurgut: Finiq, Mesopotam, Kranë, Aliko, Kulluricë dhe Vagalat, ku janë cilësuar si qendra me potencial për zhvillimin e agroturizmit me drejtim bujqësinë. Krijimi i një qendre grumbullimi të produkteve bujqësore në Dermish, si pikë qendrore për bashkinë, do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të zonës. Ndërsa fshatrat Dhrovjan, Navaricë, Leshnicë, Dhivër dhe Pandalejmon si qendra me karakter të theksuar blegtoral dhe në vijësi mund të zhvillohet agroturizmi me drejtim blegtoral me promovimin e produkteve dhe nënprodukteve të mishit e qumështit.

Fshati Mesopotam, pjesë e Programit të qeverisë qendrore të 100 Fshatrave ka marrë një vëmendje të veçantë për sa i përket projekteve të propozuara nga Akademia e 100+ Fshatrave ku propozohen projekte për: krijimin e parkut të Skulpturave në sheshin përreth Kishës së Shën Kollit, në fshatin Mesopotam, përshtatja e banesave ekzistuese, të cilat janë të pabanuara në bujtina për akomodimin e turistëve dhe vendosje në qendër të fshatit Mesopotam, e dyqanit të rrjetit "E DUA".

### **Ekoturizëm**

Ekoturizmi ka për qëllim sensibilizimin për të orientuar banorët drejt ruajtjes së vlerave natyrore, florën dhe faunën, si dhe orientimin e produktit turistik me struktura pritëse dhe

akomoduese, të cilat janë në harmoni më natyrën. Falë turizmit rural potencial për zonën përbëjnë fshatrat Ardhasovë, Vurg i Ri, Dhrovjan dhe Leshnicë, me një karakter më të theksuar drejt turizmit natyror. Projektet e propozuara janë itineraret agroturistike, kulturore dhe natyrore-peizazhistike.

Një projekt i rëndësishëm është edhe zhvillimi i bregut të Liqenit të Butrintit duke mbrojtur ekosistemin dhe mbështetur zhvillimin e turizmit liqenor, me krijimin e itinerarit me varka përreth liqenit të Butrintit, me pikënisje nga pjesa e liqenit, afër fshatit Vurgu i Ri, që do të ishte krijimi i një moli, shëtitoreje dhe vende pushimi e vrotimi.

Promovimi i turizmit në Parkun Natyror të Syrit të Kaltërt dhe në Rezervatin Strikt të Kardhiqit është gjithashtu me rëndësi të madhe për bashkinë e Finiqit, ku janë propozuar itinerare hiking, me biçikleta apo ofrad, ku vihet re nevoja e pajisjes me infrastrukturë dhe sinjalistikë të nevojshme.




Fig. 3: Harta e zhvillimit të eko-turizmit në bashkinë e Finiqit (Përpunoi: Dea Studio)

## 1.6 Tipologjitë e propozuara hapësinore

Tipologjia hapësinore evidenton mënyrat e ndërlidhjes së hapësirave në territor, kryesisht nga pikëpamja morfologjike. Duke u fokusuar në mënyrën e formimit të vendbanimeve, topologjitë varen nga morfologjia e vendbanimeve, shtrirja hapësinore e vendbanimeve në raport me relievin dhe tipologjia e ndërtesave.

### Morfologjia e vendbanimeve

Bashkia Finiq përbëhet nga 5 njësi administrative me 58 fshatra. Këto qendra kanë marrëdhënie të ndryshme të vendbanimeve brenda tyre, si dhe tipologji të ndryshme shtrirjeje. Sa i takon lidhjes së vendbanimeve brenda të njëjtit fshat, në Finiq janë kategorizuar 4 tipologji kryesore:

- **Qendra kompakte:** Kjo tipologji i përgjigjet fshatrave që përbëhen nga një vendbanim i vetëm, kompakt. Ky rast nuk është shumë i përhapur, dhe përkon me fshatra që nuk kanë presion zhvillimi.
- **Qendra të shpërndara por me një bërthamë të dallueshme:** Ky rast nënkupton që fshati përbëhet nga disa vendbanime të shpërndara, por të lidhura hierarkisht me një qendër dominante. Këto lidhje janë tregues të tendencës për rritje të fshatrave, si dhe terrenit të vështirë, i cili kufizon vazhdimësinë urbane.
- **Qendra të shpërndara:** Këto tipologji hasen në fshatrat me shumë vendbanime të vogla, të shpërndara në territor në mënyrë sporadike, të palidhur mirë. Pavarësisht prezencës së një qendre ku është zhvilluar fillimisht fshati, presioni i rritjes në kohë ka çuar në shpërndarjen e vendbanimeve të reja në mënyrë të pastrukturuar, dhe abuzuese ndaj territorit.
- **Linearisht e shpërndarë:** këto janë vendbanimet të cilat nuk kanë as një qendër të dallueshme dhe janë të shpërndara në territor. Veçantia e tyre është se janë zhvilluar jo në mënyrë sporadike por sikas një aksi të caktuar, që në pjesën më të madhe të rasteve është përgjatë aksit rrugor linear, ose përgjatë një vije ujore, ose rrëzë një kodre.

### Tipologjia e ndërtesave

Tipologjitë e propozuara hapësinore kanë për qëllim përcaktimin e morfologjisë urbane për njësitë strukturore që do të nënshtrohen rihvillimit, zonave të reja për ndërtim, konsolidimit, si dhe rigjenerimit urban. Pjesa dominuese e vendbanimeve përbëhet prej të njëjtës tipologji ndërtesash, si nga ana funksionale ashtu edhe e volumit të godinave. Ndërtesat me funksion banimi, janë banesa 1-familjare me oborr privat dhe variojnë nga 1 deri në 3 kate lartësi në varësi të kushteve të zhvillimit të secilës qendër urbane. Mbulesa propozohet kryesisht me çati.

Tipologjitë e propozuara të banesave janë:



- Banesa të tipit vilë të veçuara
- Banesa të tipit vilë të grupuara
- Banesa kolektive lineare/Pallate
- Struktura lineare

**Banesa shumë familjare, pallat** – kjo tipologji e gjetur kryesisht në fshatin Livadhja, përbëhet nga një volum i vetëm i ngritur në lartësi nga 4 kate dhe me mbulim kryesisht me taracë, por edhe në raste kur lartësia është e ulët mund të pranohet edhe me çati. Për banesat mbi 5 kate, duhet të projektohen edhe ashensorët. Sugjerohet që banesat e reja kolektive të kenë ballkone ose llozha për secilin apartament, parkim nëntokësor dhe kati përdhe mund të jetë me njësi shërbimi ose banimi. Gjithashtu sugjerohet që banesat e reja të kenë efikasitet energjitike të lartë dhe zgjidhje inovatore si tarraca të gjelbëerta apo fasada të ventiluara. Lartësia e këtyre ndërtesave do të përcaktohet në secilën pasaportë ku kjo tipologji mund të aplikohet.

**Banesa të tipit vilë të veçuara** – të cilësuar ndryshe edhe shtëpi private janë tipologjia me e përdorur në territorin e bashkisë. Mbulesa e tyre është përgjithësisht me çati, por edhe me tarracë. Ndërtesat duhet të vendosen në truall duke respektuar distancat nga objektet përreth dhe nga kufiri i pronës, kujdes duhet pasur me objektet të cilat duhet të ruajnë vijën e ndërtimit, për këto raste do të përcaktohet në pasaportat përkatëse.

**Banesa të tipit vilë të grupuara** – kjo tipologji vërehet deri në dy banesa të cilat ndajnë të njëjtin mur, por nuk ka ende në territorin e bashkisë tipologji ku të planifikohen shtëpi një familjare në formën e dupleksit apo tripleksit me vijueshmëri më të gjatë. Sugjerohet kjo tipologji në rastet e ndërtimit të parcelave të medha me mbi 2 banesa, për të krijuar harmoni dhe hapësira të përbashkëta të mirë menaxhuara. Lartësia e këtyre tipologjive sugjerohet të mos kalojë 3 kate mbi tokë. Përcaktime për lartësitë do të bëhen në pasaportat përkatëse.

**Struktura lineare** – kjo tipologji do të përdoret kryesisht për ndërtesat të cilat i përkasin përdorimeve të tokës: Industri Ekonomi, Arsim, Shëndetësi, Institucione etj. Në këtë rast, sipas funksionit përkatës, mënyra e ndërtimit të këtyre ndërtesave përcaktohet nga tipologjia përkatëse e secilit funksion duke respektuar kushtet teknike dhe legjislativet përkatëse.

Në të gjithë territorin e bashkisë lejohen tipologjitë e mësipërme të ndërtimit, ku specifikime do të jepen në pasaportat përkatëse për lartësinë dhe tipologjinë.

## 1.7 Mënyrat e ndërhyrjes në territor

Mënyrat e ndërhyrjeve të përcaktuara për secilën njësi strukturore janë shpjeguar në vijim, duke u bazuar në VKM nr. 686 datë 22.11.2017 "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të*

*Territorit", ato janë karakterizuar në njësi për: Dendësim, Konsolidim, Rigjenerim, Rizhvillim, Konservim dhe Urbanizim.*

**DENDËSIM / MBUSHJE URBANE** - Densifikimi i njësive kryesisht homogjene, me struktura të të njëjtit karakter, funksion e përdorim me kufizueset.

Kjo mënyrë ndërhyrjeje synon zhvillimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të tokës truall, si dhe rritjen e efikasitetit në përdorimin e rrjeteve të infrastrukturave publike. Përgjithësisht përdoret për zonat urbane ekzistuese, duke iu referuar hapësirave të pandërtuara në territoret e urbanizuara ose pjesërisht të urbanizuara. Njësitë ku propozohen dendësi dhe mbushje urbane, zakonisht nuk kërkojnë PDV. Mbushja urbane nënkupton zhvillimin e parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato të njësive. Kjo lloj ndërhyrjeje nuk ndryshon në asnjë rast karakterin dhe tipologjinë e ndërtimit.

**KONSOLIDIM** - Nxitja e ndërtimit brenda zonave të urbanizuara, me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore dhe përforcimin e struktura urbane territorial.

Konsolidim si mënyrë ndërhyrjeje vlen për pjesën më të madhe të zonave ekzistuese rurale të banuara dhe zonat ekonomike ekzistuese apo të propozuara. Nëpërmjet konsolidimit arrihet përforcimi i strukturës urbane të atyre zonave, të cilat kanë një skelet hapësinor, ose fillesa të mirëpërcaktuara.

**RIGJENERIM / RIKUALIFIKIM** - Përmirësimi i kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori apo ndërtimi. Si dhe rikthimi në funksionet e mëparshme.

Shkalla e ndërhyrjeve në këto zona varion që nga ndërhyrjet ndërtimore e deri tek sistemimet e terrenit, krijimi i brezave të gjelbër, apo trajtimet pejzazhistike për të ritheksuar vlerat estetike të qytetit dhe fshtrave. Rikualifikimi ekonomik zbatohet në zona ekonomike të cilat kanë degraduar, por mbeten përsëri të rëndësishme për të funksionuar si të tilla. Rikualifikimi ambjental pejzazhistik zbatohet në territore të lira të cilat propozohen të kthehen në breza të gjelbër sanitar dhe rekreativ.

Koncepti i rikualifikimit sipas sistemeve:

- Rikualifikimi në sistemin urban synon të realizojë përmirësimin e cilësisë së mjedisit urban, duke u fokusuar kryesisht në hapësirat dhe burimet publike.
- Rikualifikimi në sistemin natyror i referohet konceptit të rehabilitimit të pejzazhit dhe natyrës në rastet e zonave me dëmtime mjedisore ose zona të degraduara.
- Rikualifikimi në sistemin e bujqësisë i referohet rastit të tokës së papunuar, si dhe tokave jo pjellore dhe të pafrutshme.

**RIZHVILLIM** - Zhvillimi ose rindërtimi i një territori, i cili është i ndërtuar, por i degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore. Qëllimi është rivlerësimi i treguesëve të zhvillimit të njësisë.

Rizhvillimi aplikohet në njësi të zhvilluara më parë, duke ndryshuar strukturën e ndërtimeve ekzistuese, treguesit e zhvillimit apo edhe ndryshimin e funksioneve. Zonat e dedikuara për rizhvillim janë subjekt i PDV-së.

**KONSERVIM**- Ruajtja dhe mbrojtja e një territori ose ndërtimi të caktuar në formën e tij ekzistuese/aktuale. Ndërhyrjet janë rehabilituese në infrastruktura, shërbime publike dhe banesa.

Konservimi urban nënkupton ruajtjen e karakterit, tipologjive dhe përdorimit ekzistues të zonave të caktuara të qytetit dhe fshtrave, si dhe të pasurive kulturore apo monumenteve natyrore. Shkalla e ndërhyrjeve në lidhje me rritjen e intensitetit dhe strukturat e ndërtimit është minimale, ndaj treguesit e propozuar përputhen ose janë përafërsisht të barabartë me ato të gjendjes ekzistuese. Në qytet dhe qendrat e fshtrave ndërhyrjet nënkuptojnë rehabilitimin e infrastrukturave, shërbimeve publike, banesave, elementëve të dizajnit urban. Përgjithësisht këto ndërhyrje aplikohen në zonat e komplekseve të banimit me koncepte hapësinore të qarta të ndërtuara para viteve '90.

Konservimi është aplikuar edhe në njësi të sistemit natyror, ujor dhe bujqësor, me qëllim ruajtjen e vlerave dhe burimeve të vlefshme natyrore të Bashkisë që meritojnë të jenë të mbrojtur nga zhvillimi. Janë të përfshira në këtë kategori kombëtare zona të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi

**URBANIZIM** - Ndërhyrja në territor nëpërmjet zhvillimeve të reja, në funksion të rritjes së sistemit urban.

Urbanizimi është i lidhur me rritjen graduale të përqindjes së popullsisë që jeton në zonat urbane dhe mënyrat në të cilat çdo shoqëri i përshtatet këtij ndryshimi. Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm demografik dhe mbrojtjen e tokës bujqësore dhe natyrore janë propozuar për urbanizimi zona në afërsi të qendrave urbane ekzistuese nëpërmjet PPV-së.

## **1.8 Njësitë që i nënshtrohen hartimit të PDV-së**

Përcaktimin e njësisve të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së, bëhen të qarta në dokumentin e Planit të Përgjithshëm Vendor, në bazë të përcaktimeve të mëposhtme:

- Njësi ku janë parashikuar investime publike në infrastrukturë apo shërbime, të cilat ndikojnë në ndryshimin apo rishpërndarjen e kushteve të zhvillimit.
- Njësi të reja për zhvillim dhe urbanizim të cilat janë të pazhvilluara dhe kanë mungesë në infrastrukturën e domosdoshme.
- Njësi të cilat janë propozuar nga Plani për ndryshim të përdorimit ekzistues të tokës, me fokus rigjenerimin.
- Njësi për zhvillim/ rihvillim, ku synimi është zhvillimi i projekteve sipas prioritetit dhe drejtimit të zhvillimit.
- Njësi ku mund të jenë përcaktuar instrumente të drejtimit të zhvillimit, duke përcaktuar përdorimet e tokës dhe kushtet e zhvillimit.

Njësia e propozuar për zhvillim me Plan të Detajuar Vendor është njësia me Kod: FQ\_UB\_IE1\_35/1.

Njësia më sipër, ndodhen në kufi me bashkinë Sarandë. Tipologjia Industri – Ekonomi është ekzistuese në zone por ka presion të lartë për zhvillim të mëtejshëm dhe infrastruktura ekzistuese nuk është e mjaftueshme. Për këtë arsye propozohet që kjo zone të zhvillohet nëpërmjet një Planit të Detajuar Vendor.

Plani i detajuar vendor (PDV), gjatë fazave të hartimit dhe zbatimit, duhet të ndjekë parimet e planifikimit si një proces pune në vazhdimësi.

## 1.9 Instrumentet për drejtimin e zhvillimit

Plan i Përgjithshëm Vendor propozon përdorimin e instrumenteve për drejtimin e zhvillimit, të bazuara në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, i cilin parashtron një instrument.

**E drejta e preferimit** - është e drejta në dobi të një autoriteti të planifikimit, për t’u preferuar në radhë para çdo personi privat në blerjen, në të njëjtat kushte, të një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, që është objekt shitjeje dhe ndodhet në një zonë vendimtare për realizimin ose mbrojtjen e një interesi publik.

Ky instrument propozohet të përdoret në njësitë ku propozohen shkolla dhe qendra shëndetësore të reja, me kategori përdorimi të tokës, primare apo sekondare, AS (arsim) dhe SH (shëndetesi), ku e drejta e preferimit përdoret vetëm për interesin publik konkret, për të cilin është zgjedhur dhe i referohet shërbimeve të reja publike të propozuara. Përgjithësisht ky instrument do të përdoret në njësitë strukturore që i përkasin fshatit Vagalat dhe në Finiq. Ky instrument do të përdoret në njësitë strukturore: FQ\_UB\_SH1\_2/2 dhe FQ\_UB\_SH1\_63/11.

## 1.10 Parashikimet demografike dhe strehimi

Bashkia Finiq ka një popullsi prej 35,518 banorësh sipas Regjistrimit Civil të vitit 2016. Popullsia në bashkinë e Finiqit në pjesën dërrmuese të saj i përket minoritetit grek dhe kjo e bën atë kryesisht popullësi homogjene. Pavarësisht se Qarku i Vlorës ka pasuar vitet e fundit një rritje të popullsisë, që në përgjithësi kjo rritje i faturohet bashkisë Vlorë, bashkitë e tjera specifiku ajo e Finiqit, ka pësuar rënie. Ky fenomen shpjegohet me procesin e vazhdueshëm të emigrimit, uljen e ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit dhe emigrimit.

Treguesit e varesisë në seri kohore, tregojnë një rritje e konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, rreth 25%, madje në njësitë administrative si Dhimër dhe Livadhja kjo përqindje është edhe më e lartë duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, në atë të “plakjes”. Rritja e grupmoshës (+65), shoqërohet me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë.

Pritet që nga zbatimi i Strategjisë Territoriale dhe projekteve të propozuara në Plan, të përmirësohet mirëqenia dhe ekonomia lokale e zonës duke tërhequr më shumë vizitorë, investitorë dhe të rinj që do të zgjedhin të qëndrojnë apo të kthehen në vendlindje. Si rrjedhim pritjet përmirësimi i kushteve të punës dhe të jetesës dhe rritja graduale e popullsisë. Parashikimet për projeksionet e popullsisë, skenari i rritjes së mesme - të pasqyruara në fazën e analizës dhe strategjisë, tregojnë rritjen natyrore të popullsisë me një ritëm mesatar vjetor me 2%. Në bazë të llogaritjeve, popullsia në vitin 2034 pritjet të rritet nga 35,518 në 48,759 banorë.<sup>1</sup>

Table 4: Rritja e popullsisë (Burimi: INSTAT, llogaritje Dea Studio)

Bashkia Finiq	Popullsia në fillim të vitit	Rritja %	Popullsia në fund të vitit
2019	35518	0,02	36228
2020	36228	0,02	36953
2021	36953	0,02	37692
2022	37692	0,02	38446
2023	38446	0,02	39215
2024	39215	0,02	39999
2025	39999	0,02	40799
2026	40799	0,02	41615

<sup>1</sup> Sqarim: Rritja e popullsisë është progresive, çdo vit me 2%

<b>2027</b>	41615	0,02	42447
<b>2028</b>	42447	0,02	43296
<b>2029</b>	43296	0,02	44162
<b>2030</b>	44162	0,02	45045
<b>2031</b>	45045	0,02	45946
<b>2032</b>	45946	0,02	46865
<b>2033</b>	46865	0,02	47803
<b>2034</b>	47803	0,02	<b>48759</b>

Edhe pse rezerva e stokut të ndërtesave nga ana sasiore është e mjaftueshme për të akomoduar rritjen e popullsisë aktuale, pasi përballemi me fenomenin e braktisjes së banesave, ku një pjesë e banesave private janë të braktisura si pasojë e emigrimit të brendshëm apo të jashtëm, pritet të rritet kërkesa për ndërtimin e banesave të reja. Problematikë tjetër janë kushtet jo të mira të jetesës që ofrojnë një pjesë e madhe e godinave që janë të banuara, si pasojë e mungesës së investimeve në to.

Table 5: Status i banimit të ndërtesës (Burimi: INSTAT Census 2011)

Bashkia Finiq	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar ose e banuar nga persona që nuk përfshihen në census	Gjithsej
<b>Finiq</b>	370	213	575	1158
<b>Mesopotam</b>	870	317	77	1264
<b>Aliko</b>	1258	591	1848	3697
<b>Dhivër</b>	616	27	561	1204
<b>Livadhja</b>	445	322	1167	1934
<b>Gjithsej</b>	<b>3559</b>	<b>1470</b>	<b>4228</b>	<b>9257</b>

Plani parashikon konsolidimin e zonave të banuara në zonat rurale dhe dendësim të tyre për shkak se tipologjia hapësinore në këto vendbanime është shpeshherë e shpërhapur, duke siguruar kështu edhe më lehtë shërbimet për këto zona. Nuk është e nevojshme shtimi i zonave urbane të reja në njësinë administrative, por i nevojshëm është rigjenerimi i hapësirave publike dhe realizimi i projekteve për shërbime dhe qendra shëndetësore. Gjithashtu në Finiq është parashikuar dhe ngritja e Shkollës së Mesme Profesionale, që do të përgatisë të rinjtë për tregun e punës, sidomos në bujqësi dhe turizëm.

Për sa i përket Finiqit, nga Plani është parashikuar ndërtimi i banesave të reja, dendësim dhe konsolidim në njësitë strukturore në pjesën lindore, në njësitë FQ\_UB\_A\_1 dhe FQ\_UB\_A\_2 ku ka hapësira truall të lirë. Mbushja urbane është e domosdoshme për konsolidimin e banimit, apo rikonstrukcionin ose rihvillimin e njësive ekzistuese.

Pritet që kërkesa për ndërtimet e reja do të vijë nga çiftet e rinj, profesionistët që duan të punësohen në Finiq, të kthyerit nga emigrimi dhe ndarja e brezave që jetojnë në të njëjtën shtëpi. Shtimi i popullsisë pritet të ndikojë jo vetëm në përdorimin e tokës për kategoritë banim dhe bujqësi-banim, por rrjedhimisht do të rritet edhe kërkesa për përdorime të tjera si shërbime, infrastruktura sociale, krijimin e hapësirave rekreative dhe të gjelbëruara, si dhe infrastruktura teknike. Me zbatimin e planit, në 15 vitet e ardhshme, pritet të plotësohen kriteret për sipërfaqen minimale për secilin banor për strehim. Standardi për sipërfaqe banimi varion nga minimumi 25 m<sup>2</sup>/banor deri në 40 m<sup>2</sup>/banor, ku synohen sigurimi i banesave, shërbimeve dhe aktiviteteve ekonomike në funksion të banimit.

Bazuar në të dhënat e regjistruara në bashki, numri i personave të cilët kanë aplikuar dhe kanë përfituar nga skema e bashkisë për ndihmë ekonomike është 52 familje. Ndërsa për sa i përket numrit të personave të pastrehë, Bashkia e Finiqit nuk ka regjistruar familje të pastreha në territorin e saj.

Aktualisht nga bashkia ofrohen 2 skema mbështetëse për familjet e pastreha:

- Shtëpi me qira të ulët (skema më e aplikuar deri tani)
- Shtëpi me kredi të zbutur

Strehimi social do të vazhdojë të trajtohet nga bashkia me skemen e trajtimit me qira të ulët apo kredi të zbutur për rastet që do të paraqiten duke qënë se deri tani nuk ka pasur kërkesa.

Dukë qenë se bashkia nuk ka banesa sociale në pronësi, si dhe i mungojnë të ardhurat e mjaftueshme buxhetore për ndërtimin e banesave sociale të reja, synohet që në të ardhmen të aplikohet instrumenti i drejtimit të zhvillimit "*intensiteti i ndërtimit me kushte*" në njësitë strukturore në Finiq, Livadhja dhe Dhivër, të përcaktuara nga plani, ku një pjesë e sipërfaqës së ndërtuar do ti jepet bashkisë në pronësi dhe përdorim. Gjithashtu kjo formë strehimi do të sjellë integrimin më të mirë të këtyre familjeve në godinat e reja të ndërtuara nga sektori privat.

## **2 Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike**

### **2.1 Rrjeti rrugor**

Bashkia e Finiqit lidhet me bashkitë fqinje si Dropulli e Delvina nëpërmjet rrugës shtetërore SH 83 e cila, për në bashkinë Dropull ndërpret rrugën shtetërore SH 99, që i përket aksit rrugor Finiq – Gjirokastër. Ndërsa për në bashkinë Delvinë ndërpret rrugën shtetërore SH 78. Bashkia Finiq lidhet me bashkinë Konispol nëpërmjet rrugës shtetërore SH 97, Finiq – Qafë Botë dhe me bashkinë Sarandë nëpërmjet rrugës shtetërore SH 99.

Rrjeti i rrugëve është një pjesë integrale e një zonë urbane apo rurale, pasi lidh zonat e vendbanimit dhe lehtëson lëvizjen e njerëzve, automjeteve dhe mallrave. Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe më konkretisht në

zhvillimin e turizmit. Për këto arsye, në plan është propozuar një rrjet i qartë dhe i mirëpërcaktuar rrugor, që ndjek hierarki duke përcaktuar fluksin, funksionin dhe qëllimin e secilës rrugë.

Ky plan propozon rrjetin rrugor të ndarë sipas kategorive të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, si në tabelen dhe hartën e mëposhtme. Nisur nga standardet që duhet të plotësojnë rrugët për tu klasifikuar, vetëm një pjesë e tyre i arrijnë ato, pjesa tjetër nuk mund të klasifikohen pasi u shërbejnë vetëm grupeve të caktuara të ndërtesave.

*Table 6: Infrastruktura rrugore e propozuar e bashkisë Finiq sipas kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë (Burimi: Bashkia Finiq dhe Dea Studio)*

<b>Bashkia Finiq   Kategoria</b>	<b>Gjatësia km</b>
Kategoria C. Rrugë interurbane dytësore	114,8
Kategoria E. Rrugë urbane dytësore	2,46
Kategoria F. Rrugë lokale	498,12
Rruge këmbësoresh	1,63
<b>TOTAL</b>	<b>617</b>






Fig. 4: Profilet e rrugëve sipas ndarjes së kategorive të Kodit Rrugor Shqiptar (Burimi: Dea Studio)

Rrjeti rrugor i propozuar synon të përmirësojë gjendjen ekzistuese infrastrukturore rrugore dhe përfshirjen e akseve të reja duke plotësuar kështu rrjetin rrugor të bashkisë Finiq. Janë propozuar zgjerim dhe rikonstrukcion rrugësh sipas klasifikimit rrugor, duke përmirësuar ndërlidhjet e rrugëve me akset kombëtare dhe duke vendosur sinjalistika horizontale dhe vertikale në akset ku do ndërhyet. Do vendosen kufizues anësorë në rrugë, barriera metalike në kthesa dhe tabela informimi për zonat turistike apo objektet fetare. Në bazë të fluksit të lëvizjes në këto rrugë, nevojitet më tepër përmirësimi i tyre se sa zgjerimi në rrugë të kategorive më të larta, pasi përballohet nga rrugët ekzistuese.

Akset rrugore kryesore sipas njësive administrative janë si më poshtë:

#### Njësia administrative Mesopotam:

- Ura e Kranës – Mesopotam – Muzinë.
- Miniera e kripës – Dhrovian.
- Mesopotam – Livin.

- Njekohesisht *rruga Velahov - Bistrica 1*

**Njësia administrative Livadhja:**

- *Krane – Hardhasov – Dermish – Kulluric – Livadhja.*
- *Rruga që lidh fshatrat e po kesaj njesie Livadhja – Llazarat - Kallcat – Gravë – Zvinec.*
- *Rruga Kulluric – Pllakë*

**Njësia administrative Dhivër:**

- *Dermish – Dhivër - Partizan - Cerkovic –Leshnicë*

**Njësia administrative Aliko:**

- *Aksi rrugor Krane – Livadhja*
- *Sarandë – Krane*
- *Dermish – Jerm*

**Njësia administrative Finiq:**

- *Rruga lidhëse me bashkinë Delvinë*
- *Rruga për në Parkun Arkeologjik të Finiqit*
- *Rruga panoramike Bistricë – Muzinë*

Ndërhyrjet e propozuara për përmirësimin e infrastrukturës rrugore janë si më poshtë të përmbledhura:



Fig. 5: Skemë funksionale e infrastrukturës rrugore në territorin e Bashkisë Fier (Burimi: Dea Studio dhe Bashkia Fier)

**Zgjerim i rrugës, Jermë – Dhivër – Cerkovicë - Leshnicë e Sipërme – Kërrë.** Ky aks ka nevojë për zgjerim dhe rikonstruksion dhe është ndër aksët më të rëndësishme për pjesën qendrore të bashkisë Fier. Gjatësia totale e tij e cila ka nevojë për ndërhyrje është 17 km.

**Rikonstruksion i rrugës Mesopotam-Kostar.** Ky aks ka nevojë për rikonstruksion dhe është ndër aksët më të rëndësishme për lidhjen e fshatrave me njëri - tjetrin. Gjatësia totale e tij e cila ka nevojë për ndërhyrje është 3.5 km.

**Rikonstruksion i rrugës Dhrovian dhe Leshnicë e Poshtme.** Ky aks ka nevojë për rikonstruksion dhe pjesërisht për rindërtim. Rikonstruksion i rrugës shkon deri në Dhrovjan, e cila është një

qendër me asete turistike kulturore dhe ndërtimi i aksit të ri deri në Leshncë. Gjatësia totale e tij e cila ka nevojë për ndërhyrje është 13.8 km.

**Rikonstruktion i pjesshëm i rrugës Fitore-Aliko.** Ky aks ka nevojë për rikonstruktion dhe ka rëndësi për arsye se shërben si një aks lidhës për fshatrat e njesisë administrative Aliko. Gjatësia totale e tij e cila ka nevojë për ndërhyrje është 2.7 km.

**Rehabilitimi dhe pajisja me sinjalistikë e aksit rrugor Cerkovicë – Maliçan - Grashdan – Zminec - pika kufitare Rips.** Ky aks ka nevojë për rikonstruktion dhe pajisje me sinjalistikën e nevojshme. Gjatësia totale e tij e cila ka nevojë për ndërhyrje është 16 km.

**Shtrim i rrugës Kardhikaq – Muzinë.** Ky aks ka nevojë për rikonstruktion dhe pajisje me sinjalistikë dhe shërben si një aks peizazhistik natyror. Gjatësia totale e tij e cila ka nevojë për ndërhyrje është 5.7 km.

### **2.1.1 Koordinimi i trafikut**

Bashkia e Finiqit nuk ka probleme thelbësore që lidhen me trafikun e automjeteve, për shkak të numrit relativisht të ulët të mjeteve, megjithatë lëvizja e mjeteve është kaotike dhe korsitë zihen nga makinat e parkuara, jo në vendpushimet e përcaktuara. Synohet disiplinimi i drejtuesve të mjeteve, duke vendosur sinjalistikë të qartë në rrugë, duke vijëzuar sic duhet vendkalimet e këmbësorëve dhe duke ndërtuar një rrjet korsish biçikletash. Propozohet ngritja e Qendrës së Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut Urban pranë bashkisë, e cila do të jetë përgjegjëse për kontrollin e trafikur, vendosjen e semaforëve, monitorimin me kamera në kryqëzimet kryesore, si dhe vendosjen e ekraneve elektronike informuese në akset rrugore apo në hyrje të zonave të banuara.

### **2.1.2 Lëvizja e këmbësorëve dhe çiklistëve**

Lëvizja e këmbësorëve është një aspekt shumë i rëndësishëm për tu konsideruar në bashki ku transporti publik brenda për brenda venbanimeve mungon. Gjithashtu edhe distancat e shkurtra, duhen inkurajuar për tu përshkruar në këmbë apo me biçikletë, duke zvogëluar sa më shumë numrin e automjeteve private që qarkullojnë në rrugë.

Në mënyrë që lëvizja e këmbësorëve të jetë sa më e sigurt, bashkia do të investojë në kalimet e sigurta, vijëzimet, tabelat shënjuese, semaforët, si dhe do zgjerojë trotualet e ngushta dhe do investojë në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Korsitë e biçikletave variojnë në një gjerësi prej 1.2m deri në 1.5m për kah, duke marrë në konsideratë kushtet. Për korsitë me dy kalime, gjerësia varion nga 2.4m deri në 3m. Minimumi i gjerësive për korsitë me një kalim janë:

- 1.5m ku shpejtësia limit është 30km/h,

- 2m ku shpejtësia limit është 30km/h dhe trafiku i çiklizmit është i lartë,
- 2m (ose 1.5m + 0.5m rezerve) në rrugë me trafik të lartë ose shpejtësi limit 40km/h.
- 2m kur korsia është midis krahëve të rrugës.
- 2m deri në 2.5m për korsitë hibride, në varësi të nivelit të përdorimit.

Mënyrat për të përfituar këtë sipërfaqe në rrugët ekzistuese, janë duke hequr një korsi për makinat e duke ja lënë atë biçikletave, duke hequr vendparkimet në anë të rrugës ose duke ngushtuar korsitë e makinave, por duhet pasur parasysh që korsitë për makinat të vazhdojnë të plotësojnë standardet e të jenë të sigurta. Në momentin që asnjë nga këto zgjidhje nuk është e implementueshme duhet menduar për ndërtimin e korsive të biçikletave që janë të pavarura nga rruga, korsi të shpejta të dedikuara. Në rrugët e reja që do të ndërtohen, korsitë e biçikletave do të projektohen që në projekt.

### **Rekomandimet për përmirësimin e lëvizjes së këmbësorëve dhe çiklistëve në rrugë:**

- Duhet minimizuar hapësira e pashfrytëzuar në rrugët e kalimit të automjeteve, duke ja dhënë këtë hapësirë zgjerimit të trotuareve apo korsive të biçikletave. Ridizenjimi i hapësirës dhe rindarja e saj është një element kyç në kthimin e rrugëve në hapësira të sigurta.
- U duhet dhënë përparësi kalimit të këmbësorëve në kryqëzime, duke shtuar ku është e mundur ishujt e sigurisë.
- Duhet përdorur intervalet që u japin përparësi në lëvizje çiklistëve, duke i pozicionuar ata të parët në kryqëzim. Kthimet e automjeteve duhen ngadalësuar sa më shumë, për të shmangur kështu aksidentet.
- Kthimi i biçikletave majtas duhet të realizohet duke vendosur sinjalistikën e qartë në kryqëzime.
- Duhet dizenuar xhepa kthimi për automjetet aty ku kthimet janë të shpeshta, duke pasur parasysh lëvizjen e këmbësorëve dhe biçikletave.
- Duhet ulur shpejtësia e automjeteve dhe çiklistëve në afërsi të kryqëzimeve me sinjalistikë, në mënyrë që përdoruesit e rrugës të kenë një fushë-pamje më të qartë të pozicionimit të tyre në rrugë.

## **2.2 Transporti publik**

Në bashkinë Finiq transporti i pasagjerëve kryhet nëpërmjet një taksi 4+1 vende dhe katër 8+1 vende me vënddodhje stacionesh në qendrat e fshatrave: Dhivër, Muzinë, Bistricë, Livadhja dhe Aliko.

Gjendja e mjeteve të transportit të pasagjerëve në linjat brenda bashkisë është jo e mirë në drejtim të komoditetit, ku ka shumëllojshmëri ngjyrash, shumëllojshmëri tipesh autobusash dhe mosfunksionim të ventilimit për ngrohje dhe ftohje brenda kabinës. Është i nevojshëm përmirësimi i flotës së automjeteve si dhe krijimi i linjave për arritjen e atraksioneve turistike në territorin e bashkisë. Në varësi të fluksit të turistëve, bashkia do të vijojë me marrjen e vendimeve për krijimin dhe hapjen e këtyre linjave. Transporti publik është i lidhur ngushtësisht edhe me përmirësimin e rrjetit rrugor në territorin e bashkisë.

Gjithashtu janë propozuar ndërhyrje në kuadër të ngritjes së pikave të vendqendrimeve, stacioneve me standarte. Ngritja e këtyre pikave do të jetë në të gjithë fshatrat që përshkohen nga linjat e transportit publik. Këto pika do të ngrihen në vendqëndrimet ekzistuese, dhe projektet e tyre duhet të përfshijnë minimalisht një strehë dhe vend për t'u ulur. Pozicionimi i tyre do të jetë buze rruge, sipër në trotuar.

Përsa i përket fshatrave të njësisë administrative Livadhja dhe Dhivër, rekomandimi i planit është krijimi i dy linjave të transportit publik brenda bashkisë për të lidhur fshatrat:

- Finiq - Mesopotam - Bisticë - Sirikat - Kardhikaq - Muzinë - Dhrovjan - Leshnicë e Sipërme - Janicat – Çerkovicë
- Kodër - Kalcat - Llazat - Pandalejmon - Komat - Karroq - Zminec - Grazhdan - Malçan - Çerkovicë

### **2.3 Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm**

Spektori i furnizimit me ujë dhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operohet nga UK Finiq, e cila mbulon me këto shërbime territorin e bashkisë. Sipas të dhënave nga bashkia, përqindja e mbulimit me rrjetin e ujësjellësit arrin vlerën 60% të territorit rural. Aktualisht bashkia përballet me probleme të mëdha në çështjet organizative dhe menaxheriale në lidhje me furnizimin me ujë.

Realizimi i projektit të ujësjellësit të Leshnicës do të mundësojë furnizimin me ujë të pijshëm të 20 fshatrave në zonën e Dhivrit, zona malore e bashkisë. Projekt parashikohet të ketë qëndrueshmëri të lartë financiare, me kosto të ulta operative, për faktin se do të jetë ujësjellës me rrjedhje të lirë, duke pasur parasysh terrenin malor të zonës së mbulimit. Ky projekti do të shoqërohet me ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit si dhe ndërtimin e depos së ujit.

**PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË FINIQ**  
**HARTA E PROPOZUAR E RRJETIT T FURNIZIMIT ME UJË DHE MENAXHIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR**




Fig. 6: Harta e propozuar e rrjetit të furnizimit me ujë dhe menaxhimit të ujërave të ndotura (Burimi: Dea Studio)

Stafi i punës së UK Finiqit do të fokusohet në përmirësimin e rrjetit ekzistues të ujësjetësit në të gjithë territorin e bashkisë, në riparimet e amortizimeve, si dhe në moslejimin e ndërhyrjeve në rrjet pa respektuar hartën e shpërndarjes dhe pa praninë e specialistit të bashkisë. Gjithashtu do të realizohen kontrole periodike të cilësisë së ujit që shpërndahet në rrjet, për të trajtuar ujin e pijshëm dhe ruajtur sigurinë e tij.

Në zbatim të ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, zona rreth burimeve të ujit të pijshëm rrethohet dhe mbrohet, aty janë të ndaluara aktivitetet bujqësore, blegtorale, gjërmimet e depozitimet të cilat mund të kenë impakt në ndotjen e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore.

Duke ditur që investimet në rrjetin e furnizimit me ujë janë afatgjata e kërkojnë kohë dhe janë të kushtueshme financiarisht, është e rëndësishme, që investimet afatshkurtra dhe afatmesme në infrastrukturë të jenë të fokusuara në zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit për të mbuluar sa më shumë që të jetë e mundur zona të banuara.

Ndërhyrjet e propozuara nga Plani, në kuadër të përmirësimit të sistemit ekzistues të furnizimit me ujë të pijshëm për banorët, konsistojnë në:

- Ndërtimin e ujësjellësit të Leshnicës. Projekti përfshin ndërtimin e linjës parësore, dytësore, veprën e marrjes, stacionin e pompimit, kabinën elektrike si dhe furnizimin e saj me energji elektrike.
- Mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit dhe rrethim i depos së ujit për ujësjellësin Krongj-Finiq.
- Mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit Aliko-Neohor-Tremul.

#### **2.4 Sistemi i integruar i kanalizimeve dhe trajtimit të ujrave të ndotura**

Grumbullimi dhe përpunimi i ujërave të ndotura është një nga problemet më të mëdha me të cilat bashkia përballet sot, pasi asnjë nga njësitë administrative të bashkisë Finiq nuk ka impiante të trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotur, dhe zgjidhja e deritanishme e largimit të ujërave të ndotur është kolektori në një segment të shkurtër në Livadhja dhe gropat septike individuale, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë jashte standardeve higjeno-sanitare. Territori në masën 90% nuk është i mbuluar me rrjet kanalizimesh.

Plani propozon zgjidhjen e këtij problem nëpërmjet ndërtimit të rrjetit të kanalizimeve për qendrat e banuara rurale si edhe ndërtimin e tubacioneve, rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza që siguron lidhjen e qytetit me impiantin e trajtimit të ujrave.

Është shumë e rëndësishëm ndarja e ujrave të ndotur urbanë nga ujrat e shiut. Rrjeti infrastrukturor i propozuar i kanalizimeve do të ndjekë aksin qendror të rrugëve dhe kanalizimet do të orientohen jashtë zonës së banuar, për në impiantin e trajtimit. Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen pranë sipërfaqes (*për të parandaluar kontaminimin e mundshëm nga ujërat e ndotura urbane dhe ato të kanalizimeve*), në mes- tubat për ujërat e ndotura urbane/industriale dhe tubat e kanalizimeve më në thellësi.

Projekti i ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza në Finiq shikohet si projekti më i rëndësishëm në këtë kuadër, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe higjenës. Impianti që propozohet duhet të ketë teknologji që kombinohet me proceset biologjike dhe mekanike gjatë trajtimit të ujrave të zeza, që lejon optimizimin e efikasitetit të trajtimit në lidhje me kërkesat e energjisë. Planifikimi i ndërtimit të impiantit do të jetë në periferi të zonës së banuar në Finiq, pranë trupave ujorë, në lartësi më të ulët se zonat e banuara, në mënyrë që largimi i ujrave të realizohet me vetëderdhje.



Për ndërtimet e reja, bashkia do të sigurohet që objektet që do të pajisen me leje ndërtimit të lidhen në zgjerimet e rrjetit grumbullues sekondar dhe terciar, ndërsa gropat ekzistuese septike duhet të monitorohen, rehabilitohen apo mbyllen në mënyrë që të shmangët ndotja e tokës dhe ujërave nëntokësore. Meqënëse kjo do të kërkojë investime të mëdha, është propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit të përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe parametrave të cilësisë (p.sh. marrja e mostrave në rrjet, në vendin dhe në kohën e duhur për CSB, E.coli, etj). Në këtë mënyrë mund të arrihet zbutja e situatës së tanishme.

Për ndërtimet e reja në funksion të shërbimeve hoteliere me kapacitet më shumë se 20 shtretër/persona), do të duhen të ndërtohen impiante biologjike të veçanta të trajtimit të ujërave të ndotura, ku funksionimi i tyre do të mbikëqyret dhe kontrollohet nga inspektorati bashkiak.

Në plan janë propozuar konkretisht këto projekte për përmirësimin e situatës së rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e ujrave të ndotur:

- *Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujrave të zeza pranë Finiqit*
- *Ndërhyrje rikonstruktuese të rrjetit të kanalizimeve në Finiq.*
- *Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për qendrat e banuara rurale: Mesopotam, Dhivër, Aliko, Dhrovjan, Livadhja.*
- *Ndërhyrje për përmirësimin e gjendjeve fizike dhe higjenike të gropave septike, për plotësimin e standardit, në fshatrat e tjerë të bashkisë.*

## **Udhëzues për projektet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet**

### **A. Faza e projektim/planifikimit:**

- Duhet bërë një studim kompleks (ekonomik, hidrogjeologjik, social), që të ofrojë më shumë se një alternativë. Më i miri duhet të zgjidhet bazuar në:
  - Koston.
  - Mundësitë e financimit.
  - Kohës së zbatimit.
  - Kostove të funksionimit.
  - Teknologjisë.
  - Fleksibilitetit të funksionimit të rrjetit, etj.
- Hartimi i projekteve sipas burimeve të financimit dhe prioriteve.
- Ndarjen e ndërtimit të rrjetit të furnizimit me ujë në seksione, bazuar në njësitë hidraulike (burim, puse, vepërmarrje).

- Disa fshatra të bashkisë mund të kenë rrjete të përbashkëta kolektorësh të ujërave të zeza, në varësi të kushteve duke bërë vlerësime për çdo rast dhe sigurisht i realizuar/zbatuar në faza.

#### B. Faza e zbatimit:

- Të gjitha projektet parciale duhet të marrin në konsideratë studimin afatgjatë dhe rajonal të furnizimit me ujë.
- Monitorim të rregullt të cilësisë së ujit të pishëm nëpërmjet analizave kimike dhe bakteriologjike (sipas kritereve të Këshillit të Evropës).
- Shpërndarje dhe menaxhim sa më të mirë të ujit për një funksionim sa më të mirë të sistemit.

### **2.5 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike**

Furnizimi me energji në bashkinë e Finiqit nuk është i rregullt dhe lehtësisht i konstatueshëm është tensioni i ulët i energjisë. Sistemi i shpërndarjes është relativisht i vjetër dhe i amortizuar. Gjatësia totale e linjave të tensionit të mesëm (TM) shkojnë rreth 252 km. Tensioni i operimit është 10 kV dhe 6 kV. Nënstacionet nga të cilat ushqehen fiderat janë:

- Nst. Sarandë 110/20 kV, nga i cili del Fideri 20 kV OLM 4.
- Nst. Sarandë 35/10 kV nga i cili del Fideri 10 kV i Vrionit.
- Nst. Livadhja 35/10 kV nga i cili dalin Fiderat 10 kV Partizan, Jeta e Re, Janjar dhe Lefter Talo.
- Nst. Delvine 35/10 kV nga i cili del Fideri 10 kV SMT.
- Nst. Bistrice 35/6 kV nga i cili dalin Fiderat Nafta 1, Nafta 2, Bistrice, Livine dhe Miniere.

Për përmirësimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, plani sugjeron nxjerrjen nga puna e nën-stacionit të Bistricës 35/6 kV dhe orienton zëvendësimin e linjave të transmetimit të tensionit të mesëm, nga 6 e 10 kV në 20 kV, pasi ky tension është më i përshtatshëm dhe i sigurt. Këto ndërhyrje do duhet të shoqërohen edhe me rikonstrukcionin e rrjetit, kabinave elektrike dhe transformatorëve. Në total ndërhyrjet do të shtrihen në 252 km linja tensioni të mesëm, si dhe do ndërhyet në përmirësimin e kushteve teknike të kabinave elektrike. Pritet që këto investime të minimizojnë humbjet në rrjet, të ulin kostot e mirëmbajtjes dhe të rrisin stabilitetin e tensionit për të ofruar një shërbim sa më të mirë dhe të sigurt për konsumatorët industrial/ekonomik apo familjarë të energjisë elektrike.

Rekomandohet shtrirja e linjave të shpërndarjes së TM nga kabinat e shpërndarjes deri te konsumatorët të realizohet me futjen e tyre nëntokë, përveç rasteve të veçanta kur topografia apo kushtet tenike nuk e lejojnë diçka të tillë.

Plani do fokusohet në marrjen e masave të mëposhtme:

- Modifikimi i karakteristikave teknike në shpërndarje (ndarjen e dy linjave të tensionit të lartë nga 35 në 110 kV);
- Modifikimi i voltazhit të mesëm nga 6 e 10 KV në 20 kV;
- Modifikimi i duhur i nënstacioneve;
- Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët.

### **2.5.1 Ndryçimi publik**

Rrjeti i ndryçimit publik në territorin e bashkisë përbëhet nga ndryçimi i rrugëve, i trotuara, hapësirave publike dhe i fasadave të objekteve publike. Qëllimi i ndryçimit publik është rritja e sigurisë në rrugë apo hapësira publike gjatë natës, për këtë arsye projektet e rrjetit rrugor, ato të rikonstruksionit të hapësirave të ndryshme si sheshe apo parqe, ato mes pallateve etj, do tu kushtohet një rëndësi e madhe në përfshirjen e sistemit të ndryçimit sipas parametrave të projektimit. Vendosja e ndryçimit aty ku duhet, do të sjellë rritjen e sigurisë në rrugë për të gjithë përdoruesit e saj, që nga shoferët, këmbësorët e çiklistët, si dhe do lehtësojë leximin e shenjave sinjalizuese dhe tabelave të orientimit të trafikut.

Plani rekomandon unifikimin e ndryçuesve dhe ndarjen e tyre në kategoritë e mëposhtme:

- Ndryçuesit rrugorë të cilët vendosen në anë të rrugëve, rekomandohet përdorimi i llampave LED ose ndryçues me panele diellore. Intesiteti i nivelit të ndryçimit duhet të përcaktohet sipas tipologjisë së rrugës, si dhe ndryçimin e veprave si rrethrotullimet apo kryqëzimet. Distancat e rekomanduara të shtyllave të ndryçimit nga njëra-tjetra variojnë nga lartësia e tyre dhe tipologjia e rrugës ku do të vendosen.
- Ndryçuesit e trotuareve apo shesheve, për të cilat rekomandohet një lartësi me e ulët se ndryçuesit rrugorë dhe përdorimi i llampave halogjene LED. Një vëmendje e veçantë do ti kushtohet ndryçuesve në parqe, të cilët do të vendosen duke respektuar vendet e pushimit dhe shërbimeve.
- Ndryçuesit e fasadave dhe artit publik, kjo kategori ndryçuesish rekomandohet të jetë me dritë të bardhe LED dhe vendosja e tyre duhet të nxjerrë në pah karakteristikat arkitektonike të objekteve, duke u montuar në fasade apo në tokë dhe duke u drejtuar siç duhet, duke krijuar zona tërheqëse për këmbësorët.

## **2.6 Telekomunikacioni**

Territori i bashkisë Finiq mbulohet me sinjal telefonik dhe me rrjet të shërbimit të interneti 2G, 3G dhe pjesërisht me 4G, nëpërmjet 3 antenave të telekomunikacionit të vendosura në: një në afërsi të fshatit Pecë në pjesën veriore të bashkisë, e dyta në afërsi të kufirit me bashkinë Sarandë, pranë fshatit Dritas dhe e treta në afërsi të kufirit me bashkinë Konispol, pranë fshatit Vagalat. Territori i bashkisë mbulohet pothuajse i gjithi me shërbim nga këto antena. Në pjesën

veri-perëndimore të bashkisë, ku mbizotëron terreni fushor ka mbulim të plotë dhe ofrohet një shërbim interneti më shpejtësi mesatarisht të lartë. Në pjesën jug-lindore të bashkisë, ku mbizotëron terreni malor nuk ka mbulim të mirë, shpejtësia është e ulët dhe dallohen edhe zona që nuk mbulohen nga ky shërbim.

Në territorin e bashkisë ka filluar gjithashtu puna për shtrimin e rrjetit të fibrave optike, sipas Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.2, datë 05.05.2015 *“Leje ndërtimi për punimet civile të “Rrjetit ndërurban kabllor me fibër optike”, në akset nacionale rrugore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe “Qendra për shkëmbimin e internetit dhe përpunimit të të dhënave BIX-Tirana”*”.

Në vijim të shtrirjes së rrjetit të fibrave optike, në të gjithë ndërhyrjet e infrastrukturave rrugore të parashikuara në plan për rikonstrukcion apo ndërtim, bashkia do të kujdeset që pjesë e projekteve të jetë edhe shtrimi i rrjetit nëntokësor për fibrat optike, duke siguruar kështu zhvillim ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët e saj. Qëllimi është pajisja me infrastrukturë të rrjetit të telekomunikacionit të gjithë projektet dhe investimet e miratuara nga bashkia dhe mbulimi me fibra optike të të gjithë zonës së banuar dhe zonave turistike. Gjithashtu do të sigurohet shërbimi i mbulimit me Ëi-Fi në sheshe, parqe, zona turistike etj, me navigim të sigurt edhe për fëmijët. Këto investime pritet të sjellin përmirësim të shërbimeve telefonike, digjitale dhe internet për të gjithë banorët, duke ndikuar pozitivisht edhe në zhvillimin turistik të zonës.

## **2.7 Menaxhimi i mbetjeve**

Mungesa e një pike grumbullimi dhe përpunimi për mbetjet urbane është një shqetësim serioz për bashkinë e Finiqit. Referuar sasisë së mbetjeve të gjeneruara për fryme, për zonat rurale, sasia e mbetjeve të prodhuara është 0.4 kg/person/ditë, ndërsa për zonat urbane me popullsi deri në 25 000 banorë, kjo sasi prodhimi mbetjesh është 0.7kg/person/ditë. Aktualisht bashkia Finiq mbetjet urbane i depoziton në Landfillin e Bajkajt me kapacitet 365 000 m<sup>3</sup> dhe i cili është llogaritur për depozitimin e 25 000 m<sup>3</sup> mbetje në vit. Siç ishte parashikuar që në fillim, në landfill dërgojnë dhe depozitojnë mbetjet e tyre 5 Bashki: Sarandë, Himarë, Delvinë, Finiq dhe Konispol.

Aktualisht, shërbimi i pastrimit në bashkinë Finiq nuk mbulon gjithë territorin. Ai ofrohet vetëm në fshatrat që kanë popullsi të lartë si Finiq, Aliko dhe Livadhja. Në këto fshatra janë vendosur kontenierë, të cilët transportohen me mjete të hapura në Landfillin e Bajkajt. Ndërsa në fshatrat si Vrion, Krane, Mesopotam, Dermish, Çaus, Vagalat, Dhivër, Clirim, Karahaxh mbetjet trajtohen duke i grumbulluar dhe larguar. Pjesa tjetër e fshatrave nuk mbulohen me shërbim pastrimi.

Bashkia Finiq duhet të punojë për zgjerimin e sistemit të mbledhjes dhe grumbullimin e mbetjeve nëpër fshatra, dhe depozitimin e tyre drejt landfillit të Bajkajt, duke ulur kështu ndotjen e tokës dhe të ujrave nëntokësore dhe sipërfaqësore që janë pjesë e territorit të saj.

Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe ndërtimi është pjesë e infrastrukturës dhe duhet të bazohet në Ligjin Nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mjedisor të mbetjeve të ngurta”. Eliminimi i tyre kontribuon në mbrojtjen e shëndetit të banorëve, në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe cilësinë e saj, ekuilibrin ekologjik, në turizëm, si edhe në ruajtjen afatgjatë të burimeve natyrore. Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe atyre të ndërtimit në përgjithësi nënkupton:

- Grumbullimin në çdo fshat dhe qytet të këtyre mbetjeve sikurse dhe pastrim rrugësh
- Transportimin nga fshati në pikën e grumbullimit;
- Trajtimin dhe depozitimin apo riciklimin e tyre.

Nga analiza e grumbullimit të mbetjeve urbane dhe të ndërtimit rezulton se grumbullimi i tyre nëpër vendet e caktuara në Bashki është i mangët. Ka grumbullime masive të këtyre mbetjeve në anë të rrugëve, në luginat e përrenjve dhe lumenjve, në lëndinat buzë detit etj., dhe gjendja e kazaneve të plehrave është e mjerueshme pothuajse kudo ku ka dhe aty nuk ka fare, gjë që sjell një impakt negativ për turizmin dhe cilësinë e jetës në zonë. Një grumbullim i mirë i mbetjeve është një fillim i mbarë për menaxhimin e tyre. Sidoqoftë, menaxhimi i tyre duhet të ndajë *mbetjet urbane nga ato të ndërtimit*.

### Sugjerime

1. Së pari, çdo fshat duhet të përcaktojë një ose disa **pika të grumbullimit** (në varësi të numrit të banoreve, e cila mund të arrihet lehtë nga automjetet e kompanisë së pastrimit. Pika e grumbullimit duhet të ketë kazanë me mbishkrime, që të mundësojnë seleksionimin (grumbullim i diferencuar) e tyre sipas përbërjes së tyre si ushqimore, letër, qelq, lëndë metalike dhe plastike. Ky seleksionim do ta lehtësojë shumë procesin, si edhe do të rrisë interesimin e kompanive të specializuara për përpunimin e mbetjeve urbane. Në fshatra banorët duhet patjetër t’i hedhin mbeturinat e tyre në vendet e caktuara dhe jo nëpër rrugicat e fshatit.
2. Së dyti, një tjetër domosdoshmëri është edhe **optimizmi i kohës** së largimit të këtyre mbetjeve duke eliminuar çlirimin e aromave të këqija në mjedis, tejmbushjen e kazanëve dhe vendgrumbullimeve me mbetje urbane. Grumbullimi mund të bëhet edhe një herë në dy ose tre ditë.
3. Së treti, një **fushatë ndërgjegjësimit** është e nevojshme që të ndërmerret nga ana e Bashkisë lidhur me mbetjet urbane. Kjo mund të bëhet përmes mediave lokale, nëpër shkolla, me shpërndarje fletëpalosjesh, si edhe me fushata ndërgjegjësimiti nëpër fshatra. Kjo fushatë duhet të përfshijë jo vetëm të rriturit, por edhe fëmijët; jo vetëm familjarët, por në mënyrë të veçantë pronarët e bareve dhe restoranteve, pasi këta të fundit gjatë sezonit të verës janë ndër ndotësit më të mëdhenj. Pjesëmarrës në këto fushata duhet të jenë edhe pronarët e industrisë së zonës ku të përfshihen ata të industrisë së vajit, peshkimit, ndërtimit, transportit etj.
4. Së katërti, organizimi i **aksioneve vullnetare** nga ana e komunitetit në çdo fillim viti, do të ishte një mënyrë e mirë për krijimin e një klime pozitive në Bashki.
5. **Mbetjet e ndërtimit**: Mbetjet e ndërtimit konsiderohen si më pak të dëmshme për ekologjinë dhe shëndetin e njeriut, por nga ana vizuale prania e tyre në anë të rrugëve apo pranë ndërtimeve dëmton pejzazhin e zonës në tërësi. Në bazë të Ligjit Nr. 9010, datë 13.2.2003 përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit bëhet me ripërdorim dhe groposje.

**Transportimi i mbetjeve** është momenti i dytë i rëndësishëm i menaxhimit të këtyre mbetjeve. Sigurisht që transporti duhet të bëhet me mjete dhe pajisje profesionale, të cilat duhet të sigurohen nga Bashkia apo kompania e pastrimit. Transporti mund të kryhet edhe çdo ditë. Përsa i përket transportit të mbetjeve të ndërtimit, duhet të sigurohet nga firmat e ndërtimit, pasi ato duhen konsideruar si zotërues të këtyre mbetjeve. Transporti i tyre duhet të kryhet me automjete, të cilat të jenë të mbuluara në mënyrë që të mos ketë mbetje që bien gjatë rrugës për në stacionin e përkohshëm apo në vendgrumbullim.

**Depozitimi i mbetjeve urbane**, siç u theksua më lart, do të bëhet në landfillin e Bajkajt, në Delvinë. Përsa i përket depozitimit të mbetjeve të ndërtimit mund të bëhet pranë gurove dhe atje të groposen apo të përpunohen, ose Bashkia në bashkëpunim me Agjensinë Rajonale të Mjedisit të caktojë një hapësirë për groposje të veçantë për mbetjet e ndërtimit, që mund të jetë edhe pranë stacionit të përkohshëm (tranzitor). Depozitimi i tyre mbetet detyrë e firmave të ndërtimit. Në vendin e groposjes shtrati i gropës duhet të vishet me materiale gjeosintetike për të shmangur në këtë mënyrë ndotjen e ujërave nëntokësore.

### **Trajtimi i mbetjeve**

Trajtimi i mbetjeve urbane në vendgrumbullimin përkatës mbetet detyrë e organeve kompetente. Trajtimi i mbetjeve të ndërtimit mund të bëhet pranë gurove ekzistuese, që nuk gjenden pranë lumenjve dhe rrugës automobilistike kombëtare. Në përgjithësi menaxhimi i mbetjeve jepet me sipërmarrje duke nënkontraktuar kompanitë private, por edhe mund të kryhet drejtpërsëdrejti nga institucioni publik përgjegjës, në rastin konkret bashkia e Finiqit. Gjithashtu, ndërtimi dhe përdorimi i vendeve për groposjen e mbeturinave mund të realizohet nga sektori privat ose nëpërmjet një kontrate të Partneritetit Publik e Privat.

## **2.8 Plani për hapësirat publike dhe shërbimet sociale**

### **2.8.1 Hapësirat publike**

#### **Finiq**




Fig. 7: Zonimi i Fierit, Përpunimi: DEA studio

Si qendër me karakter urban në këtë territor, këtu gjejmë përqëndrimin më të madh të popullsisë edhe të aktiviteteve sociale, ekonomike dhe administrative. Ndërhyrjet e propozuara për përmirësimin e hapësirave publike në Fier përqëndrohen tek ri-organizimi i hapësirave të lira në mënyrë që të bëhen më tërheqëse për banorët. Ky riorganizim do të shërbejë jo vetëm zhvillimit të hapësirave publike por edhe plotësimit me shërbime, kryesisht përgjatë akseve kryesore rrugore brenda qendrës së banuar. Këtu mund të përmendim përmirësimin e bulevardit për kthimin në pedonale, plotësimin me mobilim urban, përmirësimi i fasadave, krijimi i shtigjeve për aksesimin e Amfiteatrit të Fierit etj.

## Mesopotam




Fig. 8: Fshati Mesopotam 2019, Përpunimi: DEA studio

Qendra urbane e Mesopotamit ndodhet në pjesën veriore të bashkisë Finiq. Mund të arrihet lehtësisht nga fshatrat përreth dhe është një kalim i detyrueshëm pasi përmes saj kalon aksi rrugor kombëtar Sh99, rruga Finiq - Muzinë. Ky pozicion ka luajtur një rol të rëndësishëm për zhvillimin e kësaj qendre dhe do të luajë edhe në të ardhmen. Propozimi i planit për përmirësimin e kësaj qendre është në drejtim të përmirësimit të hapësirës ekzistuese publike duke krijuar një shesh qendror, me gjithë mobilimin urban, përmirësimi i hapësirës përreth Manastirit të Shën Kollit, e cila ndodhet shumë afër qendrës. Përsa i përket infrastrukturës do të ngrihet një pikë stacioni për transportin publik, do të pajiset me ndriçim publik qendra e fshatit dhe aksi kryesor rrugor dhe do të përmirësohen hapësirat publike si fushat sportive apo lulishtet. Ky investim në funksionet e reja publike së bashku me përmirësimin e rrugës kryesore të komunikimit dhe përmirësimin e tokës do të ketë një ndikim të rëndësishëm për zhvillimin e kësaj njësie.



## Dhrovjan




Fig. 9: Fshati Dhrovjan 2019, Përpunimi: DEA studio

Qendra urbane e Dhrovjan ka gjithashtu pozicion strategjik në bashkinë e Finiqit. Fshati është në pjesën lindore të Njësisë Administrative Mesopotam. Arrihet nga rruga Muzinë – Dhrovjan. Fshati ka potenciale të larta zhvillimi të turizmit për shkak të pasurive të larta natyrore dhe kulturore. Propozimi i planit për përmirësimin e kësaj qendre është në drejtim të përmirësimit të hapësirës ekzistuese publike duke krijuar një shesh qendror, me gjithë mobilimin urban. Përsa i përket infrastrukturës do të ngrihet një pikë stacioni për transportin publik, do të pajiset me ndriçim publik qendra e fshatit dhe aksi kryesor rrugor dhe do të përmirësohen hapësirat publike si fushat sportive apo lulishtet. Ky investim në funksionet e reja publike së bashku me përmirësimin e rrugës kryesore të komunikimit dhe përmirësimin e tokës do të ketë një ndikim të rëndësishëm për zhvillimin e kësaj njësie.

## Dërmish




Fig. 10: Fshati Dërmish 2019, Përpunimi: DEA studio

Fshati i Dërmishit është i pozicionuar në pjesën perëndimore të Njesisë Administrative Dhivër. Arrihet nga rruga Sh97, Finiq - Livadhja. Ky pozicion ka luajtur një rol të rëndësishëm për zhvillimin e kësaj qendre dhe do të luajë edhe në të ardhmen. Propozimi i planit për përmirësimin e kësaj qendre është në drejtim të përmirësimit të hapësirës ekzistuese publike duke krijuar një shesh qendror, me gjithë mobilimin urban. Përsa i përket infrastrukturës do të ngrihet një pikë stacioni për transportin publik, do të pajiset me ndriçim publik qendra e fshatit dhe aksi kryesor rrugor dhe do të përmirësohen hapësirat publike si fushat sportive apo lulishtet. Ky investim në funksionet e reja publike së bashku me përmirësimin e rrugës kryesore të komunikimit dhe përmirësimin e tokës do të ketë një ndikim të rëndësishëm për zhvillimin e kësaj njësie.

Në fshatin Dërmish është propozuar gjithashtu ngritja e një pike grumbullimi për produktet bujqësore, çka do të mobilizojë banorët për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori të bujqësisë dhe rrjedhimisht të rrisë nivelin ekonomik dhe të përmirësojë mirëqënien e banorëve.

## Leshnicë e Sipërme




Fig. 11: Fshati Leshnicë e Sipërme 2019, Përpunimi: DEA studio

Qendra urbane e Leshnicës së Sipërme është i pozicionuar në pjesën lindore të Njësisë Administrative Dhivër. Arrihet nga rruga Cerkovicë – Leshnicë - Kërrë. Propozimi i planit për përmirësimin e kësaj qendre është në drejtim të përmirësimit të hapësirës ekzistuese publike duke krijuar një shesh qendror, me gjithë mobilimin urban, përmirësimi i hapësirës përreth kishës, e cila ndodhet shumë afër qendrës. Përsa i përket infrastrukturës do të përmirësohet gjendja e aksit rrugor kryesor nëpërmjet të cilit aksesohet fshati, do të ngrihet një pikë stacioni për transportin publik, do të pajiset me ndriçim publik qendra e fshatit dhe aksi kryesor rrugor dhe do të përmirësohen hapësirat publike si fushat sportive apo lulishtet. Ky investim në funksionet e reja publike së bashku me përmirësimin e rrugës kryesore të komunikimit dhe përmirësimin e tokës do të ketë një ndikim të rëndësishëm për zhvillimin e kësaj njësie.

Fshati i Leshnicës ka potenciale të larta për zhvillimin e ekoturizmit, për shkak të pasurive natyrore që zotëron.

### 2.8.2 Edukimi

Në Bashkinë Finiq funksionojnë sot 10 (dhjetë) kopshte fëmijësh (të Livadhjasë, Dërmishit, Alikos, Mesopotamit, Vrionit, SMT-së, Karahaxhit, Navaricës dhe Finiqit), 6 (gjashtë) shkolla 9-të

vjeçare (të Finiqit, Mesopotamit, Livadhjasë, Alikos, Vrionit, Navaricës) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) shkolla të arsimit të ulët fillor (të Finiqit, SMT-së, Vrionit, Karahaxhit, Vromerosë, Mesopotamit, Kranesë, Bisticës, Muzinës, Livadhjasë, Dërmishit, Navaricës, Dhivrit, Leshnicës, Alikos).  
Funksionon gjithashtu shkolla e mesme publike “Lefter Talo” në Livadhja si dhe kolegji privat “Frymë Dashurie” në Mesopotam.

Sigurimi i objekteve arsimore është një pjesë integrale e planifikimit të politikave dhe praktikave moderne. Arsimi fillor dhe ai i mesëm, i ofrojnë brezit të ri mjetet teorike dhe praktike, që do të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik. Planifikimi ka për qëllim të sigurojë objekte të mjaftueshme, ndërsa parimi themelor për funksionimin efikas të objekteve arsimore është aksesueshmëria në to.

**Objekte e arsimit bazë** (çerdhet, kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare):

- Për zonat urbane, në Finiq parimi i aksesit është i përfshirë në planifikimin e objekteve të arsimit fillor, të cilat janë të lidhur me lagjet, duke siguruar qasje me rrugët lokale dhe dytësore të lagjeve. Distancat ajrore të mbulimit të zonave të shërbimit respektojnë dispozitat kombëtare të planifikimit.
- Për zonat rurale i cili është rasti më i ndeshur në territorin e Bashkisë, objektet arsimore kanë një mbulim të vogël rajonal, për shkak të terrenit dhe të vendbanimeve, popullsisë së vjetër dhe numrit të kufizuar të nxënësve. Ato duhet të jenë të vendosura në qendrat e njësive të banuara. Është e nevojshme që të lehtësojë sa më shumë të jetë e mundur aksesin e nxënësve në objektet arsimore dhe edukative, për shembull nëpërmjet autobuzëve dhe të sigurimit të vendstacioneve të tyre për të siguruar transportin e sigurtë të nxënësve, që përdorin autobuzët e shkollave.

**Objektet e arsimit të mesëm** (shkollat e mesme, qendrat profesionale dhe shkollat, etj), duhet të pozicionohen në zona që kanë aksesibilitet të lartë, përfshirë edhe transportin publik.

Plani propozon rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare në Finiq, ndërtimin e shkollës së mesme të profilizuar në Finiq dhe restaurimi i godinave arsimore ekzistuese. Këto ndërhyrje të propozuara nuk mbeten të kufizuara vetëm në fshatrat si më sipër. Sipas nevojës në vijimësi të planit bashkia do të ndërhyjë me restaurime apo rikonstruksione për të gjithë ato godina arsimore në qendrat e banuara të cilat do i kenë të nevojshme këto ndërhyrje. Ndërhyrjet do të jenë edhe në veshjen e godinave, edhe në interior edhe në pajisjet e klasave. Hapësirat publike të shkollave, duke përfshirë oborret, ambientet sportive, bibliotekat apo salat e mësimin, propozohet të përdoren edhe nga komuniteti jashtë orëve mësimore, duke shërbyer si qendra sociale.

Me përjashtim të shkollës së mesme të profilizuar, plani nuk parashikon ngritjen e pikave të reja arsimore, për arsye se strukturat ekzistuese i plotësojnë nevojat e popullsisë dhe indikatorin e popullsisë është në rënie.

### 2.8.3 Shërbimi shëndetësor

Infrastruktura shëndetësore. Shërbimi shëndetësor mbulohet nga qendrat shëndetësore të cilat janë të lokalizuara në qendrat e njësive administrative: Livadhja, Dhivër, Aliko, Finiq dhe Mesopotam. Në total funksionojnë 5 qendra shëndetësore. Ndërsa në fshatra shërbimi shëndetësor ofrohet në ambulanca. Për vizita mjekësore më të specializuara banorët udhëtojnë drejt Sarandës për të marrë këto shërbime në spitalin e qytetit.

Për një shërbim më të mirë shëndetësor ka nevojë për investime për përmirësimin e infrastrukturës fizike shëndetësore si: rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore në Livadhja. Investimet dhe shërbimet publike duhet të forcohen në qendrat e njësive administrative, dhe kriteri i urgjencës të ishte udhëzuesi për investimet në njësitë administrative periferike të bashkisë, ku popullsia e vogël është e shpërndarë në një numër të madh të fshatrave. Duke forcuar shërbimet publike në qendër të njësive administrative nga njëra anë, nga ana tjetër duhet të rritet aksesin e banorëve që jetojnë përreth qendrës administrative ndaj këtyre shërbimeve.

Sigurimi i objekteve të kujdesit shëndetësor është një komponent thelbësor i standardeve të pranuar të jetesës dhe një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, të bazuar në shërbime cilësore. Vëmendje e veçante duhet t'u kushtohet banorëve të përhershëm të zonës (sidomos në rastet e popullsisë në moshë të madhe (plakje), si dhe për vizitorët dhe turistët nga perspektiva e rritjes së parashikuar të sektorit të turizmit.

Sipas standardeve dhe kushteve aktuale funksionale dhe fizike në të cilën ndodhen aktualisht godinat shëndetësore plani propozon:

- Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore në Livadhja
- Ndërtimi i ambulancave në fshatrat: Cerkovicë, Leshnicë e Sipërme, Karroq, Zminec, Vagalat, Pandelejmon, Kodër

Qendrat shëndetësore e propozuara në fshatrat si më sipër, janë të nevojshme për arsye të mbulimit të të gjithë banorëve me këtë shërbim. Për shkak se fshatrat ndodhen në distanca të konsiderueshme nga njëri-tjetri, këto qendra duhet të jenë të shpeshta dhe pothuajse të shërbejnë të çdo fshat.

Përsa i përket godinave të tjera shëndetësore ekzistuese, ato kanë nevojë për ndërhyrje restauruese jo vetëm në pjesën e jashtme të tyre por edhe në ato të brendshme, si edhe në zëvendësimin e pajisjeve të amortizuara. Nevojë për ndërhyrje kanë edhe ambientet rrethuese të godinave.

Këto ndërthurje të propozuara nuk mbeten të kufizuara vetëm në fshatrat si më sipër. Sipas nevojës në vijimësi të planit bashkia do të ndërhyjë me restaurime apo rikonstruksione për të gjithë ato godina arsimore në qendrat e banuara të cilat do i kenë të nevojshme këto ndërthurje.

#### **2.8.4 Varrezat**

Një nga objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor është edhe përmirësimi i gjendjes së varrezave ekzistuese dhe përcaktimi i zonave të reja të zgjerimit, veçanërisht për ato në zonat kryesore urbane.

Për varrezat ekzistuese, kryesisht ato të cilat janë afër zonave urbane, afër shërbimeve publike si arsimit apo shëndetësia si edhe për ato hapësira të cilat janë buzë apo afër akseve rrugore kryesore të bashkisë, është shumë e rëndësishme të zvogëlohet ndikimi i tyre vizual. Plani propozon mbjellje e rreshtave të pemëve dhe shkurreve të vogla përgjatë rrugës kryesore të brendshme dhe perimetrit të jashtëm në mënyrë që të krijojë një pengesë natyrore vizuale të integruar në mjedis. Pemët duhet të integrohen pemët halore me ato me gjetherënëse, të cilat duhet të kenë kurorë të madhe dhe të ulët, për një bllokim të plotë të pamjës. Një sistem i duhur i kullimit duhet gjithashtu të integrohet me ndërhyrjet e tilla pas një studimi të detajuar të tij.

#### **2.8.5 Mbrojtja kombëtare, civile kundër zjarrit**

Në kuadër të politikave për mbrojtjen e zonave të rrezikuara, është e domosdoshme nevoja e një monitorimi të rreptë dhe aplikimit të plotë të ligjit për Pyjet Nr 9385/2005 ndryshuar me Nr. 48/2016. Monitorimi i pyjeve është i domosdoshme për t'i mbrojtur ato nga djegiet aksidentale si pasojë e praktikave të gabuara në zonë për djegien e kullotave apo për shkak të prerjes së drurëve për qëllim ngrohjeje. Zonat e mbrojtura janë të rrezikuara si pasojë e presioneve të zhvillimit në zonë. Dëmi që vjen nga djegiet dhe prerjet e druve nuk lidhet vetëm me pyjet por edhe me llojet e rralla dhe endemike që i përdorin ato si habitate.

Kërcënimi kryesor për zonën shikohet zjarri dhe pasojat e tij duke rritur në këtë mënyrë edhe shkallën e erozionit. Terreni i vështirë malor si edhe rrjeti rrugor i amortizuar apo shpeshherë edhe jo i përshatshëm për mjetet e rënda të zjarrëfikëseve janë faktorë që shtojnë shkallën e rrezikut në bashki në rast zjarri.

Strategjia për mbrojtjen kundër zjarrit parashikon aktivitetet si më poshtë:

- Përmirësim të shërbimit ekzistues zjarrfikës (vënia në dispozicion e mjeteve të reja, përmirësimi i ndërtesës)
- Pajisje me sisteme të përshtatshme të mbrojtjes nga zjarri dhe formimin specifik
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për kontributin e përbashkët midis komuniteteve

dhe shërbimit zjarrfikës.

Në zonat malore duhet të merren masa për të evituar erozionin, duke evituar ndërtimet përgjatë brigjeve të lumenjve, duke rehabilituar përrrenjtë, duke ndërtuar prita malore si dhe duke kryer mbjellje në shpatet e pjerrëta.

Në mënyrë më të detajuar këto masa janë sqaruar në dokumentin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

### **3 Plani i mbrojtjes së mjedisit**

Ekonomia bujqësore dhe blegtoria përbëjnë sot bazën e aktiviteteve ekonomike në bashkinë e Finiqit, ndërkohë që në zhvillimin e ardhshëm të bashkisë, Plani i Përgjithshëm Vendor synon ti gërshetojë këto aktivitete me industrinë e turizmit. Duke qenë se pritet që turizmi, agroturizmi dhe infrastruktura të përmirësohet në territor dhe të ketë një impakt në zhvillimin ekonomik të bashkisë, lind nevoja e parandalimit dhe monitorimit të ndikimeve negative që mund të kenë në mjedis zbatimi i planit dhe projektet e propozuara nga ky plan.

Në planin e mbrojtjes së mjedisit do të trajtohen masat parandaluese, mbrojtëse e zbutëse që lidhen me zbatueshmërinë e projekteve të propozuara nga PPV-ja me qëllim mbrojtjen e peizazhit, mbrojtjen e burimeve ujore, mbrojtjen e biodiversitetit dhe shtimin e gjelbërimit, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe masa për trajtimin e zonave problematike mjedisore.

Gjatë zbatimit të projekteve, institucioneve publike dhe zhvilluesve të këtyre projekteve u lind detyrimi për të zbatuar dhe marrë masat për mbrojtjen e mjedisit, sipas rekomandimeve të VSM-së, si dhe masa më të detajuara për projektet që i nënshtrohen hartimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM-ve) individuale për secilin projekt, nëpërmjet zbatimit të Ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i cili përcakton kushtet e zbatimit të një projekti në respekt me mjedisin. Procesi i monitorimit të VSM-së duhet të ecë paralelisht me zbatimin e PPV-së duke u bërë pjesë integrale e tij.

#### **3.1 Mbrojtja e peizazhit natyror e urban**

Projektet e propozuara nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Finiq përgjithësisht nuk priten të ndikojnë negativisht në peizazh, vetëm projektet si zgjerim i infrastrukturave rrugore ekzistuese dhe ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Finiq do të kenë një ndikim minimal. Megjithatë këto projekte do të shoqërohen me mbjellje pemësh përgjatë rrugëve dhe krijimin e zonave buferike të gjelbërta që ndan impiantin e trajtimit të ujërave të zeza nga zona e urbanizuar.

***Rekomandime për mbrojtjen e peizazhit:***

- *Mbrojtja e peizazhit natyror*

Nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit të zonave të degraduara ose të dëmtuara nga zjarret, realizohet përmirësimi i peizazhit natyror, ku duhen zgjedhur me kujdes llojet e drurëve që përshataten me llojin e tokës dhe të mbrojnë atë nga erozioni. Përfitime të tjera që vijnë nga ruajtja e peizazhit natyror janë mbrojtja e tokës nga erozioni, ulja e ndotjes në shtresat e tokës, krijimi i habitateve për rritjen e specieve të florës dhe faunës, etj.

Në pikat panoramike, kryesisht në zonën e mbrojtur të Monumentit të Natyrës Syri i Kaltër dhe rreth liqenit të Butrintit, bashkia në bashkëpunim me AKZM, duhet të krijojë infrastrukturë të nevojshme si markimin e shtigjeve për këmbësorët apo çiklistët, vendosjen e tabelave informuese dhe përcaktimin e vendeve të pushimit.

- *Mbrojtja e peizazhit urban*

Zonat ekonomike dhe ato të industrisë së lehtë përpunuese duhet të shoqërohen me breza mbrojtës të gjelbëruar, për të realizuar kështu mbrojtjen e zonave të banuara. Sektori i bujqësisë gjithashtu duhet të ruajë mjedisin duke mirëmbajtur kanalet vaditëse dhe kulluese dhe mbjellë pemë përgjatë parcelave bujqësore. Rekomandohet zbatimi i masave për ruajtjes e peizazhit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së.

Peizazhi urban i ndërtuar do të pëmirësohet me anë të projekteve për rikualifikimin e hapësirave publike, mbjelljen e pemëve dhe gjelbërimin mes pallateve, krijimin e hapësirave argëtuese për fëmijët etj. Për çdo ndërhyrje në vendbanimet urbane apo rurale do të respektohen karakteristikat e arkitekturës vendase, psh në fshatrat kodrinorë do të nxitet ndërtimi i njësive të reja të banimit me mbulesë çati dhe për objektet me vlera arkitekturore e historike do synohet rehabilitimi dhe rifunksionalizimi i tyre.

Një vëmendje të veçantë do të kushtohet pasurive kulturore, ku çdo ndërhyrje në distancë 100 m nga objekti i trashëgimisë kulturore është e ndaluar dhe duhen marrë në konsideratë distancat sipas akteve dhe udhëzimeve të institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

### **3.2 Mbrojtja e burimeve ujore**

Burimet ujore janë shumë të rëndësishme si kapacitete të zhvillimit ekonomik dhe mund të ndikohen negativisht nga nxitja e industrisë përpunuese në zonë, nga bujqësia apo zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit natyror. Duhet që zhvillimi ekonomik i zonës të mos dëmtojë ekosistemet lumore dhe të ketë monitorim të vazhdueshëm të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MTM.

Mbrojtja e trupave ujore nga aktivitetet dhe ndërtimet realizohet nëpërmjet përcaktimit të vijës blu nga Plani i Përgjithshëm Vendor, me qëllim mbrojtjen e rrjedhave lumore e rigjenerimin e korridoreve natyrore që shoqërojnë to, si dhe mbrojtjen e brezit bregliqenor apo breglumor nga



aktivitetet për shfrytëzimin ekonomik të tyre. Në largësinë deri në 25 m nga vija ujore është i ndaluar çdo aktivitet dhe në zonën buferike prej 100 m mund të ketë aktivitete të kufizuara, sipas përcaktimeve në njësitë strukturore në Rregulloren e Planit.

***Rekomandime për menaxhimin e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore me qëllim mbrojtjen e tyre nga ndotjat:***

- *Reduktimi i konsumimit të ujit nga aktivitetet e industrisë përpunuese*

Është e rëndësishme që njësitë e subjektet ekonomike të grupohen së bashku në zona ekonomike, në të cilat është më e lehtë menaxhimi i infrastrukturës së shpërndarjes së ujit, ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve dhe ndalimin e shpërdorimit të ujit duke aplikuar tarifa dhe çmime të ndryshme nga konsumatorët familjarë, si psh zona ekonomike në afërsi të Finiqit, midis Çlirimit dhe Vrionit dhe pika e grumbullimit të produkteve bujqësore në Dermish. Menaxhimi bëhet më i lehtë nga njësitë vendore dhe dekurajohet shpërdorimi i resurseve të ujit si dhe menaxhohet më mirë zbatimi i rregulloreve për trajtimin e mbetjeve nga ana e bizneseve pranë zonave me trupa ujorë.

- *Krijimi dhe zbatimi i një plani menaxhimi për vaditjen e kulturave bujqësore*

Sigurimi i ujit për vaditje është tejet i rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë, por rrezikon rritjen e konsumimit të ujit dhe shpeshherë edhe shpërdorimin e ujit të pijshëm. Sensibilizimi dhe mbështetja për fermerët në ngritjen e rrjeteve të ujitjes kolektive, pastrimi i kanaleve kulluese e vaditëse si dhe rehabilitimi i tyre është tejet i rëndësishëm, si dhe informimi mbi pesticidet dhe plehrat kimikë që ndosin ujrata nëntokësorë. Duhet mirëmbajtur ujëmbledhësit, rezervuarët dhe kanalet vaditëse, si dhe duhet kontrolluar shpimet e puseve që ndikojnë në rrjetin e ujrave nëntokësore.

- *Përmirësimi i rrjeti të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe ngritja e rrjetit të kanalizimeve në qendrat e banuara*

Mbrojtja e burimeve ujore dhe përmirësimi i rrjetit shpërndarës të ujit të pijshëm do të realizohet duke rritur investimet në mënyrë që të arrihen standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke shmangur kështu humbjet në rrjet nga lidhjet e paligjshme dhe mbishfrytëzimin e burimeve ujore. Duhet ushtruar kontrolle rigorozë në monitorimin e sistemit të shpërndarjes së ujit të pijshëm. Gjithashtu tejet e rëndësishme është përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, ku mungesa e një sistemi funksional dhe impianti për trajtimin e tyre, bën që shpeshherë ujrata e ndotura të patrajtuara të shkarkohen në lumenj apo përrenj dhe të dëmtojnë në këtë mënyrë ekosistemin dhe ndotjen e ujit. Larg qendrave të banuara duhet ndërtuar gropa septike sipas standardeve.

- *Shmangia e shpërdorimit të ujit nga aktivitetet që lidhen me zhvillimin e agroturizmit dhe turizmit të natyrës*

Shtimi i numrit të vizitorëve dhe turistëve do të shtojë kërkesën për konsum të ujit të pijshëm dhe higjenikisht të pastër, për këtë arsye duhen marrë masa për inkurajimin e bizneseve në fushën e agroturizmit dhe turizmit për instalimin e sistemve të kursimit dhe riciklimit të ujit, si dhe sensibilizimin e turistëve për mosshpërdorim të ujit.

### **3.3 Mbrojtja e biodiversitetit dhe shtimin e hapësirave të gjelbra**

Shtimi dhe mbrojtja e pejzazhit natyror dhe hapësirave të gjelbërta është tejet i rëndësishëm, pasi ndikimi i tyre nuk është vetëm në përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve, por edhe në mbrojtjen dhe shtimin e biodiversitetit.

- *Shtimi i lulishteve në fshatrat: Finiq, Mesopotam, Livadhja, Aliko, Dhivër, Leshnicë e Sipërme, Dhrovjan, Vurg i Ri, Vagalat, Dërmish*

Në plani janë propozuar konsolidimet e qendrave të fshatrave dhe krijimi i hapësirave publike të gjelbëruara në: Finiq, Mesopotam, Livadhja, Aliko, Dhivër, Leshnicë e Sipërme, Dhrovjan, Vurg i Ri, Vagalat dhe Dërmish. Qëllimi kryesor i mbjelljes së pemëve me kurora të gjelbëruara është përmirësimi i mikroklimës në zonat e urbanizuara, duke rritur zonat rekreative dhe të gjelbëruara, të cilat ndikojnë në shëndetin mendor dhe fizik të banorëve. Në këtë mënyrë reduktohen zhurmat, përmirësohet cilësia e ajrit dhe shtohen hijet në ditët e nxehta duke zvogëluar edhe efektin e nxehtësisë së çliruar nga sipërfaqet e shtruara të hapësirave publike.

- *Ngritja e parkut riparian përgjatë lumit të Bistricës dhe Dhivrit*

Krijimi i zonës riparianë përgjatë lumi të Bistricës dhe Dhivrit shërben jo vetëm për mbrojtjen nga erozioni dhe kontrollin nga përmytjet, por krijon një korridor të gjelbër për strehimin dhe lëvizjen e specieve të ndryshme në mënyrë të sigurt. Rekomandohet që gjerësia e brezave nga të dy krahët e lumit të shkojë deri në 150 m aty ku është e mundur dhe lejohet nga terreni. Duhet zgjedhur me kujdes llojet e drurëve që do të mbillen, të jenë të konsultuar me specialistë agronomë pasi duhet të ruajnë karakteristikat e pejzazhit dhe të stimulojnë ekosistemin.

### **3.4 Përmirësimi i cilësisë së ajrit**

Ndotja e ajrit pritet të rritet si pasojë e zhvillimit të industrisë së lehtë përpunuese dhe sektorit ekonomik të prodhimit, nga prodhimi i energjisë si djegia e materialeve të ndryshme për ngrohje, nga rritja e numrit të automjeteve si pasojë e rritjes ekonomike dhe fluksit të vizitorëve të zonës, nga ndërtimi i rrugëve të reja dhe veprave të tjera inxhinierike dhe ndërhyrjeve në përmirësimin e infrastrukturave në qendrat e banuara, etj.

***Rekomandime për trajtimin dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit:***

- *Monitorimi i cilësisë së ajrit është thelbësor në koordinimin e marrjes së masave të duhura për rritjen e cilësisë së tij.*

Bashkia duhet të sigurojë dhe të synojë që parametrat e cilësisë së ajrit të mbeten brenda kufijve të përcaktuara si normale nga Direktiva 2008/50/EC për cilësinë e ajrit si dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162, date 04.12.2014 " *Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit*". Bashkia duhet të monitorojë nivelin e ndotësve në mënyrë periodike, dy herë në vit. Në varësi të monitorimeve duhen edhe të marren masat e nevojshme për uljen apo ruajtjen e vlerave brenda standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Table 7: Vlerat kufi të ndotësve (burimi ISHP)

Përiudha e monitorimit			Objektiva nga 2016	
Ndotësit	Metoda	Vlera e përiudhës mesatare	Standarde AL	Standarde e BE
( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )			( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )
Pluhuri total	gravim		140	80
PM 10	Ads		40	40
O3	Ads		120	110
NO2	Ads		50	40

Bashkia duhet gjithashtu të përgatisë një plan apo program për të siguruar përputhshmërinë e vlerave me standardet përpara datës së synuar limit të përcaktuar në tabelat e mësipërme, si dhe duhet të marrë masat për të siguruar transparencën lidhur me informacioni mbi cilësinë e ajrit për grupet e interesit dhe publikun.

- *Përmirësimi i infrastrukturave rrugore dhe promovimi i mjeteve alternative të transportit*

Duke përmirësuar rrjetin rrugor dhe rregulluar lëvizjen e trafikut, ulet koha e qëndrimit të automjeteve në rrugë, të cilët janë një nga ndotësit kryesorë të ajrit në qendrat e urbanizuara. Gjithashtu është e rëndësishme të përmirësohet dhe promovohet përdorimi i transportit publik, duke ulur numërin e automjeteve vetjake në rrugë. Futja e autobusëve "green", elektikë apo hibridë, të cilët nuk emetojnë gazra të dëmshëm, si dhe duke përshtatur oraret dhe shpeshtësinë e autobusëve në varësi të fluskit të udhëtarëve. Duhet të ndërmerren gjithashtu fushata për sensibilizimin e banorëve dhe promovimin e përdorimit të biçikletave si alternativë mobiliteti.

- *Kontrolli i industrisë dhe i materialeve të djegura për ngrohje*

Zhvillimi i industrisë shoqërohet me mundësinë e ndotjes së mjedisit dhe sidomos ajrit duke emetuar gazra në atmosferë, për këtë arsye është e rëndësishme të kontrollohet dhe monitorohet përdorimi i filtrave të ajrit antismog dhe emtimi i gazrave nga subjektet, sipas

kushteve të lejeve mjedisore. Gjatë stinës së dimrit duhen kontrolluar materialet që digjen për ngrohje nga banorët, si dhe sensibilizimi i tyre me fushata informuese rreth llojeve të materialeve që nuk duhen djegur dhe shkaktarët e ndotjes së ajrit që ndikojnë drejt për së drejti në shëndetin e tyre duke rritur numrin e sëmundjeve respiratore.

- *Pyllëzimi dhe mbrojtja nga zjarret*

Ulja e ndotësve në ajër realizohet nëpërmjet pyllëzimit të sipërfaqeve dhe krijimin e hapësirave dhe oazeve të gjelbër në qendrat e banuara. Mbjellja e drurëve dekorativë në zonat e urbanizuara, shtimi i parqeve, lulishteve, ndikon në përmirësimin e cilësië së ajrit. Gjithashtu është e rëndësishme të mbrohen sipërfaqet pyjore nga zjarret e qëllimshme apo të paqëllimshme, kryesisht gjatë stinës së nxehtë të verës, si dhe ripyllëzimin e sipërfaqëve të dëmtuara.

- *Ndërtimi i veprave infrastrukturore dhe ato të ndërtimit*

Respektimi i kushteve të lejeve mjedisore që shoqërojnë ndërtimin e veprave inxhinierike si hapja apo rikonstruksioni i rrugëve, ndërtimin e godinave në funksion të banimit apo ekonomisë, përkatësisht në çdo kantier ndërtimi, është shumë i rëndësishëm, pasi vetëm kështu kontrollohet sasia e grimcave të pluhurit apo gazrave të ndryshëm që ndosin ajrin. Zbatimi i kriterëve ligjore për ndërtimin e veprave dhe transportimin e inerteve sipas lejeve mjedisore është i domosdoshëm.

### **3.5 Masa për trajtimin e zonave problematike mjedisore**

Në territorin e bashkisë nuk ekzistojnë hotspotet por mund të themi që problematike është menaxhimi i mbetjeve dhe rehabilitimi i venddepozitimeve të paligjshme të ndodhura kryesisht në afërsi të vendbanimeve rurale.

#### ***Rekomandime për trajtimin e zonave të rrezikuara mjedisore:***

- *Rigjenerimi i venddepozitimeve të paligjshme të mbetjeve urbane*

Rehabilitimi i zonave që kanë shërbyer më parë apo shërbejnë edhe sot në mënyrë të paligjshme si venddepozitime për mbetjet e ngurta, është i domosdoshëm. Evidentimi i këtyre zonave dhe rehabilitimi duke i kthyer në zona të gjelbëruara do të kenë një ndikim pozitiv në mbrojtjen e mjedisit. Me anë të teknologjive si biorehabilitimi realizohet pastrimi i shtresave të dheut, në vend apo duke u gërryer dhe transportuar, kur kontaminimi rrezikon shëndetin e banorëve dhe biodegradimi nuk është i mundur.

- *Promovimi i industrisë së riciklimit*

Bashkia duhet të promovojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, e cila është mënyra më efektive për furnizimin e industrisë së riciklimit dhe mbrojtjen e mjedisit. Duhet

realizuar fushata sensibilizuese në shkollat e arsimit 9-vjeçar si dhe të banorëve nëpërmjet mediave, broshurave apo organizimit të ditëve tematike informuese.

### **3.6 Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve, kullotat**

Investimet konkrete të parashikuara për tu realizur gjatë kësaj periudhe përfshijnë: organizimin e panairove agroturistike me qëllim promovimin e turizmit si dhe nxitjen dhe prodhimin e kuturave bujqësore, investim ky që kap vlerën e 100 000 000 lekë, po në kuadër të turizmit një investim tjetër shumë i rëndësishëm i planifikuar nga bashkia është hartëzimi dhe pajisja me sinjalistikë e itinerareve turistike, një investim ky me vlerë rreth 30 000 000 lekë. Investimet e bashkisë në sektorë si bujqësia dhe turizmi do të nxisnin banorët e zones të investonin në këto dy sektor, duke rritur kështu numrin e të punësuarve, numërin e bizneseve në zone të cilat automatikisht do të kontribuonin në rritje të të ardhurave vendore. Sërish rëndësinë kryesore në investimet e bashkisë e marrin investimet në infrastrukturë rrugore të cilat gjatë kësaj periudhe kapin vlerën prej 268 000 000 lekësh.



## Investime të periudhes 4-10 vjeçare



### 4.4 Treguesit e monitorimit të zbatimit të planit

Treguesit për monitorimin e zbatimit të planit janë si më poshtë:

1_INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE	
Infrastruktura e transportit	
1.1	Gjatësi në km e rrugëve të reja
1.2	Gjatësi në km e rrugëve ekzistuese të rikonstruara
1.3	numri i makinave dhe udhëtarëve
1.4	Numri i linjave dhe i mjeteve të transportit publik
1.5	Numri i vend stacioneve të transportit publik
1.6	Numri i pasagjerëve / bileta, abone
1.7	Gjatësi në km e rrugëve për biçikleta
Infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve	
1.8	Gjatësi në km e rrjetit të ujësjellësit
1.9	Gjatësi në km e rrjetit të kanalizimeve
1.10	Numri i fshatrave/banorëve që shërbehen nga infrastruktura e ujësjellësit
1.11	Numri i fshatrave/banorëve që shërbehen nga infrastruktura e kanalizimeve
1.12	Numri i gropave septike të rehabilituara
1.13	Sipërfaqe e reduktimit të humbjeve në rrjet
1.14	Volumi i trajtuar nga impianti i trajtimit të ujërave të zeza
Infrastruktura e grumbullimit të mbetjeve	
1.15	Numri i koshave në të gjithë bashkinë

1.16	Volumi ciklik i mbetjeve i grumbulluar dhe transportuar
1.17	Volumi ciklik i mbetjeve i ricikluar
1.18	Numri i eventeve sensibilizuese për ndërgjegjësimin e komunitetit për riciklimin
<b>Infrastruktura energjitike dhe e telekomunikacionit</b>	
1.19	Gjatësi e rrjetit elektrik i rehabilituar
1.20	Numri i banorëve të shërbyer me energji elektrike 24/7
1.21	Mbulimi 100% i territorit me rrjet cilësor telekomunikacioni
1.22	Numri i banorëve të lidhur me internet/kontratat e operatorëve
1.23	Numri i fshatrave të pajisur me ndriçim publik të rrugëve kryesore
<b>Shërbimet arsimore dhe shëndetësore</b>	
1.24	Numri i ambulancave dhe qendrave shëndetësore të reja
1.25	Numri i ambulancave dhe qendrave shëndetësore të rikonstruara
1.26	Numri i qendrave arsimore të reja
1.27	Numri i qendrave arsimore të rikonstruara
<b>2_HAPËSIRAT PUBLIKE DHE KOMUNITETI</b>	
<b>Hapësirat publike</b>	
2.1	Sipërfaqja e rigjeneruar e hapësirave publike në qendrat e zonave urbane
2.2	Numri shërbimeve publike
2.3	Numri i personave që përfitojnë nga shërbimet publike
2.4	Sipërfaqet e gjelbëruara
2.5	Numri i godinave të restauruara
<b>3_EKONOMIA</b>	
<b>Bujqësia dhe Infrastrukturat bujqësore</b>	
3.1	Numri i subjekteve të reja në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë
3.2	Numri i banorëve të punësuar në bujqësi/blegtori
3.3	Sasia e produkteve lokale të çertifikuara
3.4	Sasia e produkteve lokale e prodhuar për tregtim
3.5	Gjatësia në km e rrjetit të ri vaditës
3.6	Numri i subjekteve të hapura për zhvillimin e agroturizmit
<b>Turizmi</b>	
3.7	Numri i subjekteve të reja në sektorin e turizmit
3.8	Numri i banorëve të punësuar në turizëm
3.9	Përqindja e shtimit/rënies së numrit të turistëve
3.10	Përqindja e shtimit/rënies së kapaciteteve akomoduese
3.11	Qëndrimi mesatar i turistëve brenda territorit të bashkisë
3.12	Përqindja e kohëzgjatjes së marketimit të potencialeve në media online
3.13	Përqindja e marketimit të potencialeve nëpërmjet materialeve hardcopy/broshura etj
3.14	Numri i eventeve kulturore të organizuara
	Gjatësia në km i shtigjeve të rehabilituara dhe pajisura me sinjalistikë
<b>4_NATYRA</b>	
<b>Mbrojtja e natyrës</b>	
4.1	Numri i programeve të zbatuara për mbrojtjen e mjedisit
4.2	Numri i pemëve të mbjella
4.3	Sipërfaqja e rehabilituar e trupave ujore

#### **4.5 Ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ vendor**

Hartimi i PPV të bashkisë Finiq ka reflektuar parashikimet ligjore të Ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar. Decentralizimi fton Bashkitë të kenë një rol me aktiv në menaxhimin e territorit të tyre, për këtë arsye Plani parashikon ndryshime të nevojshme në strukturën administrative vendore të planifikimit, që janë të specifikuara në kapitullin e Kapaciteteve institucionale, ku është analizuar nevoja e bashkisë për shtim të kapaciteteve njerëzore si edhe hapësirave fizike për të përballuar punën aktuale të bashkisë si edhe detyrat e reja të cilat shtohen si shkak i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Gjithashtu në nivel vendor është e nevojshme që të krijohen struktura të reja për monitorim mjedisor ose të përmirësohen ato ekzistuese, duke shtuar në organikën lokale numrin e inxhinierëve, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore. Në territorin e bashkisë Finiq gjendet zona e mbrojtur e Monumentit të Natyrës së Syrit të Kaltër, i shpallur me VKM nr.102, datë 15.01.1996 dhe zona e mbrojtur e Parkut Kombëtar të Butrintit e shpallur me VKM nr.134, datë 20.02.2013. Është e nevojshme të rishikohet roli i bashkisë në menaxhimin e këtij territory, kryesisht në detyrat e monitorimit të gjendjes së mjedisit apo të plotësimit me shërbime me 0 ndikim në mjedis si psh me sinjalistikë të domosdoshme.

Në përgjithësi, propozimet e Planit të Përgjithshëm Vendor nuk kërkojnë ndryshime ligjore. Në periudhëm afatshkurtër të zbatimit të planit, 3 vite pas miratimit të tij, Bashkia Delvinë do monitorojë vështirësitë që mund të hasen gjatë zbatimit të Planit dhe të hartojë një Raport. Kjo periudhë do ndihmojë bashkinë të pëepilojë ndryshime të nevojshme, nëse do të ketë, si dhe propozime sipas rastit për përmirësimin e bazës ligjore.

#### **4.6 Faktorët që mund të shkaktojnë rishikim të PPV-së apo pjesëve të saj**

PPV-ja është një dokument i cili hartohet nga Bashkia mbi bazën e kërkesave dhe zhvillimeve kombëtare nën drejtimin e AKPT-së bazuar në Ligjin 107/2014, dhe është dokumenti bazë udhëzues për zhvillimin në 15 vjetët e ardhshëm të territorit. Faktorët të cilët shkaktojnë rishikimin e PPV-së, sipas pikës 2, të Nenit 26 të Ligjit 107/2014 konform procedurës që përcaktohet në të. Faktorët janë:

- Rastet kur kemi ndryshime të caktuara territoriale si ndarje administrative që çojnë në ndryshime dhe ndarje të reja territoriale.
- Në rastin kur kemi ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike.
- Ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore
- Në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Procedura e thjeshtuar, zbatohet kur:

- PPV-ja e bashkisë Finiq do të rishikohet për çështje që nuk prekin qëllimet e përmbajtjen e saj dhe nuk çënojnë vlerat natyrore, cilësinë e mjedisit, zonat e mbrojtura, tokat bujqësore, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore;
- Rishikimi i rregulloreve të planifikimit nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale dhe të parashikimeve të planit përkatës;
- Rishikimi i dokumenteve sipas pikës 1, më lart, shoqërohet me kritere apo kushte më të hollësishme sesa dokumenti në fuqi;
- Parashikohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial.

Përdorimi i procedurës së thjeshtuar ka për efekt përjashtimin e miratimit të nismës si dhe përgjysmimin e afateve të përcaktuara për bashkërendimin e këshillimin dhe takimin publik sipas Ligjit të planifikimit dhe akteve nënligjore përkatëse.

#### **4.7 Përcaktimet kryesore për termat e referencës për Planet e Detajuara Vendore dhe Planet Sektoriale**

Bashkia Finiq ka përcaktuar përmes kësaj PPV-je njësitë strukturore të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të planeve të detajuara vendore, mbi bazën e kritereve ligjore dhe atyre të parashtruara në këtë dokument. Këto PDV do të hartohen me nismën publike ose private në zona të cilat janë:

- Një njësi strukturore
- Disa njësi strukturore bashkë
- Çdo zonë me prioritet për zhvillim

Qëllimi kryesor i planeve të detajuara vendore do të jetë zhvillimi dhe/ose rizhvillimi i një zone, rigjenerimi /ripërtëritja e një zone kryesisht urbane, ndërtimi i infrastrukturave publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e kushteve të zhvillimit. Planet e detajuara vendore kanë për objekt nëndarjen dhe/ose bashkimin për qëllim zhvillimi. Nisma për hartimin e tyre duhet të mbështetet nga pronarët që kanë në pronësi jo më pak se 51 për qind të sipërfaqes së zonës, për të cilën propozohet plani i detajuar vendor.

Procesi i hartimit të PDV-së koordinohet nga kryetari i Bashkisë, i cili është edhe autoriteti përgjegjës për hartimin e planit. Plani i detajuar vendor (PDV) me nismë publike hartohet nga grupi i punës mbi bazën e planit të miratuar të veprimeve. Grupi i punës është i përbërë nga specialistë të Bashkisë, institucioneve publike në varësi dhe ekspertë të fushave të ndryshme, vendas apo edhe të huaj.

Plani i detajuar vendor me nismë private regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën. Parcelat e reja që krijohen nga nëndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese janë objekt transaksioni vetëm pasi të jetë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në pronësi të autoritetit publik përkatës. Struktura,

forma, pjesët përbërëse të përmbajtjes, procesi për nismën, informimin dhe takimet publike të detyrueshme, hartimin dhe miratimin e planit të detajuar vendor, kriteret për përcaktimin e kufijve të zonës që trajtohet me plan të detajuar vendor dhe kushte të tjera, përcaktohen në rregulloren e zhvillimit.

Procesi i hartimit të PDV-së shoqërohet nga përgatitja e studimit paraprak të fizibilitetit, ku llogariten përqindjet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kostot dhe kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

Projekti që do të hartohen për Planet e Detajuara Vendore, është e nevojshme të përmbajë:

- Studimin e fizibilitetit (format A4)
  1. Të sqarohet gjendja aktuale e territorit;
  2. Faktorët aktualë të cilët ndikojnë në zhvillimin e njësisë duke e nxitur apo penguar zhvillimin e saj;
  3. Përmbledhje e materialeve nga vizita në terren dhe studimet e bëra më parë nëse ka;
  4. Në rast se PDV-ja hartohet nga subjekt privat, çdo material që disponohet lidhur me projektin duhet të vendosen në dispozicion të hartuesit.
  
- Projekt Ideja (format A3, A2 ose çdo format i përshtatshëm në varësi të shkallës së vizatimit)
  1. Ndarja dhe kategorizimi i sipërfaqes;
  2. Rilevimi i zonës;
  3. Vizatimet përkatëse në një shkallë të lexueshme
  4. Përshkrim i detajuar i arsyeve dhe shkaqeve që përcaktojnë vëndodhjen dhe ndërhyrjen e propozuar
  5. Studim i detajuar i kthimit të kostos së investimit, përcaktimi i tarifave të shërbimit
  6. Evidentimi i numrit të qytetarëve që përfitojnë nga investimi;
  7. Pritshmeritë dhe përfitimet nga projekti.
  
- Projekt Zbatimi (format A2, A1 ose çdo format i përshtatshëm në varësi të shkallës së vizatimit) Pas aprovimit të projekt-idesë nga Autoriteti Kontraktues dhe Përfituesi, vijohet me hartimin e projekt-zbatimit duke përfshirë të paktën:
  1. Planimetri e përgjithshme;
  2. Projektet elektrike dhe mekanike;
  3. Planimetri dhe prerje të detajuara;
  4. Relacionin teknik me llogaritjet teknike dhe konstruktive për sa cituar më sipër;
  5. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

6. Preventivin e plotë vlerësues të veprës bazuar në manualin e preventivimit të aprovuar nga Këshilli i Ministrave.
7. Grafikon e punimeve, të detajuar sipas zërave të punës, si dhe kohëzgjatja e punimeve.

Përmbajtja e dokumentit të PDV dhe përcaktimet e shpjegimet për secilin dokument shoqërues të projektit përcaktohen më të detajuara në VKM 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar.

Projekti i Detajuar Vendor duhet të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e Bashkisë; duke përdorur fillimisht të gjithë të dhënat paraprake që disponohen nga bashkia si edhe të konsultohet gjatë gjithë procesit me dokumentin e PPV-së. Gjithashtu duhet të merren në konsideratë të gjithë kufizimet legjislative kombëtare dhe vendore.

Grupi i punës për hartimin e PDV-së, me nismë publike, ngrihet me vendim të kryetarit të njësisë vendore dhe duhet të përmbajë të paktën:

- 2 arkitekt/planifikues
- 1 ekspert ligjor
- 1 ekspert mjedisi
- 1 ekspert vlerësim pasurish të palujatshme

Edhe në rastet kur PDV-ja hartohet me nismë private, procesi i përzgjedhjes së ekspertëve, pjesë e grupit të punës, duhet të bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe transparent, me qëllim përzgjedhjen e konsulencës më të mirë. Në këtë rast grupi i punës duhet të përbëhet nga:

- 2 arkitektë/planifikues
- 1 ekspert ligjor
- 1 ekspert mjedisi
- 1 ekspert vlerësimi pasurish të paluajtshme

### **Përcaktimet kryesore për termat e referencës për planet sektoriale**

Dokumentat më të rëndësishëm ku duhet bazuar hartimi i Planit Vendor Sektorial janë: Plani Vendor dhe Plani Kombëtar Sektorial. Pikëprerja e këtyre dy instrumentave përbën pikën e nisjes së haritimit të planit vendor sektorial. Një element tjetër që duhet marrë në konsideratë është hartimi i buxhetit afatmesëm dhe afatgjatë i Bashkisë në zbatim të këtij plani. Plani Vendor sektorial, teksa hartohet e zbatohet, duhet të ndjekë parimet e planifikimit si një proces pune përherë në vazhdimësi. Autoriteti përgjegjës, përmbajtja e dokumentit të PVS-së, përmbajtja e dokumentit të PVS-së, nisma për hartimin e PVS-së; hartimi i PVS-së,

bashkërendimi i PVS-së, këshillimi dhe takimi publik në kuadër të PVS-së, botimi në regjistër i PVS-së, miratimi, hyrja në fuqi e PVS-së kryhen duke ndjekur si bazë procedurat e përcaktuara për PPV dhe PKS.

Me qëllim dhënien e zgjidhjeve afatgjata për të përmirësuar dhe efiçentuar flukset e transportit privat dhe publik në bashkinë e Finiqit, me qëllimin kryesor krijimin e kushteve dhe të atraksione për turistët, është e nevojshme të hartohet **Plani sektorial i transportit, fokusuar në transportin rrugor.**

Ky plan duhet të synojë:

- Zgjidhjen e skemës së transportit në çdo stacion.
- Mundësimin e krijimit të disa shtigjesh biçikletash përgjatë Zonave të Mbrojtura nëpërmjet pedonaleve.
- Promovimin e lëvizjes së gjelbër dhe uljen e emetimeve të karbonit në ajër.
- Lidhje më efiçentë të zonave periferike dhe malore të Bashkisë me shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale përmes transportit publik.

Projekti që do të hartohen për Planet Sektoriale, është e nevojshme të përmbajë:

- Studimin e fizibilitetit (format A4)
  1. Të sqarohet gjendja aktuale e rrjetit infrastrukturor;
  2. Faktorët aktualë të cilët ndikojnë në zhvillimin e njësisë duke e nxitur apo penguar zhvillimin e saj, trafiku, pikat problematike, karakteristika teknike të rrugëve;
  3. Kapaciteti aktual i rrugëve;
  4. Përmbledhje e materialeve nga vizita në terren dhe studimet e bëra më parë nëse ka;
  5. Në rast se Plani hartohet nga subjekt privat, çdo material që disponohet lidhur me projektin duhet të vendosen në dispozicion të hartuesit.
- Projekt Ideja (format A3, A2 ose çdo format i përshtatshëm në varësi të shkallës së vizatimit)
  1. Ndarja dhe kategorizimi i sipërfaqes;
  2. Rilevimi i zonës;
  3. Vizatimet përkatëse në një shkallë të lexueshme
  4. Përshkrim i detajuar i arsyeve dhe shkaqeve që përcaktojnë vëndodhjen dhe ndërhyrjen e propozuar
  5. Studim i detajuar i kthimit të kostos së investimit, percaktimi i tarifave të shërbimit
  6. Evidentimi i numrit të qytetarëve që përfitojnë nga investimi;
  7. Pritshmeritë dhe përfitimet nga projekti.

- Projekt Zbatimi (format A2, A1 ose çdo format i përshtatshëm në varësi të shkallës së vizatimit) Pas aprovimit të projekt-idesë nga Autoriteti Kontraktues dhe Përfituesi, vijohet me hartimin e projekt-zbatimit duke përfshirë të paktën:
  1. Planimetri e përgjithshme;
  2. Projekti për rrugët;
  3. Mbrojtja mbjedisore gjatë ndërtimit;
  4. Profile gjatësore dhe tërthore të rrugëve;
  5. Ndriçimi dhe vendosja e sinjalistikës;
  6. Relacionin teknik me llogaritjet teknike dhe konstruktive për sa cituar më sipër;
  7. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
  8. Preventivin e plotë vlerësues të veprës bazuar në manualin e preventivimit të aprovuar nga Këshilli i Ministrave.
  9. Grafikon e punimeve, të detajuar sipas zërave të punës, si dhe kohëzgjatja e punimeve.

Përmbajtja e dokumentit të Planit Sektorial dhe përcaktimet e shpjegimet për secilin dokument shoqëruar të projektit përcaktohen më të detajuara në VKM 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar.

Plani duhet të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e Bashkisë; duke përdorur fillimisht të gjithë të dhënat paraprake që disponohen nga bashkia si edhe të konsultohet gjatë gjithë procesit me dokumentin e PPV-së. Gjithashtu duhet të merren në konsideratë të gjithë kufizimet legislative kombëtare dhe vendore. Projektuesi të bazohet në normat dhe standardet e Kodit Rrugor të Shqipërisë dhe Manuali I Projektimit të Rrugëve.

Bashkia nuk ka kapacitetet e nevojshme për hartimin e këtij Plani Sektorial prandaj është e nevojshme që të përzgjidhen ekspertët në disiplinat që gjykohen të nevojshme në mënyrë që të mbulohet i gjithë qëllimi i punës i përshkruar në këtë detyrë projektimit (terma reference) dhe të përgatiten kërkesat e paraqitura. Nisur nga kompleksiteti i punës për t’u realizuar, grupi i ekspertëve duhet të përfshijë minimalisht:

- Inxhinier Hidroteknik
- Inxhinier Gjeolog
- Inxhinier Topograf
- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Transporti
- Inxhinier Konstruktore
- Inxhinier Elektrik
- Inxhinier Mekanik
- Inxhinier Mjedisi
- Preventivues.
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme



## 5 Kapacitetet institucionale

### 5.1 Vlerësimi i nevojave për personel të kualifikuar dhe logjistikë

Reforma Administrative Territoriale e vitit 2015, solli krijimin e 61 bashkive me territore disa here më të mëdha për tu menaxhuar dhe më komplekse. Bashkisë Finiq ju shtuan nën administrim njësitë administrative: Finiq, Aliko, Mesopotam, Livadhja dhe Dshivër. Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë Finiq synon të integrojë të gjitha njësitë administrative përbërëse duke orientuar zhvillimin e bashkisë drejt ruajtjes së aseteve natyrore e kulturore dhe promovimit të turizmit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

Në kuadër të reformës së decentralizimit, përgjegjësitë e qeverive vendore janë bërë gjithnjë e më të komplekse dhe të shumëllojshme. Me gjithë përpjektet e bëra nga bashkia për riorganizimin e stafit për tu përballur me sfidat e reja, sigurimi me efikasitet dhe përgjegjshmëri i shërbimeve cilësore publike në nivel vendor po përballlet ende me sfida të konsiderueshme në aspektin e kapaciteteve të burimeve institucionale dhe njërezore.

Kapaciteti i kufizuar për të hartuar dhe zbatuar strategji të integruara të zhvillimit vendor dhe planeve të zhvillimit territorial, për hartimin e programit buxhetor afatmesëm vendor, aftësia për të trajtuar kompleksitetin rregullator dhe qëndrueshmërinë e strukturave të trajnimit kanë qenë e vazhdojnë të jenë disa nga sfidat kryesore për funksionimin e administratës së qeverisjes vendore.

Table 8: Nr i punonjësve në Bashkinë Finiq (Burimi: Bashkia Finiq)

	EMËRTIMI	PUNONJËS
	<b>PERSONELI I ADMINISTRATËS SË BASHKISË FINIQ</b>	
1	Administrata e Bashkisë Finiq	56
2	Njësia Administrative Aliko	4
3	Njësia Administrative Livadhja	5
4	Njësia Administrative Mesopotam	6
5	Njësia Administrative Dshivër	5
6	Drejtoria e Shërbimeve Publike	61
7	Spektori i Emergjencave Civile	6
8	Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit	3
9	Policia Bashkiake	8
	<b>FUNKSIONE TË TRANSFERUARA</b>	

1	Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave & Bordi i Kullimit	20
2	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	14
3	Arsimi Parashkollor	12
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>200</b>

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Finiq është i domosdoshëm angazhimi i një sërë sektorësh/departamentesh në vënien me sukses në praktikë të tij, duke qënë se planifikimi është një proces i vazhdueshëm. Në këtë kontekst, përfshirja e drejtpërdrejtë dhe marrja e përgjegjësive institucionale gjykohet tepër thelbësore veçanërisht për sektorët që përballen me zinxhirin e zbatueshmërisë së PPV-së.

Table 9: Organigrama e Bashkisë Finiq (Burimi: Bashkia Finiq)

<b>EMERTIMI</b>	<b>Nr. Punonjësve</b>
<b>Kryetari</b>	1
<b>Sekretar i Përgjithshëm</b>	1
<b>Zv. Kryetari</b>	3
<b>Sekretar i Keshillit Bashkiak</b>	1
<b>Kabineti i Kryetarit</b>	2
1.Drejtor kabineti dhe Koordinator për të drejten e informimit	1
2.Këshilltar	1
<b>Drejtoria e Finances</b>	<b>11</b>
Drejtor	1
<b>Zyra e Finances</b>	<b>3</b>
Përgjegjës Finance	1
Magazinjer	1
Arketare-Llogaritare	1
<b>Njesia e Prokurimeve Publike</b>	<b>2</b>
Përgjegjës	1
Specialist i Prokurimeve	1
<b>Sektori i Shërbimit Social dhe Barazisë Gjinore</b>	<b>5</b>
Përgjegjës	1
Specialist i Shërbimit Social	1
Specialist i Barazisë Gjinore	1
Qendra e Solidaritetit dhe Vullnetarizmit	2
Punonjës	2
<b>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit</b>	<b>3</b>
1.Drejtor	1

2.Specialist Hartograf	1
3.Specialist Topograf	1
<b>Drejtoria e Tarifave dhe Taksave</b>	<b>10</b>
Drejtor	1
<b>Sektori i Planifikimit te te ardhurave dhe rakordimit te taksave</b>	
Pergjegjesi i te Ardhurave	1
Specialist i vleresimit, planifikimit te te ardhurave dhe rakordimit e taksave	3
<b>Sektori i Inspektimit ne Terren</b>	
Pergjegjesi inspektimit	1
Inspektor i vjeljes se taksave dhe tarifave	4
<b>Drejtoria e Burimeve Njerezore</b>	<b>8</b>
Drejtor	1
Specialist IT	1
Specialist protokolli Bashkia Finiq	
Specialist arkivi Bashkia Finiq	1
Pastrues (sanitar)	1
Roje Objekti	4
<b>Drejtoria e Programim - Zhvillimit, Aplikimit te Projekteve, Turizmit, Mjedisit dhe Arsimit</b>	<b>9</b>
Drejtor	1
<b>Sektori per aplikimin e Projekteve, Turizmit dhe Mjedisit</b>	<b>4</b>
Pergjegjes aplikim projekti	1
Specialist mjedisi	1
Specialist per turizmin	2
<b>Sektori i Arsimit, Kultures, Rinise dhe Sporteve</b>	<b>4</b>
Specialist i Sporteve	1
Specialist Arsimi	1
Punonjese e ruajtjes dhe promovimit te tradites	2
<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b>	<b>61</b>
Drejtor	1
<b>Sektori i Transportit</b>	
Pergjegjes i transportit	1
Specialist	1
Mirembajtjes i mjeteve motorike te Bashkise	1
Mekanik	2
Shofer Administrate	6
Shofer-Manovrator	6
<b>Sektori i Ndrçimit Rrugor dhe Dekorit</b>	<b>6</b>
Pergjegjes	1

Punonjës elektrikist	5
<b>Spektori i pastrimit te Territorit dhe mirembajtjes se objekteve te Bashkise</b>	<b>19</b>
Përgjegjes	1
Mirembajtjes objekteve te Bashkise	1
Punonjës gjelbërimi	7
Punonjës pastrimi	10
<b>Spektori i mirëmbajtjes së rrugëve rurale dhe urbane</b>	<b>18</b>
Përgjegjës	1
Përgjegjes te grupit te puntoreve	2
Puntor mirëmbajtje	16
<b>Drejtoria e AMT, Veterinarise, Mbrojtjes se Konsumatorit</b>	<b>7</b>
<b>Drejtor</b>	<b>1</b>
Përgjegjes sektori i AMT	1
Specialist i menaxhimit të tokës	2
Specialist veterinar	1
Specialist i mbrojtjes se konsumatorit	2
<b>Drejtoria Ujitje Kullimit dhe Mbrojtjes se Brigjeve</b>	<b>8</b>
<b>Drejtor</b>	<b>1</b>
Përgjegjes sektori i Ujitje Kullimit	1
Punonjes mirembajtje	5
Manovrator	1
<b>Spektori emergjencave civile</b>	<b>6</b>
Përgjegjes	1
Specialist i Emergjencave Civile	2
Punonjës i emergjencave civile	3
<b>Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit (IMT)</b>	<b>3</b>
K/Inspekt. ndertimor urban	1
Inspektor Ndertimor Urbanistik	2
<b>Policia Bashkiake</b>	<b>8</b>
K/Inspektor	1
Polic	7
<b>Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave</b>	<b>12</b>
<b>Drejtor</b>	<b>1</b>
Specialist i Monitorimit te Pyjeve e Kullotave	1
Specialist i Menaxhimit te Pyjeve Kullotave	2
Roje mjedisor	8
Arsimi Parashkollor	12
MZSH	14
Njësia Administrative Aliko	4

Njësia Administrative Livadhja	5
Njësia Administrative Mesopotam	6
Njësia Administrative Dhiver	5
<b>Totali</b>	<b>200</b>

### **Kapacitetet logjistike dhe hapësirat**

Përsa i përket gjendjes fizike dhe pajimit, në këtë institucion mbetet shumë për t'u përmirësuar. Ndërtesa ku është vendosur stafi i bashkisë është godina e ish kooperativës bujqësore të Finiqit, e ndërtuar në vitin 1970, e cila është në kushte teje të amortizuara. Në vitin 2008 është rikonstruktuar kati i dytë i ndërtesës me rifinitura dhe shtresa veshjeje, ndërsa kati përdhe dhe kati i parë nuk kanë pasur ndërhyrje që në përfundimin e ndërtimit të saj. Kati përdhe i godinës ndahet midis bashkisë dhe postës, pasi një pjesë të këtyre ambienteve kanë kaluar në pronësi të postës, e treguar në planimetrinë e ndërtesës së katit përdhe. Në këtë kat aktualisht ndodhen zyrat e gjendjes civile, policia bashkiake, drejtoria e pyjeve dhe kullotave dhe një ambient për shërbime. Në katin e parë ndodhen zyrat e arkivës, financës, tatimet, arkëtimet, zyra e urbanistikës dhe zyra e zv. Kryetarit të bashkisë. Vihet re një mungesë në hapësira magazinimi dhe arkivimi për materialet që disponon administrata. Ndërsa në katin e dytë, atë të rikonstruktuar ndodhen zyrat e financës, njësia e prokurimeve publike, zyra e personelit, zyra e sekretarit të përgjithshëm dhe zyra e kryetarit së bashku me hapësirën për sekretaren dhe ambientin e pritjeve. Në bashki mungon një hapësirë për organizimin e mbledhjeve dhe hapësira për pjesën tjetër të administratës.




Fig. 12: Planimetria e katit përdhe (Burimi: Bashkia Finiq)




Fig. 13: Planimetria e katit të parë (Burimi: Bashkia Finiq)




Fig. 14: Planimetira e katit të dytë (Burimi: Bashkia Finiq)

Për shkak të mungesës së hapësirave të përshtatshme për punonjësit e administratës vendore, një pjesë e stafit është vendosur nëpër zyrat e ish komunave, në njësitë e tjera administrative të bashkisë. Në pjesën e teknologjisë dhe pajisjeve në dispozicion të stafeve teknike, zyrat janë të pajisura me kompjutera për çdo punonjës dhe 10 printera janë shpërndrë nëpër zyra.

Ndërkohë, përsa i përket njërive administrative nevojiten disa ndërhyrje në zgjerimin e mjediseve, në rregullimin dhe rikonceptimin e tyre për t'i bërë efikase e për t'u përshtatur me kërkesat e reja.

Më tej, lidhur me logjistikën që pritet të mbështesë bashkinë e Finiqit në zbatimin e PPV-së dhe kontrollin e zhvillimit të mëtejshëm të territorit, vlen të theksohet se do të nevojitet një përmirësim i kushteve të punës dhe përforsim i kapacitetit logjistik të bashkisë me mjete transporti, të nevojshme për t'i bërë të gjitha territoret e reja, të përfshirë rishtaz nën këtë bashki, të arritshme dhe menaxhueshme në kushte optimale.

Mangësitë kryesore të vëna re në drejtori kanë të bëjnë më vështirësi të hasura në përdorimin e RKPT-së, shqyrtimin e lejeve të zhvillimit nëpërmjet sistemit të e-lejeve online, mungesë të informacionit të dixhitalizuar të aseteve të bashkisë, etj.

Bazuar mbi mangësitë e mësipërme, gjykohet se, një sërë masash do të mund të kontribuojnë në rritjen e performancës së Bashkisë Finiq, sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit, masat më të rëndësishmet janë:

- gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor është krijuar një bazë e mirë informacioni, të cilën, Bashkia duhet ta mirëmbajë, ta përdorë dhe ta plotësojë në mënyrë të vazhdueshme;

- të vazhdojë të plotësojë databazën e informacionit dhe inventarizimit të pyjeve, kullotave, tokave bujqësore dhe elementeve të tjerë të klasifikueshëm që përfshihen në territorin e bashkisë;
- të plotësohet baza materiale e vetë bashkisë, si dhe e njësisve administrative me pajisje e domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit të punës si: PC, printer, ploter, skaner, programe të nevojshëm si Autocad, GIS, etj;
- organizimi i trajnimeve të vazhduara dhe plotësuese të stafit të bashkisë në fushat më prioritare.

## 5.2 Rishikimi i nevojave të bashkisë për ristrukturim

Në analizën mbi gjendjen e kapaciteteve institucionale të bashkisë Finiq dallohet mungesa e kapaciteteve të specializuara në disa raste, mungesa e përvojës institucionale në trajtimin e çështjeve të agroturizmit, mjedisit dhe menaxhimit të tokës, si dhe mungesa e kapaciteteve të specializuara në hartimin e planeve sektoriale të menaxhimit të zonave të mbrojtura e mbetjeve urbane, si dhe të planeve të detajuara vendore.

Ristrukturimet që propozohen lidhen me:

- Shtimin dhe ristrukturimin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pasi mungon hierarkia e shpërndarjes së detyrave dhe delegimit të funksioneve si dhënia e lejeve të ndërtimit, monitorimi i tyre, hartimi i PDV-ve, hartimi i detyrave të projektimit për projekte që kanë impakt në zhvillimin e territorit, prokurimi i projekteve të rëndësishme në palët e treta.
- Ristrukturimin e sektorëve të tjerë zinxhir që lidhen me zhvillimin e territorit si sektorët që mbulohen nga Drejtoria e Programim-Zhvillimit, Aplikimeve të Projekteve, Turizmit, Mjedisit dhe Arsimit, si dhe rakordim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.
- Gjithashtu sugjerohet forcimi i sektorëve bazë që ndjekin zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, turizmit dhe hartimin e projekteve.
- Në përgjithësi nevojitet rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, duke aftësuar stafin aktual për detyrat dhe kompetencat e tyre, si dhe shtimin e disa sektorëve me specialist të tjerë të kualifikuar.

Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor kërkon burime njerëzore, të cilat Bashkia Finiq nuk i ka të plotësuara. Domosdoshmëria e ofrimit të shërbimeve dhe aplikimeve online nga Bashkia, si dhe funksionimi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me ekspertë GIS dhe me shërbime të lidhura me Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, nxjerrin në pah nevojën për një sërë ekspertësh të të gjitha fushave që lidhen me nevojat e ardhshme të bashkisë për të rekrutuar punonjës të rinj në strukturën e saj si: arkitektë, konstruktorë, urbanistë, ekspert GIS



(për të integruar në sistem gjeoreferencimi dhenien e lejeve), inxhinierë ndërtimi, inxhinierë hidroteknikë, inxhinierë elektrikë, inxhinierë mjedisi, inxhinierë transporti, agronomë dhe topografë.

### **5.2.1 Ristrukturimi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit**

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit kontrollon drejtpërdrejt zbatimin e PPV-së për bashkinë Finiq dhe shërben si koordinues edhe për sektorët e tjerë. Drejtorja është përgjegjëse për hartimin/ detajimin e PDV-ve sipas rastit dhe monitorimin e zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, përgatit raportin përfundimtar të monitorimit në lidhje me ecurinë e investimeve, koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e zbatimit të investimeve në fushën mjedisore, si dhe mirëmban dhe përmirëson të dhënat gjeohapësinore dhe statistikore.

Aktualisht Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit përbëhet nga 3 punonjës, nga të cilët: 1 hartograf, 1 topograf dhe 1 inxhinier ndërtimi. Ka mungesa në disa kategori specialistësh dhe kjo mund të reflektohet në probleme gjatë zbatimit të planit dhe projekteve të tij, veçanërisht në njësi ku ka zona të ndjeshme me vlera historike e natyrore dhe nën presion zhvillimi. Për këtë arsye rekomandohet ndarja e kësaj drejtori në sektorë sipas profilit:

**Spektori i Planifikimit dhe Projektimit** – ky sektor do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, do të hartojë e monitorojë PDV-të si dhe do të përgatisë detyrat e projektimit për studimet apo projektet që bashkia do të prokurojë në palë të treta. Përgjegjësitë e këtij sektori lidhen edhe me projektet në shkallë urbane për përmirësimin e hapësirave publike, si dhe garantimin e përputhshmërisë teknike të projekteve në fushën e planifikimit hapësinor.

**Spektori i Zhvillimit të Territorit** – ose sektori që do të përgjigjet për lejet e zhvillimit/ ndërtimit, do të ketë funksion primar shqyrtimin e aplikimeve dhe ndjekjen e zbatimit të tyre.

**Spektori GIS dhe Kadastra** – qëllimi i këtij sektori është azhurnimi i databazës GIS me lejet e dhëna nga sektori i lejeve dhe hedhja e PDV-ve nga sektori i planifikimit, duke përqëndruar kështu të gjitha të dhënat në një sistem të vetem. Si dhe përditësimin e projekteve me impakt në territor. Ky sektor do të lidhet ngushtë me kadastrën, duke gjeneruar Gen-plane të azhurnuar me sistemin rrugor sipas PPV-së dhe duke koordinuar më mirë punën mes sektorëve që lidhen me zhvillimin e territorit.

Nga struktura e mësipërme e propozuar, rezulton se janë të nevojshëm minimumi 10 punonjës të nevojshëm në “Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, 1 Drejtor dhe 3 punonjës për secilin Sektor (Shef Sektor + 2 specialistë). Rritja e stafit mund të kryhet në disa etapa, pasi ka kosto për buxhetin e bashkisë shtimi i 7 vendeve të reja të punës, për këtë arsye sugjerohet restrukturimi sipas etapave, ku mund të realizohet duke zgjeruar fillimisht sektorin me 3

punonjës të rinj, për 2-3 vitet e para. Ku këta 3 punonjës të shtuar do duhet të kenë këto profile:

- 1 specialist arkitekt ose urbanist
- 1 specialist GIS (mirëmbajtje të dhënash gjeohapësinore)
- 1 inxhinier transporti

Efekti financiar për punësimin e 3 specialistëve vlerësohet me 1.008.000 lekë/vit, duke supozuar një pagë minimale mujore prej 28.000 lekë/ muaj për pozicionin e specialistit. Profilet e ekspertëve të cilët duhet të punësohen në vazhdim pranë këtyre sektorëve do duhet të jenë: arkitekt, konstruktor/ inxhinier ndërtimi, urbanist, ekspert GIS, inxhinierë hidroteknik, inxhinierë elektrik, inxhinierë mjedis, inxhinierë transporti, agronom dhe topograf.

Në rast se bashkia do ta ketë të pamundur punësimin e specialistëve të rinj sugjerohet nënkontraktimi i palëve të treta për disa nga projektet të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi aktual i bashkisë. Bashkia mund të delegojë një pjesë të funksioneve të veta drejt të tretëve, të cilët nëpërmjet procesit të prokurimit ose tenderimit garantojnë realizimin e detyrës. Vëmendje duhet pasur në llogaritjen e kostove në delegimine funksioneve, si kostot e bashkisë në përgatitjen e kontratës dhe monitorimin e zbatimit të saj.

### **5.3 Zhvillimi i kapaciteteve dhe marrëveshjet e zbatimit**

Gjatë procesit të punës për hartimin e Plani të Përgjithshëm Vendor, analiza e kujdesshme e kryer mbi aspektet institucionale të bashkisë Finiq nxori në pah një sërë çështjesh kryesisht të lidhura me mangësi në aspektin e kapaciteteve institucionale. Prandaj, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh, të hartuar dhe renditur në vijim, prekin ngritjen/përmirësimin e kapaciteteve institucionale të domosdoshme për veprim në departamentin e propozuar, si dhe do të kontribuojnë në rritjen e performancës së bashkisë Finiq sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit të tij.

Përmirësimi i kapaciteteve institucionale arrihet duke përmirësuar proceset e punës, rritur efiçencën dhe kapacitete e burimeve njerëzore. Është shumë e rëndësishme të rritet përdorimi i teknologjisë dhe ofrimit të shërbimeve të dixhitalizuara, duke shmangur kështu gabime dhe vonesa, si dhe duke shkurtuar shpenzimet operative të bashkisë. Rritja dhe aftësimi i kapaciteteve njerëzore është gjithashtu një komponent shumë i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së bashkisë në ofrimin e shërbimeve ndaj banorëve të saj. Evidentimi nga Sektori i Burimeve Njerëzore për mungesat dhe paketen e trajnimeve të nevojshme për stafin e bashkisë është hapi i parë në rritjen e performancës.

Sipas Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020, fuqizimi i administratës vendore është një objektivi kryesor në suksesin e një sërë

reformave si ajo territoriale, ajo e decentralizimit të administratës publike në nivel vendor etj. veçanërisht një sfidë e madhe është ajo e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore. Performanca e kërkuar dhe kapaciteti i nevojshëm i administratës vendore do të arrihen përmes promovimit të të mësuarit të vazhdueshëm dhe trajnimeve afatshkurtër dhe afatgjatë. Trajnimet e vazhduara dhe plotësuese të stafit të Bashkisë duhet të organizohen në fushat më prioritare si në:

- Planifikim dhe menaxhim territori;
  - Hartim politikash zhvillimi
  - Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit
  - Përdorim i GIS dhe RKPT-së
  - Menaxhim projektsh
  - Rregulla të përdorimit të tokës
- Trajtim i çështjeve sociale (duke përfshirë konfliktin mbi pronën, etj.)
- Zhvillim rural dhe menaxhimin e pasurive natyrore;
- Menaxhim të pasurive ujore (lumenj, rezervuarë etj.)
- Turizëm dhe guida turistike;
- Menaxhim i rreziqeve natyrore;
- Transport (publik) dhe lëvizshmëri e butë.

Kostot e trajnimeve të mësipërme ndahen në këto komponente: kosto e ditëve të punës për punonjësit që trajnohen në qendra të specializua/ ditë trajnimi si dhe kostot e dietave për ditët e trajnimeve nëse zhvillohen në qytete të tjera. Kostot e trajnimit të punonjësve duhet të jetë më e vogël së përfitimet që sjellin keto trajnime, duke synuar zhvillimin e projekteve dhe rritjen e investimeve publike, në mënyrë që të ulen shpenzimet administrative të përgjithme të bashkisë.

Marrëveshjet e ngritura në kuadër të zbatimit të PPV-ve mund të kenë si fokus disa çështje të ndryshme si:

- Marrëveshje për zbatim projektsh të përbashkëta.
- Marrëveshje për monitorimin e situatës ekzistuese dhe plotësimin e databazës së të dhënave.
- Marrëveshje për hartimin e planeve sektoriale vendore.
- Marrëveshje për menaxhimin e hapësirave publike.
- Ndërgjegjësimin e publikut.
- Ngritjen e kapaciteteve vendore.
- Monitorim të situatës mjedisore.

Pasurimi i organikave me specialistë të kualifikuar dhe hapja e Departamentit të Projekteve të Huaja (PIU - Project Implementation Unit), që minimalisht duhet të përbëhet nga 1 specialist

për agroturizëm dhe 1 ekspert për projektet ndërkuftare IPA me kualifikim të nevojshëm në hartimin dhe menaxhimin e projekteve do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV-së.

Table 10: Modulet e trajnimit

Module trajnimi	Përmasat	Kosto e trajnimit	Fazat e Zbatimit			Institucionet përgjegjëse	Burimet / Ekspertët	Përfituesit
			i	II	III			
Promovimi dhe vendosja e Brand-it për produktet lokale	-	15.000				Bashkia Finiq	Ekspertë marketingu dhe vecanërisht ekspertë të manaxhimit të markave/brandeve	1- Specialistët e bashkisë dhe të njësive administrative; dhe 2- Fermerët kultivues të produkteve
Promovimi i aktiviteteve të reja për turizmin aktiv natyror (eksplorim shpellash, ngjitje etj)	-	8.740				Agjensia Kombetare e Turizmit	Ekspertë të shërbimeve turistike dhe të promocion-marketingut të tyre.	1- Specialistët mjedisorë e të turizmit të bashkisë e të njësive administrative; 2 - Udhërrëfyesit vendas
Promovimi i bashkëpunimit me bashkinë e Sarandës	Vjetore	10.000				Bashkia Finiq/ Bashkia Sarandë	Ekspertë të burimeve njerëzore dhe specialistë	Specialistët e departamenteve simotra nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave (ekonomi, turizëm)
Promovimi i prodhimit vendas në bizneset e turizmit	-	2.740				Bashkia Finiq / Agjensia Kombetare e Turizmit	Ekspertë të shërbimeve turistike, të manaxhimit të produkteve ushqimore, të shërbimeve mikpritëse.	Bizneset e vogla dhe ato familjare të turizmit, hotelerisë, të shërbimeve mikpritëse dhe fermerët
Promovimi i ndërmarrjes në sektorin e agroturizmit (30 start-up)	30 fermerë	15.000				Bashkia Finiq	Ekspertë biznesi, ekspertë të shërbimeve turistike	30 fermerë për t'u kthyer në sipërmarrës të turizmit

Iniciativa dhe programe për nxitjen e riciklimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor	min 2 herë në vit	10.000			Bashkia Finiq	Ekspertë mjedisorë dhe ekspertë riciklimi	1- Komuniteti rrit ndërgjegjësimin ndaj çështjeve të ruajtjes së mjedisit. 2 - Specialistët e mjedisit në bashki dhe në njësi administrative
Përmirësimi i kapaciteteve të bashkisë në zhvillimin e projekteve dhe tërheqjen e fondeve		40.000			Bashkia Finiq	Ekspertë për aplikim në projektet IPA, Cross Border.	Specialistët e departamentit të projekteve të huaja (PIU)
Përmirësimi i kapaciteteve për zbatimin e planit dhe aplikimin e PDV		20.000			Bashkia Finiq / AKPT	Ekspertë të urbanistikës e planifikimit, të infrastrukturës dhe ekspertë GIS	Specialistët e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashki
Aplikimi i instrumente tatimore dhe taksave mbi tokën	1 herë në vit	20.000			Bashkia Finiq / AKPT	Ekspertë tatimore, ekspertë të urbanistikës e planifikimit dhe ekspertë ligjorë	Kalimi në Keshillin bashkiak i të paktën dy instrumentave tatimore për menaxhimin e taksave të pronës dhe turizmit dhe trajnimi i stafit 1 herë në vit.

## 6 Konsultime me palët e interesuara

### 6.1 Dëgjese publike për Planin e Zhvillimit dhe Rregulloren e Planit

Bashkia Finiq më datë 12.04.2019 në orën 10:30, në ambientet e një lokali në qendër të Finiqit realizoi dëgjese të tretë publike, ku u prezantuan dokumentet e Fazës 3 “Plani i Zhvillimit Territorial”, për të cilin ju informojmë si më poshtë vijon:

#### Stafi i Bashkisë prezentë në dëgjese:

Zis Olluci –N/ Kryetar Bashkie;

Vasil Loli – Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;

Katerina Tholloni- N/Kryetare Bashkie;  
Vasil Talo -Sekretar i Pergjithshem

**Përfaqësues nga studio “DEA Studio”:**

Ervin Taçi – Drejtues Projekti;  
Suzana Gjokutaj- Kordinatore projekti;  
Erjon Çobani – Ekspert;

**Pjesëmarrës të tjerë** në dëgjuesë ishin: Irena Nikuli, Dhimitraq Ndreu, Spiro Jorgji, Thoma Nikuli, Kristaq Thanasi, Vanthia Shqevi, Anesti Karkodhina, Maniola Ndoka, Kristo Dolodha, Jani Pupi, Marjeta Teli, Ilia Kalivjoti, Kado Çepe, Petraç Bereti, Milto Londo, Grigor Zafir, administratorë të njëjësive administrative, fermerë, përfaqësues biznesesh, ekspertë të fushave të ndryshme, etj.

**Rreth takimit:**

Takimi filloi me prezantimin e fazës 3 të hartimit të planeve të përgjithshme vendore për Bashkinë Finiq, e cila është përmbledhur në pikat si më poshtë:

- Përmbledhje e problematikave të evidentuara në këtë bashki, si pengesë kryesore për zhvillimin ekonomik të saj;
- Përmbledhje e Potencialeve të mundshme për zhvillimin ekonomik – social të territorit të kësaj bashkie
- Plani i zhvillimit
- Vizioni
- Evidentimi i poleve të zhvillimit:
- Polet ekonomike (qendra të zhvillimit industrial, pika grumbullimi të produkteve bujqësore, blegtorale apo bimëve medicinale)
- Pole të zhvillimit agro-turistik me drejtim bujqesine
- Pole të zhvillimit të agro-turizimit me drejtim blegtorine
- Pole të zhvillimit te eko-turizmit
- Strategjia territorial
- Evidentimi i zonave me rëndësi kombëtare
- Ruajtja e tokës bujqësor
- Ruajtja e tipologjisë së zhvillimit për banesat, nëpërmjet mbushjes dhe konsolidimit urban
- Kthimi i tokës bujqësore në truall për ato toka ku janë ndertuar banesa.

Me vijim të prezantimit u hap diskutimi me publikun, ku u shprehën mendime, në lidhje me prezantimin e Planit të Zhvillimit për Planin e Pergjithshem Vendor të Bashkisë Finiq.

Gjatë vazhdimit të prezantimit qytetarë të ndryshëm shprehën mendimin e tyre në lidhje me prezantimin dhe sesi mund të zhvillohej ekonomia nëpërmjet projekteve të propozuara dhe sesi do të impaktohej jeta e banorëve të kësaj bashkie.

Shqetësimi i vetëm i ngritur prej tyre ishte përcaktimi i qendrës së bashkisë dhe sesi ishte parë nga grupi i punës ofrimi i shërbimeve publike në fshatrat që shërbejnë si qendra të Njërive Administrative të bashkisë Finiq.

Në vazhdim të diskutimit u theksua dhe njëherë se nuk është kompetencë e konsulentit të propozojë qendër të re për bashkinë Finiq, si dhe u sqarua që qendrat administrative janë parë si qendra zhvillimi duke propozuar shkolla, ambulanca, rikualifikime të shesheve qendrore.



## 6.2 Raporti i Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në nivel Vendor

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit më datë 04.04.2019 (ditën e enjte), në orën 12:30, realizoi takimin e FBPV ku u diskutua mbi: Planin e Zhvillimit dhe Rregullore lokale të bashkive: Libohovë, Delvinë, Finiq. Hapjen e takimit e bëri Drejtoresha e Planifikimit Vendor të AKPT-së, Znj. Fiona Mali duke theksuar shkurtimisht rëndësinë dhe arsyet e organizimit të Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në Nivel Vendor. Më pas u vijua me prezantimin e studios konsulente për bashkitë e Lot 5 – Libohovë, Delvinë dhe Finiq.

Prezantimi i Fazës së Planit të Zhvillimit dhe Rregullores Lokale u bë nga Znj. Suzana Gjokutaj, menaxhere e projektit nga kompania konsulente. Diskutimi i kryer u zhvillua në mënyrë të përgjithshme për të gjithë bashkitë duke u përqëndruar në pikat si më poshtë:

### **AKZM**

Parimisht Z. Sulejman Xhepa, përfaqësues i AKZM-së u shpreh në dakordësi për zhvillimet e propozuara nga kompania konsulente për zhvillimin e Zonave të Mbrojtura të ndodhura në territoret e të tre bashkive gjithmonë në drejtim të ekoturizmit.

Për bashkinë e Libohovës, Z. Xhepa u shpreh se Parku Natyror i Zagorisë, si park natyror i Kategorisë IV, lejon:

- Është në proces hartimi i Planit të Menaxhimit për Parkun, por kufijtë e Zonës Bërthamë dhe ai tradicional mund të mbahen kufijtë e shpallur me VKM;
- Zhvillimin e ekoturizmit në zonimin tradicional të tij;
- Mund të vijë nga ana e bashkisë Libohovë dhe nga kompania konsulente propozime për shpallje të reja të monumenteve të Natyrës apo zona të mbrojtura, të argumentuara për vlerat e tyre specifike.

Në territorin e bashkisë Delvinë, ndodhet Rezervati Natyror i Menaxhuar “Rrëzoma”, kategoria IV, për të cilin z. Xhepa u shpreh se mund të jetë me vlerë edhe një propozim për zgjerim të kufijve të tij apo propozim për futje në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura edhe për Pyllin e Gështenjave.

Lidhur me Monumentin Natyror “Syri i Kaltër”, në bashkinë e Finiqit, u shpreh se:

- Zona e Monumentit të Natyrës mund të qëndrojë si Zonë Bërthamë dhe të propozohet shpallja e Parkut Natyror për zonën përreth, nga ana e bashkisë. Zgjerimi i kësaj zone shikohet me vlerë edhe për bashkinë, pasi në rast se aty do të lejohen zhvillimi i aktiviteteve ekoturistike mund të jetë fitimprurëse nga ana ekonomike.
- E gjithë hapësira e propozuar mund të jetë një njësi strukturore më vete, në të cilën duke respektuar kufizimet ligjore për Zonat e Mbrojtura, mund të vendoset si përdorim i lejuar toke, aktivitetet si Argëtim apo Shërbime.
- Mund të propozohen edhe krijimi i Shtigjeve miqësore ndaj Natyrës, brenda zonës së Parkut.

Si komente të përgjithshme, z. Sulejman u shpreh se në çdo rast:

- Duhet të respektohet distanca 200m si zonë buferike përreth Monumenteve të Natyrës;
- Qëndrojnë gjithmonë të hapur ndaj diskutimeve dhe konsultimeve për përdorimet e lejuara të tokës për njësitë strukturore brenda Zonave të Mbrojtura.

### **ARRSH**

Përfaqësuesja e Autoritetit Rrugor Shqiptar u shpreh se një nga projektet i cili është aktualisht në proces zbatimi nga ARRS, i cili prek territorin e bashkisë Delvinë, është aksi rrugor Delvinë-



Kardhiq. Projekte të tilla të cilat propozojnë zgjerime të trasesë ekzistuese apo akse të reja rrugore, janë gjithmonë projekte komplekse pasi kërkojnë shpronësime dhe futen në lojë shumë aktorë. Për këtë arsye zbatimi i tyre mund të kërkojë një kohë të caktuar.

### **AKPT**

Znj. Fiona Mali, ngriti pyetjen nëse është e nevojshme që në territorin e bashkisë Delvinë të jenë të propozuara 2 struktura të ndryshme për Tregun Bujqësor dhe për Qendrën e Grumbullimit të produkteve bujqësore, apo mund të inkorporohen në ambient të vetëm.

Nga kompania konsulente u shprehën se tregu ka përmasa të vogla dhe do i shërbejë kryesisht qytetit të Delvinës, në mungesë të një tregu aktual me cilësi të mirë. Pozicionimi i tij në fshatin Stjar është shumë strategjik pasi ka një distancë shumë të vogël me qytetin, mund të shikohet si një pjesë periferike e tij dhe gjithashtu është afër prodhimeve bujqësore. Përsa i përket qendrës së grumbullimit të produkteve bujqësore, ajo do i shërbejë të gjithë territorit të bashkisë, por edhe bashkive kufitare, prandaj ka nevojë për një hapësirë më të madhe.

Gjithashtu nga Znj. Mali u përmend edhe fusha e zhvillimit të Agroturizmit dhe Ekoturizmit, i cili duhet të përfshihet në dokumentin e Rregullores së Planit, si një Nen i veçantë, duke u synuar gjithmonë një lejim i këtyre aktiviteteve atje ku do të lindë nevoja në të ardhmen dhe jo duke u kufizuar në përcaktimin që në këtë fazë të një vendndodhjeje specifike.

